



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT 2025

Prishtinë, gusht 2026

Tabela e përmbajtjes

Fjala e Auditorës së Përgjithshme	7
Përmbledhja ekzekutive.....	1
Kapitulli I: AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025	5
1.Opinion i auditimit	7
2.Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	8
3.Deficiti buxhetor	11
4.Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore	13
5.Analiza e buxhetit të shtetit	19
5.1.Analiza e të hyrave/pranimeve sipas kategorive ekonomike	21
5.2.Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike	24
5.3.Analiza e shpenzimeve sipas funksionit.....	30
5.4. Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike	31
5.5.Analiza e subvencionimit të Ndërmarrjeve Publike nga buxheti i shtetit.....	33
6.Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe balanceve të fondeve	34
7.Pasuritë jofinanciare kapitale, jokapitale dhe stoqet.....	36
8.Llogaritë e arkëtueshme	39
9.Detyrimet e papaguara dhe kontingjente	42
10.Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore	46
11.Sistemi i auditimit të brendshëm	49
12.Të dhënat e punësimit	50
Kapitulli II: AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË	53
Përmbledhje e opinionëve, konkluzioneve dhe rekomandimeve	55
1.Niveli Qendror	57
1.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre	57
1.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre	59
1.3.Rekomandimet e dhëna	60
2.Niveli Lokal	60
2.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre	60
2.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre	62
2.3.Rekomandimet e dhëna	64

3.Ndërmarrjet Publike	65
3.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre	66
3.2.Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre	67
3.3.Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar	68
3.4.Rekomandimet e dhëna	71
Kapitulli III: AUDITIMET E PERFORMANCËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	73
1.Auditimet e performancës dhe teknologjisë së informacionit	75
Kapitulli IV: AUDITIMET E PAJTUESHMËRISË.....	93
1.Auditimet e pajtueshmërisë.....	95
Kapitulli V: REKOMANDIMET E AUDITIMIT	105
Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve.....	107
1.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2024	107
2.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2024.....	108
3.Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës.....	109
4.Ndikimi i auditimit.....	109
4.1.Niveli Qendror	110
4.2. Niveli Lokal	110
Shtojcat	113
Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA-në e vitit 2024.....	115
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës pas shqyrtimit të raporteve të auditimit	119
Shtojca III: Opinionet për OB-të e audituara në tre vitet e fundit.....	120
Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	124
Shtojca V: Letërkonfirmimi.....	127
Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë	128

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm	LIVTH	Llogaria e Vetme e Thesarit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil	MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	MAPL	Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal
ANZH	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim	MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit	MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
BB	Banka Botërore	MSH	Ministria e Shëndetësisë
BE	Bashkimi Evropian	ME	Ministria e Ekonomisë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
BPV	Bruto Produkti Vendor	NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	NP	Ndërmarrjet Publike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	OB	Organizata Buxhetore
BZHKE	Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës	OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
DK	Doganat e Kosovës	PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	RFV/BRK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
INTOSAI/ ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit	RTK	Radio Televizioni i Kosovës
KA	Komiteti i Auditimit	SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve	SGJC	Sistemi i Gjendjes Civile
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës	TVSH	Tatimi në Vlerën e Shtuar
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	TI	Teknologjia e Informacionit
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
LPP	Ligji për Prokurim Publik		



Fjala e Auditorës së Përgjithshme

Në një kohë kur paraja publike duhet të shndërrohet në shërbim, zhvillim dhe mirëqenie për qytetarët, rritja e llogaridhënies, transparencës dhe përgjegjshmërisë në shpenzimin e saj është më e rëndësishme se kurrë.

Menaxhimi më i mirë i fondeve publike matet me ndryshimin që ai sjell, më një investim më të mirë, shërbime publike më cilësore, shkolla më të sigurta, mjedis më të pastër dhe mbi të gjitha matet me besueshmërinë e qytetarëve që kanë ndaj institucioneve publike.

Shpenzimi i parasë publike nuk është vetëm çështje e zbatimit të procedurave, ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosje e shifrave, por është më shumë, është arritje e qëllimeve të përbashkëta të institucioneve dhe qytetarëve.

Për t'i ndihmuar shtetit në forcimin e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin e fondeve publike, si Auditore e Përgjithshme, përmes këtij Raporti Vjetor të Auditimit shpalos para Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës informacione të pavarura dhe objektive se si është përdorur paraja publike në raport me pritshmëritë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Në fillim të shpalosjes së rezultateve dua të shpreh besimin tim që rekomandimet e auditimit do të shërbejnë si instrument për ndryshim dhe jo vetëm si përgjigje formale ndaj një raporti. Dua të besoj gjithashtu që qytetarët do të shohin në mënyrë konkrete kundërvlerën e parasë së tyre.

Në këtë drejtim, Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar 131 auditime në institucione publike, projekte me rëndësi dhe fusha me interes për qytetarët duke e përmbyllur procesin e angazhimeve me auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë, rezultatet e të cilit janë paraqitur në këtë Raport.

Përkundër se nga viti në vit vërehen përmirësime, rezultatet e auditimeve tregojnë se ende ekzistojnë mangësi, qoftë në cilësinë e raportimit financiar ashtu edhe në fusha të tjera të përbushjes së objektivave në drejtim të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Një numër i institucioneve publike duhet të rrisin masat për të përmirësuar kontrollet e brendshme për sa i përket përbushjes së standardeve dhe rregullave të raportimit financiar. Edhe më tutje, vazhdojnë të kryhen aktivitete dhe transaksione jo në pajtim me legjislacionin në fuqi, klasifikimin e saktë të shpenzimeve, evidentimin dhe administrimin e pasurive, menaxhimin e detyrimeve të papaguara dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme. Dukuri shqetësuese, në disa raste në rritje, është lidhja e kontratave për projekte kapitale pa siguruar fondet e nevojshme ose pa miratimet përkatëse. Praktika të tilla dëmtojnë balancën buxhetore, krijojnë kosto shtesë të paparashikuara dhe rrisin rrezikun e keqmenaxhimit të fondeve publike.

Prokurimi publik, në theks menaxhimi i kontratave vazhdon të mbetet sfidë për institucionet publike. Forcimi i kontroleve të brendshme është më se i nevojshëm në menaxhimin e projekteve infrastrukturore për të siguruar që ato udhëhiqen në pajtueshmëri me kornizën ligjore.

Në kuadër të auditimeve të ndërmarrjeve publike, kemi vazhduar të mbulojmë ndërmarrje me rëndësi për ekonominë dhe shërbimet publike, përfshirë Trepçën, KEK-un, KOSTT-in, Termokos-in, NPL Stacioni i Autobusëve Prishtinë, si dhe ndërmarrje të tjera publike. Rezultate tregojnë se, përkundër përmirësimeve në disa ndërmarrje, menaxhimi financiar dhe qëndrueshmëria e disa ndërmarrjeve publike vazhdojnë të kërkojnë vëmendje.

Një pjesë e rëndësishme e punës sonë gjatë këtij sezoni kanë qenë auditimet e performancës, përmes të cilave kemi vlerësuar nëse programet, projektet dhe shërbimet publike po i arrijnë rezultatet e synuara. Këto auditime kanë mbuluar fusha të ndryshme, përfshirë arsimin, sigurinë e nxënësve, mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, zhvillimin urban, shërbimet publike, energjinë, pronat dhe teknologjinë e informacionit.

Rezultatet tregojnë se institucionet publike ende përballen me sfida në zbatimin e politikave dhe në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Siguria e nxënësve në shkollat publike dhe mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta në arsimin fillor janë dy fusha ku auditimi ka evidentuar nevojën për mekanizma më të mirë të sigurisë, koordinim më të madh ndërmjet institucioneve dhe mbështetje më efektive për nxënësit.

Në fushën e zhvillimit urban, auditimi i procesit të ndërtimeve të larta në Komunën e Ferizajt ka evidentuar nevojën për kontrole dhe mbikëqyrje më të efektshme në proceset e lejeve, ndërtimit dhe certifikimit. Ndërsa në fushën e shërbimeve publike, auditimet për ngrohjen qendrore në Termokos dhe grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet, së bashku me auditime të tjera në energji, infrastrukturë, prona dhe sisteme të teknologjisë së informacionit, kanë identifikuar fusha ku kërkohet përmirësim i mëtejshëm.

Janë zgjeruar dukshëm auditimet e pajtueshmërisë, të cilat kanë evidentuar nevojën për kontrole më të fuqishme në nivelin lokal në menaxhimin e pronës publike dhe subvencionet, derisa te niveli qendror në menaxhimin e investimeve kapitale dhe granteve/subvencioneve për zhvillim.

Për korrigjimin e mangësive të identifikuara, gjatë vitit 2025 kemi dhënë gjithsej 1,032 rekomandime. Megjithatë, shqetësues mbetet fakti se nga rekomandimet e dhëna në vitin 2024 janë zbatuar vetëm 36%. Ky nivel tregon se rekomandimet e auditimit ende nuk po marrin vëmendjen dhe veprimin e nevojshëm nga institucionet përgjegjëse. Përderisa, për rastet me dyshime potenciale për mashtrim janë adresuar tek institucionet përkatëse të drejtësisë për trajtim të mëtutjeshëm.

Si Auditore e Përgjithshme, vlerësoj se forcimi i llogaridhënies dhe rritja e zbatimit të rekomandimeve duhet të jenë ndër prioritetet e institucioneve publike. Auditimi mund të identifikojë problemet dhe të tregojë se çfarë duhet përmirësuar, por ndryshimi real varet nga veprimet që ndërmerren pas auditimit.

Prandaj, u bëj thirrje drejtuesve të institucioneve publike që të ndërmarrin masa konkrete dhe në kohë për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit si dhe trajtimin e rasteve me dyshime potenciale për mashtrim. Po ashtu, inkurajoj Kuvendin e Republikës së Kosovës që rezultatet e auditimeve t'i përdorë në mënyrë më aktive për të forcuar mbikëqyrjen dhe llogaridhënien e institucioneve.

Auditorja e Përgjithshme,
Vlora Spanca

Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës

Opinionimi i kualifikuar

**Klasifikimi joadekuat
i shpenzimeve**

77,365,811€

Pasuritë

mbivlerësim i pasurive për

33,546,888€

Llogaritë e arkëtueshme

nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme për

4,376,420€

Detyrimet e papaguara

mbivlerësim i detyrimeve për

2,819,782€

Detyrimet e kontingjente

mbivlerësim i detyrimeve kontingjente për

29,818,507€

Deficiti

i përlogaritur sipas
buxhetit

-224,067,000€

apo **-2%**

Deficiti

pas realizimit të
buxhetit - 2025

-7,772,000€

apo **-0.07%**

Të hyrat/pranimet buxhetore

Planifikimi **3,835,225,000€**

Realizimi **3,512,430,000€** apo **92%**

Krahasuar me realizimin e vitit 2024

pranimet janë rritur për **278,341,000€** apo **9%**.

Buxheti/Shpenzimet

Buxheti final **3,847,789,000€**

Realizimi **3,486,638,000€** apo **91%**

Krahasuar me vitin 2024 kishte

rritje të shpenzimeve për **291,059,000€** apo **9%**.



Borxhi shtetëror
1,817,340,000€
apo **16.5%** e BPV-së

Borxhi i jashtëm
856,290,000€

Borxhi i brendshëm
961,050,000€

Auditimet e kryera 2025/2026

131 auditime

87 auditime financiare dhe
të pajtueshmërisë për
organizata buxhetore

12 auditime të
ndërmarrjeve publike


6 auditime të projekteve
të Bankës Botërore

15 auditime të
performancës

11 auditime të
pajtueshmërisë

87

Opinione të Pasqyrave Financiare të Organizatave Buxhetore



12

Opinione të Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjeve Publike



Auditimet e Performancës dhe Teknologjisë së Informacionit



Monitorimi, mirëmbajtja dhe siguria e digave në Kosovë



Fuqizimi i rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe marrje të vendimeve



Siguria e nxënësve në shkollat publike në Kosovë



Mbështetja për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike



Efektiviteti i shërbimit të ngrohjes qendrore Termokos



Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e lejeve ndërtimore në Komunën e Fushë Kosovës



Efikasiteti dhe efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave të amviserisë në kryeqytet.



Efikasiteti dhe efektiviteti i administrimit të pronave nga AKKVP



Zbatimi i procedurave të prokurimit për mirëmbajtjen e autotudhëve A7 dhe A6



Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Ferizajt



Efektiviteti në përdorimin e kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm për dhënie të kontratës në prokurim publik



Planifikimi dhe menaxhimi i projektit "Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet



Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit "Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK dhe GPK për vitin 2021"



Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale (SII)



Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS)

Auditimet e Pajtueshmërisë



Ndërtimi i objektit për Klinikat e Nefrologjisë dhe Hemato-Onkologjisë



Ndërtimi i shtëpive për komunitetet jo shumicë



Menaxhimi i projekteve kapitale në trashëgimi kulturore



Monitorimi i Skemës së Granteve për Zhvillim Rajonal të Balancuar



Menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit



Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira

Për Komunat :

- Komuna e Lipjanit,
- Komuna e Skënderaj, dhe
- Komuna e Gjakovës,



Auditimet e Pajtueshmërisë me informata të klasifikuara (Niveli i kufizuar) për:

- Ministrinë e Punëve të Brendshme,
- Ministrinë e Mbrojtjes, dhe
- Ministrinë e Drejtësisë.

Rekomandimet për vitin 2025

Raporti Vjetor i Auditimit 2025

17 Rekomandime

Auditimet individuale në total

1032 Rekomandime

- **230** Niveli Qendror
- **412** Niveli Lokal
- **182** Ndërmarrjet Publike
- **39** Auditimet e Pajtueshmërisë
- **169** Auditimet e Performancës

Përmbledhja ekzekutive

Raporti Vjetor i Auditimit përgatitet në bazë të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Ky raport, për Kuvendin, Qeverinë dhe palët e tjera të interesit përmban:

- Opinionin e Auditorit lidhur me faktin nëse deklaratat financiare të Raportit Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës japin një pasqyrë të saktë dhe të drejtë;
- Deklaratën lidhur me kufirin e deficitit buxhetor dhe me kushtet dhe kërkesat ligjore; dhe
- Përmbledhjen e rezultateve të auditimit që përfshijnë konkluzionet dhe rekomandimet e rëndësishme nga të gjitha auditimet e kryera gjatë sezonit auditues që mbulon vitet 2025/2026.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Deklarata e pajtueshmërisë për deficitin buxhetor - Kufiri i deficitit buxhetor gjatë vitit 2025 ishte në kuadër të limiteve të përcaktuara ligjore dhe nga realizimi i buxhetit vërehet se niveli i inkasimit të të hyrave ishte përmirësuar dhe ishte ulur kërkesa për financim. Për vitin 2025, deficitin i përgjithshëm i përlogarit sipas buxhetit ishte -224,067,000€ apo -2% e BPV-së. Sipas realizimit në fund të vitit, kishte deficit në vlerë prej -7,772,000€ apo - 0.07% e BPV-së.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit - Sipas trendit të tri viteve të fundit vërehet se pranimet dhe pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Projektionet fillestare dhe finale për të hyrat/pranimet sipas buxhetit për vitin 2025 ishin planifikuar 3,835,225,000€, ndërsa ishin realizuar në vlerë prej 3,512,430,000€ apo 92% e buxhetit. Krahasuar me realizimin e vitit 2024 pranimet janë rritur për 278,341,000€, apo rreth 9%.

Buxheti fillestar për shpenzime ishte 3,782,398,000€, kurse buxheti final ishte në vlerë prej 3,847,789,000€ i cili ishte realizuar në vlerë 3,486,638,000€ apo 91% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2024 kishte rritje të shpenzimeve për 291,059,000€ apo 9%.

Bilanci i fondeve, në fund të vitit 2025 është rritur për 21,344,000€ në krahasim me bilancin e vitit 2024. Bilanci bankar i pasurive financiare - pasasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2025 ishte 445,228,000€.

Borxhi shtetëror - Në fund të vitit 2025, vlera e borxheve shtetërore ishte 1,817,340,000€ apo rreth 16.50% të BPV-së dhe është brenda kufijve të përcaktuar ligjor. Prej tyre, 856,290,000€ janë borxhe të jashtme dhe 961,050,000€ borxhe të brendshme. Në raport me vitin e kaluar borxhi i përgjithshëm ka shënuar rritje prej 80,380,000€ apo 4.60%.

Borxhi i jashtëm në raport me vitin e kaluar është rritur për 81,530,000€ përderisa borxhi i brendshëm është zvogëluar për 1,150,000€.

Nga analiza e realizimit të projekteve të financuara nga borxhi shtetëror është vërejtur mosefikasitet dhe ngecje në shfrytëzimin e fondeve të marra si hua të jashtme. Kjo është shkaktuar kryesisht nga problemet me menaxhimin e projekteve infrastrukturore, shpronësimet qoftë në fazën e planifikimit apo zbatimit të tyre.

Llogaritë e arkëtueshme - Vlera e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 1,210,744,277€ nga këto 903,029,757€ të nivelit qendror dhe 307,714,521€ të nivelit lokal. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 206,104,277€, apo 20% dhe ky është një tregues që institucionet publike nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për mbledhjen e të hyrave. Në vitin 2025, nga auditimi është identifikuar se llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar në vlerë prej 4,376,420€.

Detyrimet e papaguara dhe kontingjente - Vlera e prezantuar e detyrimeve të papaguara në RVF-BRK ishte 294,553,783€, nga këto 237,850,574€ të nivelit qendror dhe 56,703,209€ të nivelit lokal. Krahasuar me vitin paraprak detyrimet e papaguara janë rritur për 98,548,779€ apo rreth 50%. Në vitin 2025, nga auditimi është identifikuar se detyrimet e papaguara ishin mbivlerësuar për 2,819,782€.

Ndërsa, sipas RVF-BRK-së detyrimet kontingjente për vitin 2025 janë gjithsej 419,097,677€. Nga auditimi është identifikuar se vlera e detyrimeve kontingjente ishte e mbivlerësuar për 29,818,507€.

Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve - sipas RVF-BRK-së për vitin 2025 ishin në vlerë 159,460,818€. Në raport me vitin 2024, shumën e këtyre pagesave është rritur për 34,045,662€ apo 27%. Shpenzimet e kësaj natyre të cilat derivojnë nga këto procedura vazhdojnë të jenë sfidë për buxhetin e shtetit edhe për faktin e shpenzimeve shtesë përtej borgjit kryesor.

Marrë parasysh faktin se një pjesë të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë investimet kapitale, rezultojnë që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ridestinuuar për t'u paguar këto detyrime.

Pasuritë jofinanciare - Raportet mbi pasuritë jofinanciare në vitin 2025 ende nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrollë dhe monitorim të plotë mbi pasuritë. Të dhënat e pasurive jofinanciare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri janë jo të plota dhe gjendja e tyre është përcjellë me pasaktësi në raportim në vlerë prej 33,546,888€, derisa në vitin 2024 pasaktësia ishte 27,090,159€.

Kapitulli I

AUDITIMI I RAPORTIT VJETOR FINANCIAR I BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2025

1. Opinioni i auditimit

Zyra Kombëtare e Auditimit ka audituar Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, i cili përfshin: Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar të pasurive financiare dhe bilancin e fondeve dhe Shënimet shpjeguese dhe shtojcat.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Baza për opinionin e kualifikuar

- **Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve** - Gjatë vitit 2025 janë identifikuar klasifikime joadekuate të shpenzimeve në vlerë prej 77,365,811€. Prej tyre 20,905,828€ apo 27% të nivelit qendror dhe 56,459,983€ apo 73% të nivelit lokal.
Kjo ka ndodhur si rezultat i pagesave të bëra me vendime gjyqësore në vlerë prej 58,473,171€, (përkundër që MFPT ka mundësuar planifikimin e mjeteve në kategorinë "Rezerva" për të shmangur klasifikimin jo adekuat), buxhetimit jo adekuat 4,531,785€ dhe të ndikuara nga vetë organizatat buxhetore në vlerë prej 14,360,855€.
- **Pasuritë** - Në fund të vitit 2025, vlera e pasurive sipas RVF-BRK-së ishte 10,724,860,661€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar mbivlerësim i pasurive prej 33,546,888€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK. Problemet më të mëdha të cilat e kanë përcjellë këtë kategori ishin: regjistrimi jo i plotë i pasurive, moskoordinimi në mes organizatave gjatë bartjes së pasurive që ka rezultuar me dyfishim të pasurive dhe regjistrimi i pasurive finale si investime në vijim përkundër pranimi teknik.
- **Llogaritë e arkëtueshme** - Vlera e llogarive të arkëtueshme e prezantuar në RVF-BRK ishte 1,210,744,277€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme prej 4,376,420€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK.
- **Detyrimet e papaguara** - Vlera e detyrimeve të papaguara e prezantuar në RVF-BRK ishte 294,553,783€. Sipas auditimeve individuale është identifikuar mbivlerësim i detyrimeve prej 2,819,782€ në raport me vlerën e prezantuar në RVF-BRK.
- **Detyrimet kontingjente** - Detyrimet kontingjente, janë rezultat i pretendimeve përmes padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritët të marrin epilogun gjyqësor në një të ardhme. Sipas RVF-BRK-së detyrimet kontingjente për vitin 2025 janë gjithsej 419,097,677€. Sipas auditimeve individuale, është identifikuar mbivlerësim i detyrimeve kontingjente për 29,818,507€.

Përshkrim më i detajuar i çështjeve të përmendura te Baza për Opinion gjenden në kapitujt përkatës të këtij raporti.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MF-së dhe mekanizmave të tjerë, të siguroj përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe shpalosjeve në përputhje me kërkesat për raportim të saktë dhe të drejtë të informatave financiare. Të nxis dhe siguroj veprime që ndihmojnë Organizatat Buxhetore të identifikojnë dhe adresojnë shkaqet e mangësive të raportimit financiar, ndër të tjera duke zhvilluar dhe trajnuar kapacitetet profesionale që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar.

2. Korniza ligjore, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Korniza ligjore

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për realizimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë ministritë, komunat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Auditori i Përgjithshëm, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, një herë në vit kryen auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për vitin 2025 bazohet në dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (neni 6 dhe 18);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar (neni 47 dhe 48);
- Plani Vjetor i Auditimit për sezonin auditues 2025/2026;
- Doracaku për Auditime Financiare dhe të Pajtushmërisë;
- Udhëzues për kontrollin e cilësisë;
- Rregullorja e MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Korniza INTOSAI për Deklaratat Profesionale, përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe kryer bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit financiar të buxhetit të Kosovës sipas LMFP-së është baza e parasë së gatshme. Menaxhimi i parasë së gatshme është i organizuar në formën e llogarisë së vetme të Thesarit. Llogaria e Vetme e Thesarit është sistem llogarish bankare që shfrytëzohet për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari. Organizatat buxhetore kanë të deleguara përgjegjësitë për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve. Po ashtu, bazuar në rregulloren MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë në bazë të të cilëve përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe raportojnë në MF/Thesar.

Raporti vjetor financiar për buxhetin e shtetit, përbëhet nga tri pasqyrat kryesore së bashku me shënimet shpjeguese si dhe anekset tjera, të cilat përgatiten nga Thesari, bazuar në shënimet e SIMFK-së.

Gjatë konsolidimit të RVF-BRK-së shënimet për anekset si në vijim: aneksi nr. 8 pasuritë me vlerë nën 1,000€, aneksi 9 stoqet, aneksi 10 të arkëtueshmet, aneksi 12 faturat e papaguara, aneksi 13 detyrimet kontingjente, aneksi 17 numri i të punësuarve jashtë listës së pagave dhe aneksi 18 numri i të punësuarve me kontratë për shërbime, bazohen në shënimet nga pasqyrat financiare individuale të Organizatave Buxhetore.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit. Ndërsa, raportet e auditimeve individuale iu dërgohen Kuvendit të Kosovës, kuvendeve komunale, bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të subjekteve të audituara.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave/Thesari është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatitë dhe të prezantojë në mënyrë të drejtë Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontroleve të brendshme.

Raporti Vjetor Financiar për vitin 2025 është dorëzuar dhe aprovuar në Qeveri brenda afatit dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFP me ndryshime dhe plotësime) si dhe në pajtim me SNKSP-të. Po ashtu, RVF-BRK-të e vitit 2025 janë korrigjuar dhe riaprovuar në Qeveri më 24.07.2026.

Zyra Kombëtare e Auditimit është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e RVF-ve të Qeverisë. Auditimi është fokusuar në tri pasqyrat kryesore dhe në shënimet shpjeguese/shpalosjet:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive financiare dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Objektivi i auditimit ishte që të ofrojmë siguri të arsyeshme:

- Nëse RVF-BRK-ja, paraqet në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse RVF-BRK-ja, paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontroleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së RVF-BRK-së; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Auditimi i RVF-ve të BRK-së për vitin 2025 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA-së. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit përmes të cilit janë hartuar RVF-të dhe me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqëndrohet në adresimin e rreziqeve specifike për opinion, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Qasja e përzgjedhur përfshin edhe vlerësimin e rezultateve të dala nga auditimet për disa anekse të RVF-ve të cilat konsolidohen nga pasqyrat financiare individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike dhe anekset tjera.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keqdeklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontroleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Pjesët e mëposhtme të raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që e kanë karakterizuar vitin 2025, por gjithsesi ofrojnë një nivel të arsyeshëm të sigurisë.

3. Deficiti buxhetor

Sipas nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, Ministri duhet t'i dorëzojë Qeverisë raportin përfundimtar mbi buxhetin, i cili përfshin një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve lidhur me respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tilla.

Në bazë të nenit 22.A.1. të LMFPP Nr. 04/L-194, përcaktohet se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të parashikuar.

Ndërsa, neni 22.A.3 përcakton se me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- Kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së të parashikuar në KASH-in më të fundit; dhe
- Procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas propozimit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka identifikuar burimet shtesë të financimit të deficitit, i cili do të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive të jashtme si dhe granteve.

Tabela 1 - Përlllogaritja e deficitit buxhetor¹ për vitin 2025 (në '000€)

	Buxheti fillestar 2025	Realizimi 2025 sipas RVF-së
1. Të hyrat Buxhetore	3,305,435	3,343,238
Te hyrat tatimore (përfshirë kthimet tatimore)	2,926,364	2,972,984
Të hyrat jotatimore	356,571	339,568
Mbështetja buxhetore nga grantet	10,500	14,372
Grantet e përcaktuara të donatorëve	12,000	16,314
2. Shpenzimet Buxhetore	3,607,502	3,425,893
Paga dhe shtesa	916,920	910,133
Mallra dhe shërbime	536,990	498,634
Subvencione dhe transfere	1,156,723	1,230,710
Shpenzime kapitale	931,300	720,059
Rezerva	4,062	
Pagesa e interesit	49,507	50,884
Grantete e përcaktuara të donatorëve	12,000	15,474
3. Deficiti/suficiti i përgjithshëm (3=1-2)	-302,067	-82,655
4. Deficiti /suficiti i përgjithshëm në % të GDP	-2.73%	-0.75%
5. Shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale	78,000	74,883
Shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura	-	53,384
Shpenzimet nga pranimet e dedikuara të AKP-së	-	-
Fondet e likuidimit nga AKP-ja	-	-
Shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve dhe AKP-ja	78,000	21,499
6. Deficiti/suficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale (6=5+3)	-224,067	-7,772
7. Deficiti/suficiti sipas rregullës fiskale në % të GDP	-2%	-0.07%
8. Bruto produkti vendor i parashikuar	11,083,600	11,083,600

1 Për qëllime të kalkulimit të deficitit buxhetor nuk përfshihen grantet, huamarrja dhe pranimet tjera (Të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga NP, Financimi i njehershëm nga AKP dhe Pranimet nga depozitat)

Tabela më lartë tregon se, deficit i përlogaritur i përgjithshëm (rregulla fiskale) sipas buxhetit fillestar ishte -224,067,000€ apo -2% e BPV-së së parashikuar. Sipas realizimit në fund të vitit, kishte deficit në vlerë prej -7,772,000€ apo - 0.07% e BPV-së.

Vlen të theksohet se kufiri i deficitit buxhetor ishte respektuar si me ligjin fillestar të buxhetit ashtu edhe me realizim për vitin 2025.

4. Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore

Borxhi Shtetëror i Kosovës përbëhet nga borxhi i jashtëm/ndërkombëtar, borxhi i brendshëm dhe garancitë shtetërore. Borxhi i jashtëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar përmes marrëveshjes ndërkombëtare dhe/ose marrëveshjes financiare me kreditorë që kanë selinë jashtë vendit, ndërsa borxhi i brendshëm nënkupton borxhin shtetëror të emetuar ose kontraktuar nga kreditorë brenda vendit.

Republika e Kosovës ka filluar të marrë borxhe të jashtme/ndërkombëtare nga viti 2009, ndërsa prej vitit 2012 ka filluar të marrë borxhe të brendshme përmes emetimit të letrave me vlerë.

Portofoli i Borxhit Shtetëror në fund të vitit 2025 përbëhet nga borxhi i jashtëm dhe borxhi i brendshëm, si dhe një garanci shtetërore². Deri më tani, Kosova nuk ka borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara. Për të gjitha borxhet që kanë të bëjnë me projekte të nivelit qendror dhe lokal, Qeveria e Kosovës është Institucioni bartës.

Në fund të vitit 2025, borxhi shtetëror arriti vlerën 1,817,340,000€ që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej 80,380,000€ apo 4.60%. Megjithatë, duhet theksuar se rritja e Bruto Produktin Vendor ka reflektuar edhe në përqindjen e borxhit dhe garancive shtetërore, e cila ka zbritur në 16.50% në vitin 2025 nga 16.90% sa ishte në vitin 2024.

Sipas ligjit për Borxhin Shtetëror nr.08/L-099 është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë 40% të BPV-së. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) për vitin 2025 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e borxheve.


² Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguajë obligimet kontraktuese të garantuara;

Tabela 2 - Borxhi i jashtëm/ndërkombëtar dhe borxhi i brendshëm në tri vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Borxhi i Jashtëm	856,290	774,760	692,850
Borxhi i Brendshëm	961,050	962,200	970,190
Borxhi i Përgjithshëm	1,817,340	1,736,960	1,663,040
Garancitë Shtetërore	2,550	3,570	28,590
Borxhi dhe Garancitë Shtetërore sipas % së BPV-së	16.50%	16.90%	17.50%
BPV nga ASK ³	11,026,350	10,305,400	9,680,070

Borxhi shtetëror përbëhet 47% nga huamarrja e jashtme dhe 53% nga huamarrja e brendshme, si dhe një garanci shtetërore.

Grafikoni 1- Borxhi i jashtëm dhe i brendshëm ('000 në €)



³ Borxhi i jashtëm ndryshon nëpër vite edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutor. Vlerat e BPV-së për vitin 2025 janë marrë nga faqja zyrtare e Agjencionit të Statistikave të Kosovës.

Borxhi i jashtëm/ndërkombëtar

Në fund të vitit 2025, borxhi i jashtëm është 856,290,000€, që ka shënuar rritje për 81,530,000€ apo 10.52% krahasuar me vitin paraprak. Borxhi i jashtëm është huazuar me qëllim të financimit të projekteve në fushën e arsimit, bujqësisë, mirëqenies sociale, kadastrës, energjisë, shëndetësisë, ujit, trajtimit të ujërave të zeza, ngrohjes qendrore, sistemit bankar, rehabilitimit të rrugëve dhe hekurudhave, rritjes ekonomike si dhe mbështetjen e buxhetit.

Kreditorët kryesorë të borxhit ndërkombëtar janë: Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH) me pjesëmarrje 32%, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) me pjesëmarrje 19%, Banka Evropiane (BE) me pjesëmarrje 12%, Banka Evropiane për Investime (BEI) me pjesëmarrje 9%, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZH) me pjesëmarrje 8%, Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (FOZHN) me pjesëmarrje 5%, Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (BZHKE) me pjesëmarrje 5% dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me pjesëmarrje 4% dhe të tjera 6%.

Tabela 3 - Borxhi i jashtëm/ndërkombëtar në tri vitet e fundit ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Borxhi i jashtëm	856,290	774,760	692,850
Qeveritar	814,030	732,130	652,050
Nën-huazuar	42,260	42,630	40,800
Borxhi i jashtëm sipas % së BPV-së	7.76%	7.52%	7.16%
BPV	11,026,350	10,305,400	9,680,070

Në vitin 2025, organizatat buxhetore për projekte të cilat financohen nga borxhi ndërkombëtar kanë tërhequr fonde nga kreditë në vlerë prej 147,640,000€. Tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga kreditorët si në vijim: FMN, ANZH dhe BERZH.

Gjatë vitit 2025, si rezultat i mosfunksionalitetit të Kuvendit nuk janë ratifikuar kredi të reja.

Mangësi në shfrytëzimin e kredive të jashtme

Bazuar në aneksin 21.1 të RVF të BRK-së për shpалosjen e borxhit të jashtëm, për pesë (5) projekte/kredi në vlerë totale prej 137,300,000€, të ratifikuara përgjatë viteve 2022 deri 2024, nuk janë tërhequr mjete fare. Në raport me vitin paraprak numri i kredive që nuk kishin tërheqje fare është ulur nga 10 në pesë (5) kredi (vlera e kredive që nuk kishin tërheqje fare në 2024 është 196,800,000€). Projektet kishin afat realizimi apo përmbushje duke filluar nga viti 2024 deri në vitin 2031.

Kreditë e ratifikuara të cilat nuk kishin disbursim/tërheqje të mjeteve deri në fund të vitit 2025

1. Projekti për Impiantin e Ujërave të Zeza në Mitrovicë, kreditori BEI, zbatues i projektit është Komuna e Mitrovicës, në vlerë prej 19,800,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2022 (me afat të realizimit në dhjetor 2026);
2. Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10B, kreditori BEI, zbatues i projektit është Infrakosi, në vlerë prej 38,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2023 (me afat të realizimit në dhjetor 2024);
3. Zhvillimi i Sektorit të Energjisë VII – Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit, kreditori KfW, zbatues i projektit është KOSTT-i, në vlerë prej 25,500,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2023 (me afat të realizimit në dhjetor 2027);
4. Programi i Energjisë Solare i (Solar4kosovo I) Fotovoltaik, kreditori KfW, zbatues i projektit është KEK-u, në vlerë prej 29,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2024 (me afat të realizimit në dhjetor 2027);
5. Banimi Social Adekuat, kreditori BZHKE, zbatues i projektit është MMPHI-ja, në vlerë prej 25,000,000€, viti i ratifikimit të marrëveshjes 2024 (me afat të realizimit në dhjetor 2031);

Kreditë e ratifikuara të cilat kishin vonesa në disbursimin e mjeteve deri në fund të vitit 2025

Për tetë (8) kreditë e ratifikuara në vlerë prej 193,100,000€, që kanë vonesa më të theksuara e të cilat kanë afat përmbjlljeje duke filluar nga viti 2022 deri në vitin 2028, niveli i tërheqjeve deri në fund të vitit 2025 ishte vetëm 21,470,000€ apo 11%.

1. Kredia për Projektin “Rehabilitimi i rrugëve rajonale” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (ratifikuar në vitin 2016) në vlerë 29,000,000€ ishte tërhequr në vlerë prej 15,500,000€;
2. Kredia për Projektin “Trajtimi i ujërave të zeza në Prishtinë” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, (ratifikuar në vitin 2017) në vlerë prej 66,000,000€ ishin tërhequr vetëm 530,000€;
3. Kredia për Projektin “Impianti i ujërave të zeza në Gjiłan” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, (ratifikuar në vitin 2021) në vlerë prej 11,000,000€ ishin tërhequr vetëm 200,000€;
4. Kredia për Projektin “Rindërtimi dhe zhvillimi për projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Gjiłan” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e ratifikuar në vitin 2020 nga vlera prej 10,000,000€ janë tërhequr vetëm 100,000€;
5. Kredia për Projektin “Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit”, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (ratifikuar në vitin 2022) në vlerë prej 25,100,000€ ishin tërhequr vetëm 4,640,000€;

6. Kredia për Projektin “Trajtimi i ujërave të zeza në Mitrovicë”, në mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, (ratifikuar në vitin 2022) në vlerë prej 13,500,000€ ishin tërhequr vetëm 140,000€;
7. Kredia për Projektin “Forcimi i qeverisjes digjitale për Ofrimin e Shërbimeve” në mes të Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, (ratifikuar në vitin 2024) në vlerë prej 18,500,000€ ishin tërhequr vetëm 160,000€; dhe
8. Kredia për Projektin “Trajtimi i ujërave të zeza në Ferizaj”, në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, (ratifikuar në vitin 2024) në vlerë prej 20,000,000€ ishin tërhequr vetëm 200,000€.

Për projektet e lartpërmendura, organizatat zbatuese të projekteve përkatëse raportojnë çdo 3 muaj në MF, si dhe për të njëjtat, MF-ja raporton çdo 6 muaj në Qeveri mbi rrjedhën e ecurisë së realizimit të këtyre projekteve. Raportimet nga njësitë implementuese të projekteve janë formale dhe jo të mirëfillta, duke mos i listuar në mënyrë të detajuar shkaqet dhe pengesat që paraqiten në terren në realizimin e këtyre projekteve, që të pasqyrojnë veprimet konkrete në eliminimin e tyre.

Vonesat në tërheqjen e fondeve në dispozicion, janë pasojë e planifikimit të dobët, procesit të shpronësimit, lëvizjet e çmimeve të tregut dhe mungesës së kapaciteteve qeveritare për t'i shfrytëzuar në kohë dhe në mënyrë efektive fondet e huamarrjes.

Borxhi i brendshëm

Qeveria ka filluar marrjen e borxhit të brendshëm përmes emetimit të letrave me vlerë nga janari i vitit 2012. Ky borxh paraqet katalizatorin kryesor në financimin e deficitit buxhetor.

Në vitin 2025, borxhi i brendshëm është 961,050,000€, ku në raport me vitin paraprak ka shënuar rënie për 1,150,000€.

Tabela 4 - Borxhi i Brendshëm në tre vitet e fundit ('000 në €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Emetimet e Reja	-1,150	-7,993	-141,810
Stoku i Borxhit të Brendshëm	961,050	962,200	970,190
Borxhi i brendshëm sipas % së BPV-së	8.71%	9.34%	10.02%
BPV nga ASK	11,026,350	10,305,400	9,680,070

Në vitin 2025 vlera e letrave me vlerë që kanë maturu ishte 244,430,000€, ndërsa për rifinancim janë emetuar 243,280,000€.

Tabela 5 - Shpalosje për Emetimet e Reja të Letrave me Vlerë ('000 në €)

Borxhi i Brendshëm (neto)		Viti 2025
Maturimet		-244,430
Emetimet		243,280
Diferenca		-1,150

Përveç bankave komerciale dhe fondeve pensionale që janë akterët primarë, letra me vlerë mbajnë edhe investitorë të tjerë fizikë dhe juridikë (biznese dhe individë privat). Në vijim janë prezantuar në tabelë mbajtësit e letrave me vlerë në tri vitet e fundit.

Tabela 6 - Mbajtësit e Letrave me Vlerë - vlerë nominale ('000 në €)

Instrumenti	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Bankat Komerciale	248,400	229,220	231,500
Fondet Pensionale	394,320	434,920	444,540
Institucionet Publike	234,830	215,580	216,600
Kompanitë e Sigurimeve	50,270	51,880	50,330
Të tjerë	35,220	33,810	29,690
Totali	963,040	965,410	972,660

Garancitë shtetërore

Në vitin 2025 portofoli i garancive shtetërore përbëhet nga një garanci shtetërore e emetuar.

Kjo garanci është emetuar në vitin 2016 në vlerë prej 10,000,000€ për kredinë e huazuar nga ndërmarrja publike lokale Trafiku Urban nga BERZH-i. Deri në fund të vitit 2025, huamarrësi kishte kthyer 7,450,000€ të kredisë.

Tabela 7 - Gjendja e garancive shtetërore ('000 në €)

Përshkrimi	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Garancitë Shtetërore	2,550	3,570	28,590
BERZH Garancia për Trafikun Urban-Prishtinë	2,550	3,570	4,590
BERZH Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK	0	0	24,000
Garancitë Shtetërore sipas % së BPV-së	0.02%	0.03%	0.30%

Rekomandime për Qeverinë

- Qeveria duhet të sigurojë që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, të bëhen analiza të hollësishme dhe përgatitje të duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve; dhe
- Në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe organizatat zbatuese, duhet të sigurojë shqyrtim të vazhdueshëm të projekteve me ngecje ose mosrealizim duke identifikuar barrierat dhe të ndërmarrë veprime për eliminimin e tyre. Po ashtu, përmes MF-së të adresohen sfidat e identifikuara në raportet tremujore nga organizatat zbatuese dhe të merren masa konkrete për përsheptimin e zbatimit të tyre dhe realizimin e përfitimeve publike.

5. Analiza e buxhetit të shtetit

Të dhënat e prezantuara në Raportin Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës janë reflektim i projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit për vitin 2025 dhe si rrjedhojë e pranimeve dhe pagesave kundrejt ndarjeve përkatëse buxhetore.

Projeksionet fillestare dhe finale për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore Nr.08/L-332 ishin në vlerë prej 3,835,225,000€ dhe nuk kishin ndryshuar gjatë vitit. Derisa realizimi i të hyrave/pranimeve për vitin 2025 ishte në vlerë prej 3,512,430,000€ apo 92% e buxhetit final. Krahasuar me realizimin e vitit 2024 pranimet janë rritur për 278,341,000€, apo rreth 9%.

Buxheti fillestar për shpenzime ishte 3,782,398,000€, kurse buxheti final ishte në vlerë prej 3,847,789,000€ i cili ishte realizuar në vlerë prej 3,486,638,000€ apo 91% e buxhetit final. Krahasuar me vitin 2024 kishte rritje të shpenzimeve për 291,059,000€ apo 9%.

Buxheti final për shpenzime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur në vlerë prej 65,391,000€. Këto lëvizje buxhetore, vijnë nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë prej 56,867,000€ nga grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë prej 12,138,000€ dhe zvogëlimet prej -3,614,000€, nga ndryshimet sipas LMFPP-së.

Informatat në detaje mbi buxhetin fillestar, final dhe realizimin janë prezantuar në tabelat në vijim.

Tabela 8 - Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizim (në '000€)

Nr.	Zërat Buxhetor	Realizimi	Sipas Buxhetit Final	Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-332 viti 2025
1	Tatimet direkte	559,286	586,339	586,339
2	Tatimet indirekte	2,490,359	2,431,367	2,431,367
3	Kthimet	-76,661	-91,343	-91,343
4	Të hyrat jotatimore	339,568	356,571	356,571
5	Grantet dhe ndihmat	30,687	22,500	22,500
6	Financimi nga huamarrja	145,953	518,491	518,491
7	Pranimet tjera	23,239	11,300	11,300
Total pranimet		3,512,430	3,835,225	3,835,225
1	Paga dhe mëditje	910,133	914,185	916,920
2	Mallra dhe shërbime	466,586	515,319	502,233
3	Shpenzime komunale	32,048	35,013	34,757
4	Subvencione dhe Transfere	1,230,710	1,246,738	1,156,723
5	Shpenzimet kapitale	720,059	887,409	931,300
6	Rezerva	-	583	4,062
7	Interesi	50,884	49,507	49,507
8	Të tjera	76,218	199,036	186,897
Total pagesat		3,486,638	3,847,789	3,782,398
Rritja/zvogëlimi i parësë së gatshme		25,792	(12,564)	52,828

Sipas Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, rezervat janë buxhetuar në vlerë prej 4,061,660€ prej tyre në nivel qendror 3,636,965€ dhe nivel lokal 424,695€.

Pjesa më e madhe e rezervave është shpërndarë për nivelin qendror, ku mjetet në vlerë prej 3,012,000€ janë shpërndarë duke u bazuar në vendimin e Qeverisë, për mbulimin e pagesës sipas Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit për rastin ICSID⁴. Pjesa tjetër prej 281,875€ është shpërndarë përmes vendimeve qeveritare për përkrahje financiare për qëllime të ndryshme.

Pjesa e nivelit lokal prej 185,249€ janë shpërndarë për financimin e projekteve kapitale.

Në buxhetin final kanë mbetur si mjete të lira 582,536€ (343,090€ të nivelit qendror dhe 239,446€ të nivelit lokal).

4 Rasti në lidhje me privatizimin e Hotel Grandit në Prishtinë

5.1. Analiza e të hyrave/pranimeve sipas kategorive ekonomike

Projeksionet për të hyrat/pranimet, sipas Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-332 për vitin 2025 ishin në vlerë prej 3,835,225,000€, ndërsa realizimet ishin në vlerë prej 3,512,430,000€ apo 92% e planifikimit të tyre.

Pasqyra më poshtë ofron informata më në detaje për buxhetin fillestar, final dhe trendet e realizimeve gjatë tre viteve të fundit.

Tabela 9 - Pranimet sipas burimit sipas RVF/BRK-së ('000 në €)

Pranimet	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2025	Realizimi 2024	Realizimi 2023
Tatimet direkte	586,339	586,339	559,286	517,168	490,294
Tatimet indirekte	2,431,367	2,431,367	2,490,359	2,297,114	2,076,882
Kthimet	-91,343	-91,343	-76,661	-74,131	-61,277
Të hyrat jotatimore	356,571	356,571	339,568	337,939	266,881
Grantet dhe ndihmat	22,500	22,500	30,687	9,929	81,323
Financimi nga huamarrja	518,491	518,491	145,953	123,306	-36,845
Pranimet tjera	11,300	11,300	23,239	22,764	48,382
Total	3,835,225	3,835,225	3,512,430	3,234,089	2,865,640

Në tre vitet e fundit, ka një trend të rritjes së të hyrave buxhetore. Në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024, realizimi i të hyrave/pranimeve është më i lartë për 278,341,000€ apo 9%, ndërsa në raport me vitin 2023, realizimi është më i lartë për 646,790,000€ apo 23%.

Tatimet direkte

Tatimet direkte përbëhen prej katër kategorive: tatimi në të ardhura të korporatave (TAK), tatimi në të ardhura personale (TAP), tatimi në pronë (TP), si dhe tatime tjera. Realizimi i tatimeve direkte ishte në vlerë prej 559,286,000€ apo rreth 95% e shumës së planifikuar me buxhetin vjetor për këtë kategori të të hyrave.

Burim kryesor i tatimeve direkte ishte: tatimi në të ardhura personale me 300,604,000€ apo 54%, tatimi në të ardhura të korporatave me 219,484,000€ apo 39%, tatimi në pronë me 39,142,000€ apo 7% si dhe tatimet tjera direkte ishin 56,000€. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa tatimi në pronë nga komunat. Krahasuar me vitin 2024, tatimet direkte kanë shënuar rritje për 42,118,000€ apo 8%, ndërsa 68,992,000€ apo 14% krahasuar me vitin 2023.

Tatimet indirekte

Burimet kryesore të tatimeve indirekte janë: tatimi në vlerën e shtuar (TVSH), detyrimi doganor, akcizat dhe tatimet tjera indirekte. Realizimi për këtë kategori të të hyrave ishte 2,490,359,000€ apo 58,992,000€ më shumë se buxheti final i planifikuar. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 1,649,892,000€ apo rreth 66% e realizimit total, akcizat 653,275,000€ apo 26%, taksat doganore 185,914,000€ apo 7%, dhe tatimet tjera indirekte prej 1,278,000€, apo rreth 1%. Krahasuar me vitin 2024, tatimet indirekte kanë shënuar rritje për 193,245,000€ apo 8%, ndërsa krahasuar me vitin 2023, rritja është për 413,477,000€ apo rreth 20%.

Kthimet tatimore

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të shumave të paguara nga tatimpaguesit mbi shumën e detyrimit tatimor. Me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-në dhe Doganën, përlllogariten diferencat, dhe si të tilla u kthehen subjekteve të ndryshme pas shqyrtimit të kërkesave për rimbursim.

Sipas buxhetit, shuma e kthimeve ishte planifikuar në vlerën prej 91,343,000€, ndërkaq shumat e kthyer deri në përfundim të vitit fiskal ishin 76,661,000€ apo 84 % e planit. Prej tyre, vlera e kthimeve nga ATK-ja ishte 73,282,000€, kurse 3,379,000€ janë kthimet nga Dogana. Në krahasim me vitin 2024, kthimet e tatimeve ishin për 2,530,000€ më të larta apo për 3 %.

Të hyrat jotatimore

Në kategorinë e të hyrave jotatimore bëjnë pjesë të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, llojet e ndryshme të gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj. Të hyra jotatimore mbliidhen nga niveli qendror, niveli lokal dhe agjencitë e pavarura buxhetore.

Të hyrat jotatimore për vitin 2025 sipas Ligjit të Buxhetit fillestar dhe final ishin në vlerë prej 356,571,000€⁵.

Realizimi i të hyrave jotatimore gjatë vitit 2025 ishte 339,568,000€ apo 95% e planit. Prej tyre, 170,454,000€ ishte shuma e mbledhur nga niveli qendror, nga niveli lokal 81,656,000€, nga rentat minerare ishte 25,467,000€, nga taksa koncesionare 42,634,000€, nga të hyrat nga interesi i kredive për ndërmarrje publike 3,940,000€ si dhe nga të hyrat nga dividendat 15,417,000€.

Trendi tregon se të hyrat jotatimore kanë shënuar rritje për 1,629,000€ krahasuar me vitin 2024, dhe për 72,687,000€ në raport me vitin 2023.

⁵ Në nivelin qendror ishin planifikuar rreth 190.9 milion€, në nivelin lokal 70milion€. Pjesa tjetër e planifikuar përfshinë: Rentën minerare rreth 30.3 milion€, taksa koncesionare rreth 42 milion€, të hyrat nga dividendat rreth 10 milion€ si dhe të hyrat nga interesi rreth 13.3 milion€.

Grantet dhe ndihmat

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes të Qeverisë dhe donatorëve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme.

Shuma e granteve sipas Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-332 për ndarjet buxhetore dhe buxhetin final për vitin 2025, duke përfshirë grantet për mbështetje buxhetore, ishte planifikuar në vlerë prej 22,500,000€. Realizimi i granteve ishte 30,687,000€.

Financimi nga huamarrja

Si burim për financimin e pagesave buxhetore, me Ligjin e Buxhetit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financojë nga huamarrjet.

Pranimet nga huamarrja ishin planifikuar në vlerë prej 518,491,000€, prej tyre, huamarrja e jashtme ishte në vlerë prej 418,491,000€, ndërsa huamarrja e brendshme ishte në vlerë prej 100,000,000€.

Pranimet tjera

Pranimet tjera përbëhen nga financimi i njëhershëm i AKP-së, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e dedikuara dhe pranimet nga depozitat. Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-332, pranimet tjera ishin planifikuar në vlerë prej 11,300,000€.

Realizimi i pranimeve tjera ishte në vlerë prej 23,239,000€, prej të cilave: kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 12,363,000€, të hyrat e dedikuara në vlerë 6,809,000€ dhe pranimet nga depozitat në vlerë prej 4,045,000€, financimi i njëhershëm nga AKP-ja është 22,000€.

5.2. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Buxheti final për shpenzimet e përgjithshme ishte në vlerë prej 3,847,789,000€, ndërsa realizimi ishte 3,486,638,000€ apo 91% e buxhetit. Krahësuar me vitin 2024, pagesat janë rritur për 291,059,000€, ndërsa me vitin 2023 janë rritur për 560,640,000€.

Tabela 10 - Pasqyra e pagesave krahasuar me dy vitet e fundit ('000 në €)⁶

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2025	Realizimi 2024	Realizimi 2023
Pagat dhe shtesat	916,920	914,185	910,622	843,599	767,305
Mallrat dhe shërbimet	502,233	515,319	470,357	432,514	397,978
Shërbimet komunale	34,757	35,013	32,049	29,250	28,779
Subvencionet dhe transferet	1,156,723	1,246,738	1,232,533	1,114,605	1,079,450
Investimet kapitale	931,300	887,409	729,448	654,626	560,868
Shpenzimet e interesit	49,507	49,507	50,884	42,215	42,215
Rezervat	4,062	583	-	-	-
Të tjera	186,897	199,036	60,745	78,770	49,403
Total	3,782,398	3,847,789	3,486,638	3,195,579	2,925,998

Në vijim paraqitet realizimi i shpenzimeve sipas kategorive si dhe krahasimet me vitet e kaluara.

Pagat dhe shtesat

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore prezantohen si një ndër kategoritë me përqindje të lartë të shpenzimeve me 26%. Buxheti final për vitin 2025 ishte 914,185,000€, ndërsa shpenzimet 910,622,000€ apo mbi 99% e buxhetit. Krahësuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 67,023,000€ që ka ndodhur për shkak të rritjes së pagave dhe rritjes të numrit të përgjithshëm të të punësuarve për 1,304 punonjës.

Po ashtu, edhe këtë vit janë realizuar pagesa në mungesë të vijueshmërisë së plotë në punë për punonjësit e angazhuar sipas marrëveshjes së Brukselit. Numri i tyre ishte 80, kurse vlera e pagesave për vitin 2025 ishte 589,884€. Në raport me vitin e kaluar numri i tyre ishte zvogëluar për 21 kurse pagesa janë zvogëluar për 101,166€.

⁶ Vlerat në tabelë sipas kategorive ekonomike, përfshijnë edhe grantet e donatorëve.

Mallrat dhe shërbimet

Në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve buxhetore marrin pjesë me rreth 13%. Buxheti final për vitin 2025 ishte 515,319,000€, ndërsa shpenzimet 470,357,000€ apo rreth 91% e buxhetit. Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të shpenzimeve për 37,843,000€.

Shërbimet komunale

Buxheti final për vitin 2025 ishte 35,013,000€, ndërsa shpenzimet 32,049,000€ apo rreth 92% e buxhetit. Zërat të cilat e përfshijnë këtë kategori janë: shpenzimet e rrymës, ujit, mbeturinave, ngrohja qendrore dhe shpenzimet e telefonisë fikse.

Subvencionet dhe transferet

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 35% që njëherit prezanton kategorinë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Buxheti final për vitin 2025 ishte 1,246,738,000€, kurse shpenzimet ishin 1,232,533,000€ apo rreth 99% e buxhetit. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 117,928,000€. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së subvencionimit për skemat e ndryshme në kuadër të kësaj kategorie.

Investimet kapitale

Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme investimet kapitale marrin pjesë me rreth 21%. Buxheti final për këtë kategori ishte 887,409,000€, kurse shpenzimet ishin 729,448,000€ apo rreth 82% e buxhetit për investime kapitale. Krahasuar me vitin 2024 ka një rritje të shpenzimeve për 74,822,000€.

Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, si dhe shërbimeve tjera publike.

Menaxhimi i projekteve kapitale bëhet përmes Programit për Investime Publike (PIP). Planifikimi i projekteve në PIP duhet të bëhet në mënyrë të detajuar dhe të aprovohet nga krerët e organizatave, bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre. Në anën tjetër, MF-ja aprovon këto kërkesa të OB-ve duke u bazuar në dokumentet e paraqitura në PIP në lidhje me arsyeshmërinë dhe duke siguruar se janë në përgjegjësi dhe kompetencë të tyre.

Në gjashtë komuna, janë evidentuar 82 pagesa për projekte në vlerë të përbashkët prej 11,617,488€, ku fondet e dedikuara për projekte specifike janë përdorur për qëllime të tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar, pa u zbatuar procedurat dhe kriteret për transferimin ose rialokimin e ndarjeve buxhetore dhe pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Pjesa më e madhe e këtyre rasteve është evidentuar në:

- Komunën e Prishtinës, në 46 pagesa në vlerë prej 10,192,709€,
- Komunën e Malishevës, në 19 pagesa në vlerë prej 805,212€, dhe
- Komunën e Suharekës, në 11 pagesa, në vlerë prej 457,039€.

Ndryshimet e tilla të ndarjeve buxhetore pa miratimin e Kuvendit Komunal zvogëlojnë transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e fondeve publike dhe mund të ndikojnë negativisht në realizimin e projekteve për të cilat fondet ishin planifikuar fillimisht.

Po ashtu, katër komuna kishin hyrë në obligime kontraktuale për projekte të ndryshme, pa siguruar paraprakisht fonde të mjaftueshme buxhetore, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Vlera e përgjithshme e obligimeve kontraktuale pa mbulesë buxhetore ishte 19,442,470€. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve është evidentuar në:

- Komunën e Prishtinës me vlerë prej 17,134,523€,
- Komunën e Ferizajt me vlerë prej 1,137,131€,
- Komunën e Kaçanikut me vlerë prej 614,874€, dhe
- Komunën e Malishevës me vlerë prej 555,942€.

Shpenzimet e interesit, rezervat dhe pagesat tjera

Për këto kategori janë buxhetuar gjithsej 249,126,000€ ndërsa janë realizuar pagesa në vlerë prej 111,629,000€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet e interesit, pagesat për kthimin e borxhit dhe nën huazimeve, pagesat për kapitalizim dhe blerje të aksioneve, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimi i depozitave.

Rekomandime për Qeverinë

- Përmes MF-së të sigurojë mekanizma efektivë të kontrollit dhe mbikëqyrjes, me qëllim të parandalimit të përdorimit të ndarjeve buxhetore për qëllime të tjera nga ato të planifikuara dhe të hyrjes në obligime kontraktuale pa mbulesë të mjaftueshme buxhetore nga komunat; dhe
- Përmes ministrive përkatëse, duhet të vazhdojë ndërmarrjen e veprimeve për adresimin e rasteve të punonjësve që nuk kanë vijueshmëri në punë, të analizojë situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhjeje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

5.2.1. Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve

Sipas Rregullës financiare Nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Sipas Ligjit për Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332, neni 15, paragrafi 12, ndarjet buxhetore nga rezervat ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e detyrimeve sipas vendimeve përmbartimore dhe gjyqësore, me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Gjithashtu, bazuar në Qarkoren Buxhetore Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), pika 3 “Kufijtë buxhetorë për komunat”, përcaktohet se në kolonën “Rezervat”, komunat duhet të planifikojnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve. Mjetet për mbulimin e këtyre detyrimeve duhet të ndahen brenda kufijve buxhetorë të përcaktuar për komunat me këtë qarkore, duke përfshirë përdorimin e kategorisë ekonomike “Pagat dhe Shtesat”.

Edhe pse MFPT-ja ka ndërmarrë masa për adresimin e rekomandimit përmes përcaktimit të mundësisë së planifikimit të mjeteve në kategorinë “Rezerva” për këtë qëllim, organizatat buxhetore nuk e kanë zbatuar këtë kërkesë gjatë procesit të planifikimit buxhetor për vitin 2025. Kjo ka ndikuar që pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore të mbulohen nga kategori të tjera ekonomike, duke rezultuar në vazhdimin në rritje të keqklasifikimeve.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve në vitin 2025 ka arritur vlerën prej 77,365,811€, duke evidentuar mangësi të vazhdueshme në regjistrimin e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike. Nga kjo shumë, 27% i përket nivelit qendror, ndërsa 73% nivelit lokal.

Krahasuar me vitin paraprak, vlera e keqklasifikimeve është rritur për 42,111,170€, ose 119%, pasi në vitin 2024 ajo ishte 35,254,641€. Në rritjen e vlerës së klasifikimit joadekuat të shpenzimeve ka ndikuar mosekzekutimi i pagesave nga kategoria “Pagat dhe shtesat” për vendime gjyqësore që burojnë nga kontrata kolektive.

Tabela nr. 11 - Klasifikimet joadekuate të shpenzimeve të bëra në kategori të ndryshme ekonomike (në €)

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB-ja	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Mallrat, shërbimet dhe komunalitë	Investimet kapitale	740,825	733,613	794,654	2,269,092
	Pagat dhe shtesat	1,061,962	15,702	12,898,041	13,975,705
	Subvencionet dhe transferet	251,894	-	55,262	307,156
Gjithsej Mallrat, shërbimet dhe komunalitë		2,054,681	749,315	13,747,957	16,551,953

Subvencionet dhe transferet	Investimet kapitale	-	-	309,138	309,138
	Mallrat, shërbimet dhe komunalitë	257,538	-	822,211	1,079,749
	Pagat dhe shtesat	-	-	2,391,876	2,391,876
Gjithsej Subvencionet dhe transferet		257,538	-	3,523,225	3,780,763
Investimet Kapitale	Mallrat, shërbimet dhe komunalitë	6,528,607	1,189,883	3,043,558	10,762,048
	Pagat dhe shtesat	4,516,847	-	37,866,362	42,383,209
	Subvencionet dhe transferet	1,003,182	2,592,587	292,069	3,887,838
Gjithsej Investimet kapitale		12,048,636	3,782,470	41,201,989	57,033,095
Gjithsej Keqklasifikimi për vitin 2025		14,360,855	4,531,785	58,473,171	77,365,811

Kategoria më e prekur nga klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishin Investimet Kapitale, me vlerë prej 57,033,095€ (74% e totalit). Pas saj, renditet kategoria Mallrat dhe Shërbimet, me 16,551,953€ (21%), ndërsa Subvencionet dhe Transferet përbëjnë 3,780,763€ (5%).

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte ndikuar kryesisht nga:

- Pagesat e realizuara nga Thesari (në përputhje me nenin 40 të LMFP-së), përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore me 58,473,171€ apo 76%;
- Planifikimi jo i duhur i buxhetit me 4,531,785€ apo 6%; dhe
- Shpenzimet e bëra nga vetë organizatat buxhetore në kategori ekonomike të gabuara me 14,360,855€ apo 18%.

Në vijim janë paraqitur Organizatat me vlerën më të lartë të klasifikimeve joadekuate buxhetore, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

Tabela 12 - Niveli qendror, vlerat (në €)

Entiteti	Ishte regjistruar në kategori të gabuar	Duhej të regjistrohej në kategorinë	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
MPB	Investimet kapitale	Pagat dhe shtesat	10,065,651	Pagesat janë realizuar me vendime gjyqësore/permbarimore dhe kryesisht kanë të bëjnë me pagesat për pagën shtesë të Policisë për vitet paraprake.
SHSKUK	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	2,592,587	Nga kategoria e investimeve kapitale, ishin realizuar pagesa për furnizime me produkte për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë ndonëse i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve.
MMPHI	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	2,662,042	Nga kategoria e investimeve kapitale janë realizuar pagesa për shpenzime të interesit, permbarimit dhe shpenzimet e sinjalizimit të rrugëve.
MASHT	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet	1,055,207	Blerja e pajisjeve nën 1000€, pajisje sportive dhe inventarit për shkolla.
	Mallrat dhe shërbimet	Pagat dhe shtesat	939,262	Janë realizuar pagesa për paga jubilarë dhe shujta si rezultat i kontratës kolektive.

Tabela 13 - Niveli lokal, vlerat (në €)

Entiteti	Ishte regjistruar në kategori të gabuar	Duhej të regjistrohej në kategorinë	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
Komuna e Ferizajt	Investimet kapitale	Pagat dhe shtesat	4,548,263	Janë realizuar pagesa për paga jubilarë dhe shujta si rezultat i kontratës kolektive.
Komuna e Prishtinës	Investimet kapitale	Mallrat dhe shërbimet si dhe komunalitë	3,218,054	Pagesat kishin të bënin për energji elektrike, transport publik, sigurimin fizik, mbeturina, mirëmbajtjen dhe sinjalizimin e rrugëve etj.
Komuna e Podujevës	Investimet kapitale	Pagat dhe shtesat	2,601,921	Janë realizuar pagesa për paga jubilarë dhe shujta dhe kualifikim për arsimtarë si rezultat i kontratës kolektive.
Komuna e Gjakovës	Investimet kapitale	Pagat dhe shtesat	2,474,282	Janë realizuar pagesa për paga jubilarë dhe shujta dhe kualifikim për arsimtarë si rezultat i kontratës kolektive.
Komuna e Mitrovicës së Jugut	Investimet kapitale	Pagat dhe shtesat	2,441,273	Janë realizuar pagesa për paga jubilarë dhe shujta dhe kualifikim për arsimtarë si rezultat i kontratës kolektive.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MF-së, të sigurojë kontrolle efektive në procesin e buxhetimit dhe realizimit të shpenzimeve në kategoritë adekuate. Po ashtu, të analizojë arsyet e moszbatimit të kërkesave të Ligjit për Ndarjet Buxhetore dhe të Qarkores Buxhetore nga organizatat buxhetore për planifikimin e mjeteve në kategorinë “Rezerva” për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore dhe përmbarimore.

5.3. Analiza e shpenzimeve sipas funksionit

Shpenzimet sipas funksionit përfshijnë shërbimet publike, mbrojtjen, rendin dhe sigurinë publike, çështjet ekonomike, mbrojtjen e mjedisit, komoditetet e banimit dhe të bashkësisë, shëndetësinë, rekreacionin, kulturën dhe religjionin, arsimin, si dhe mbrojtjen sociale.

Tabela 14 - Pasqyra e pagesave sipas funksionit në tre vite (‘000 në €)

KF	Përshkrimi	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
01	Shërbimet e përgjithshme publike	421,043	391,973	429,725
02	Mbrojtja	107,177	113,829	98,135
03	Rendi dhe siguria publike	306,243	291,870	266,377
04	Çështjet ekonomike	585,111	565,183	499,052
05	Mbrojtja e mjedisit	7,932	7,409	7,883
06	Komoditetet e banimit dhe të bashkësisë	64,622	58,511	50,554
07	Shëndetësia	357,568	320,008	298,441
08	Rekreacioni, kultura dhe religjioni	113,839	104,775	80,416
09	Arsimi	457,124	446,862	395,099
10	Mbrojtja sociale	954,355	774,175	708,698
	Total ⁷	3,375,014	3,074,595	2,834,380

Shpenzimet sipas funksionit ishin në vlerë prej 3,375,014,000€ e që në raport me vitin paraprak kanë shënuar një rritje prej 300,419,000€.

Te shumica e shpenzimeve sipas funksionit vërehet trendi në rritje i shpenzimeve nga viti paraprak e që rritje më të lartë kishte te mbrojtja sociale me 180,180,000€, te shëndetësia me 37,560,000€, te shërbimet e përgjithshme publike 29,070,000€ si dhe te çështjet ekonomike me 19,928,000€.

7 Në total nuk përfshihen pagesat tjera: pagesa e borxhit, kredidhënia për ndërmarrjet publike dhe kthimet nga fondet e depozitave

Shpenzimet sipas funksionit janë prezantuar bazuar në shënimet e SIMFK-së. Nga analiza e shpenzimeve vërehet se ka shpenzime të cilat nuk janë klasifikuar drejt sipas funksionit. Rasti më i theksuar dhe i përsëritur edhe këtë vit është regjistrimi i shpenzimeve prej 83,669,641€ të cilat i takojnë mbrojtjes përderisa ishin të regjistruara gabimisht te shërbimet e përgjithshme publike.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MF-së të sigurojë se planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.

5.4. Analiza e pakos për rimëkëmbjen ekonomike

Gjatë vitit 2025, Qeveria ka financuar tre programe për mbështetjen ekonomike: Pakon Emergjente, Pakon e Ringjalljes Ekonomike dhe Kontingjencat e BE-së për Energji. Mjetet për këto programe janë ndarë me vendime të Qeverisë, në përputhje me autorizimet e Ligjit për Buxhetin për vitin 2025.

Për këto programe ishin buxhetuar gjithsej 48,435,216€, ndërsa ishin shpenzuar 47,510,785€, apo 98% të mjeteve të buxhetuara. Krahasuar me vitin 2024, kur ishin shpenzuar 112,408,068€, vërehet një zvogëlim në vitin 2025 prej 64,897,283€ në nivelin e shpenzimeve për këto programe.

Tabela 15 - Pako Emergjente, Pako e Ringjalljes Ekonomike dhe Kontingjencat e BE-së për Energji (në €)

Përshkrimi	Buxheti 2025	Realizimi 2025	Realizimi 2024
Kontingjencat e BE-së për Energji (00097)	895,668	895,668	27,779,253
Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (00098)	47,394,088	46,474,117	84,290,745
Pakoja Emergjente (00099)	145,461	141,000	338,070
Gjithsej	48,435,217	47,510,785	112,408,068

Shpenzimet për këto programe ekonomike janë realizuar nga niveli qendror dhe janë shpërndarë si më poshtë:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka shpenzuar 43,827,552€. Kjo vlerë përfshin zbatimin e masës 3.6 në mbështetje të likuiditetit familjar, mbështetjes së studentëve, masës 4.5 në mbështetje të mërgatës nga Pako e Ringjalljes Ekonomike, si dhe masave 4 dhe 5 të Planit të veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, masës 3.7 në mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të financuara nga Kontingjencat e BE-së për energji;
- Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) ka shpenzuar 1,941,431€. Kjo vlerë përfshin përkrahjen dhe zhvillimin e komuniteteve në fushën e bujqësisë, ekonomisë (bizneset e vogla) dhe fushën e shëndetësisë nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike;

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka shpenzuar 993,520€. Kjo vlerë përfshin subvencionimin e librave dhe të bursave nga Pako e Ringjalljes Ekonomike;
- Ministria e Ekonomisë (ME) ka shpenzuar 607,282€ për zbatimin e masës 4 - për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin në pajisje eficiente për ngrohje, dhe masës 5 - për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në investimin në sisteme të energjisë së ripërtëritshme të financuara nga Kontingjencat e BE-së për energji; dhe
- Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka shpenzuar 141,000€ për financimin e pajisjeve mjekësore si dhe shërbimeve farmaceutike post COVID, përkatësisht shërbimeve laboratorike nga Pako Emergjente.

Shpenzimet nga kontingjenca e BE-së për Energji janë ndarë nga MFPT-ja dhe ME-ja në Subvencione dhe Transfere dhe shkalla e realizimit të tyre ishte 100%.

Tabela 16 - Kontingjencat e BE-së për Energji (00097) sipas kategorive ekonomike (në €)

Kategoria ekonomike	Buxheti 2025	Realizimi 2025	Realizimi 2024
Mallrat dhe shërbimet	-	-	17,695
Subvencionet dhe transferet	895,668	895,668	27,761,557
Total	895,668	895,668	27,779,252

Shpenzimet nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike janë dhënë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve përmes MFPT-së, MASHTI-t dhe MKK-së dhe shkalla e realizimit të tyre ishte 98%.

Tabela 17 - Pagesat nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike (kodi 00098) sipas kategorive ekonomike (në €)

Kategoria ekonomike	Buxheti 2025	Realizimi 2025	Realizimi 2024
Subvencionet dhe transferet	47,394,088	46,474,117	84,290,745
Total	47,394,088	46,474,117	84,290,745

Shpenzimet nga Pakoja Emergjente, kanë të bëjnë me mjete të ndara për nevojat e Ministrisë së Shëndetësisë nga kategoria e investimeve kapitale dhe shkalla e realizimit të tyre ishte 97%.

Tabela 18 - Pagesat nga Pakoja Emergjente (00099) sipas kategorive ekonomike (në €)

Kategoria ekonomike	Buxheti 2025	Realizimi 2025	Realizimi 2024
Pagat dhe shtesat	-	-	38,782
Mallrat dhe shërbimet	2,372	-	990
Investimet kapitale	143,089	141,000	298,298
Total	145,461	141,000	338,070

5.5. Analiza e subvencionimit të Ndërmarrjeve Publike nga buxheti i shtetit

Financimi i ndërmarrjeve publike për vitin 2025 ishte në vlerë prej 11,394,186€ apo rreth 62% më pak krahasuar me vitin paraprak. Janë financuar 16 ndërmarrje publike, prej tyre katër ndërmarrje të nivelit qendror, shtatë janë rajonale si dhe pesë të nivelit lokal.

Nga analiza e orientimit të financimit vërehet se 79% ishin për financimin e NP-ve qendrore kurse pjesa tjetër për NP-të rajonale (17%) dhe lokale (4%).

Në vijim kemi paraqitur qëllimin e subvencionimit për disa nga ndërmarrjet publike qendrore si pranueset e pjesës më të madhe të financimit:

- Subvencionimi i NP-së "Trepça" - ishte për mbulimin e shpenzimeve operative si: pagat e punëtorëve, energjia elektrike, nafta furnizimi me lëndë dhe pajisje për ecurinë e prodhimit, mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve/makinerive, blerjen e mjeteve të punës etj;
- Subvencionimi i NP-së "Trainkos" - ishte për funksionalizimin e linjave të aprovuara për transportin e udhëtarëve gjatë periudhës fiskale pesëvjeçare 2023-2027 si dhe për financimin e shpenzimeve tjera operative të ndërmarrjes si: paga, qasja në binarë, për lëndë djegëse etj;
- Subvencionimi i Postës së Kosovës - ishte për kompenzimin e ofrimit të shërbimit universal postar; dhe
- Subvencionimi i NP-së "Infrakos" - ishte për financimin e shpenzimeve operative të ndërmarrjes si: paga, energjia elektrike etj.

Po ashtu, edhe qëllimi i financimit të NP-ve tjera rajonale dhe lokale ishte kryesisht për mbulimin shpenzimeve operative të tyre.

Ministria e Ekonomisë kishte pjesëmarrjen më të madhe në financimin e ndërmarrjeve publike, duke financuar rreth 91% të vlerës totale të subvencioneve.

Në tabelën në vijim paraqiten organizatat buxhetore financuese, ndërmarrjet publike përfituese dhe vlera e subvencioneve të ndara sipas nivelit të ndërmarrjes publike.

Tabela 19 - Subvencionimi i Ndërmarrjeve Publike (në €)

Nr.	Organizata Buxhetore Financuese	Ndërmarrja Publike Përfituese	Vlera
1	ME dhe MMPHI	Trainkos SH.A.	2,064,391
2	Ministria e Ekonomisë	Posta e Kosovës SH.A.	817,836
3	Ministria e Ekonomisë	Infrakos SH.A.	775,000
4	Ministria e Ekonomisë	Trepça SH.A.	5,320,332
	Totali		8,977,559
	Ndermarrjet Publike Rajonale		

1	Ministria e Ekonomisë	KRU Gjakova SH.A.	433,214
2	Ministria e Ekonomisë	KRU Hidroregjioni Jugor SH.A.	134,527
3	Ministria e Ekonomisë	KRU Hidrodrini SH.A.	248,992
4	Ministria e Ekonomisë	KRU Prishtina SH.A.	603,940
5	Ministria e Ekonomisë	KRU Bifurkacioni SH.A.	358,925
6	Ministria e Ekonomisë	KRU Drini i Bardhë SH.A.	4,888
7	Ministria e Ekonomisë	Hidromorava SH.A.	192,875
Totali			1,977,361
Ndermarrjet Publike Lokale			
1	Ministria e Ekonomisë	Ngrohtorja e qytetit	300,000
2	Komuna e Podujevës	NPL Eko Llapi	30,000
3	Komuna e Podujevës	NPL Pastrimi	29,266
4	Komuna e Obiliqit	NPL Kastrioti	50,000
5	Komuna e Skënderajt	NPL Eko Natyra SH.A.	30,000
Totali			439,266
Totali i përgjithshëm			11,394,186

Nga të dhënat rezulton se financimi kryesisht është në katër ndërmarrjet publike qendrore, të cilat kanë përfituar 8,977,559€ ose rreth 79% të shumës totale të subvencioneve. Përfituesi më i madh ishte Trepça SH.A., me 5,320,332€, që përbën rreth 47% të financimit të përgjithshëm.

6. Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit përfshin shumat e pashpenzuara të fondeve nga: paratë në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor i mirëbesimit, paraja e gatshme transit, Kuota në Institucionet Ndërkombëtare Financiare (INF), llogaritë e Misionëve Diplomatike të Republikës së Kosovës, paratë e gatshme (arka) dhe avancet e hapura.

Fondet për qëllime specifike përbëhen nga: Grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat vetanake të bartura, fondi i mirëbesimit për zhvillim, të hyrat e dedikuara, të tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave), dhe fondet e pashpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2025 dhe të bartura në vitin 2026.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Pjesa më e madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK).

Tabela 20 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve ('000 në €)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Banka Qendrore e Kosovës	419,526	395,911	345,232
Kuotat në INF	9,832	9,832	8,395
Fondi zhvillimor i mirëbesimit	3,862	3,837	3,566
Paraja në transit	6,382	7,223	22,894
Para në llogaritë e Misioneve Diplomatike	2,674	4,849	3,899
Para të gatshme (arka)	2,951	2,231	1,389
A. Gjithsej: pasuritë financiare në PG	445,228	423,884	385,375
Bilanci i fondeve	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Garantët e përcaktuara të donatorëve	8,321	7,675	17,472
Të hyrat vetiake të bartura NQ	1,803	2,000	3,027
Të hyrat vetiake të bartura në NL	45,615	57,515	81,387
Fondi zhvillimor në mirëbesim	3,807	3,782	3,510
Të hyrat e dedikuara	5,158	4,253	3,431
Grantet (kontingjenca) e BE-së për energji	-	-	22,740
Të hyrat tjera	35,189	33,832	29,060
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	6,571	6,953	6,226
B. Fonde për qëllime specifike	106,464	116,010	166,854
C. Të pashpërndara	338,764	307,874	218,522
Gjithsej fondet (B+C)	445,228	423,884	385,375

Pasuria financiare në para të gatshme dhe bilanci i fondeve në fund të vitit 2025 ishte 445,228,000€, me një rritje prej 21,344,000€ krahasuar me vitin 2024. Nga kjo shumë, 419,526,000€ ose 94% mbaheshin në llogaritë rrjedhëse në BQK.

Në RVF-2025 te Shënimi 43 - Paraja e gatshme dhe avancet e hapura te Organizatat Buxhetore, nuk kemi arritur të konfirmojmë gjendjen e saktë të avanceve të hapura te MPJD-ja, në raport me shënimet e SIMFK-së, në mungesë të evidencave të sakta dhe të qarta që i mbështesin vlerat e prezantuara.

Vlera e prezantuar e avanceve të hapura në RVF për MPJD-në ishte 1,568,000€. Lidhur me vlerat e prezantuara nuk kemi pranuar dëshmi mbështetëse që e konfirmojnë nëse këto vlera e prezantojnë gjendjen e saktë të avanceve të hapura për MPJD-në.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MF-së dhe MPJD-së, duhet të sigurojë kontrolle efektive në mënyrë që vlerat e raportuara të avanceve të hapura në RVF të jenë të mbështetura me evidenca të plota dhe të mjaftueshme.

7. Pasuritë jofinanciare kapitale, jokapitale dhe stoqet

Rregullorja MF Nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jofinanciare që vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit. Pasuritë jofinanciare sipas klasifikimit kontabël ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, kanë vlerë financiare mbi 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja;
- Pasuritë jokapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, kanë vlerë financiare më pak se 1,000€ dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB-ja; dhe
- Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materiali për zyre.

Menaxhimi i pasurive jofinanciare bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrat kontabël të SIMFK-së si sistem i integruar në kuadër të MF-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000€, si dhe sistemi/aplikacionit “e - Pasuria” që është një sistem i integruar në kuadër të MDAP-së, ku të gjitha organizatat buxhetore duhet të evidentojnë, menaxhojnë dhe raportojnë për pasuritë jokapitale nën 1,000€ dhe stoqet/pajisje rezervë dhe material zyre.

Rezultatet e auditimit tregojnë se raportet mbi pasuritë jofinanciare në vitin 2025 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorim të plotë mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive jofinanciare në sistemet për menaxhimin e pasurive në SIMFK dhe e-pasuri, janë jo të plota.

Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive jofinanciare janë duke vazhduar edhe më tutje si te institucionet e nivelit qendror dhe lokal duke mos i regjistruar saktë dhe raportuar drejtë pasuritë e tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Si rezultat, këto pasaktësi reflektohen edhe në Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë (RVF-BRK_2025), pavarësisht rekomandimeve të përsëritura ndër vite për përmirësimin e menaxhimit dhe forcimin e kontrolleve.

Organizatat buxhetore, kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PVF-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në RVF. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Tabela 21 – Pasuritë jofinanciare kapitale, jokapitale dhe stoqet në (€)

Pasuritë	Institucionet	Vlera neto e pasurisë në RVF-BRK 2025	Vlera neto e pasurisë sipas Auditimit	Mbivlerësimi/ Nënvlërësimi
Pasuritë kapitale mbi 1,000€	Niveli Qendror	3,527,143,789	3,487,502,945	39,640,844
	Niveli Lokal	7,064,887,650	7,070,949,079	-6,061,429
Pasuritë kapitale nën 1,000€	Niveli Qendror	48,634,206	50,226,482	-1,592,276
	Niveli Lokal	24,829,082	23,475,499	1,353,583
Stoqet	NQ+NI	59,365,934	59,159,768	206,166
Total		10,724,860,661	10,691,313,773	33,546,888

Pasuritë jofinanciare, sipas auditimit, në total ishin mbivlerësuar në vlerë neto për 33,546,888€. Nga kjo vlerë, në nivelin qendror pasuritë kapitale ishin mbivlerësuar për 39,640,844€, ndërsa në nivelin lokal ishin nënvlërësuar për 6,061,429€. Pasuritë jokapitale, në nivelin qendror, ishin nënvlërësuar për 1,592,276€, ndërsa në nivelin lokal ishin mbivlerësuar për 1,353,583€.

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK-së janë 59,365,934€, ndërsa sipas auditimeve individuale ishin 59,159,768€ me një mbivlerësim prej 206,166€.

Si rrjedhojë e të dhënave të mësipërme për mbivlerësimet dhe nënvlërësimet, konstatohet se bilanci në total i pasurisë jofinanciare, në krahasim me gjendjen e raportuar, ka treguar pasaktësi, me një mbivlerësim të vlerës neto prej 33,546,888€, (në vitin 2024 mbivlerësimi neto ishte (27,063,159€).

Niveli qendror

Në nivelin qendror, 19 organizata buxhetore, prej tyre 11 ministri dhe tetë institucione të pavarura kanë mbivlerësuar ose nënvlërësuar pasuritë jofinanciare të raportuara në PVF, duke mos i raportuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë pasuritë kapitale dhe jokapitale. Bilanci në total i vlerës neto së pasurisë, i prezantuar në RVF-BRK të vitit 2025 është mbivlerësuar për 39,640,844€,

Nga auditimet individuale ka rezultuar se disa organizata buxhetore kanë përfshirë në regjistra pasuri jofinanciare të cilat nuk i plotësojnë kriteret për t'u regjistruar. Mbivlerësimet më të theksuara ishin te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me vlerë 40,172,325€, Ministria e Ekonomisë me vlerë 6,009,587€ dhe nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit me 3,130,548€.

Në anën tjetër, janë evidentuar edhe nënvlërësime në disa institucione të tjera qendrore, si në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës me vlerë 8,405,650€, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për 1,140,570€ dhe në Zyrën e Kryeministrit 458,826€.

Këto mospërputhje janë shkaktuar kryesisht nga:

- Mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme;
- Moskompetenca e duhur e zyrtarëve përgjegjës në regjistrimin e pasurive; dhe
- Moskoordinimi i institucioneve qendrore me ato lokale për t'i siguruar marrëveshjet e nënshkruara nga komunat për bartjen e pronësisë së tyre.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se kontrollet dhe menaxhimi i pasurive jofinanciare është përcjellë me disa mangësi, që kryesisht janë:

- Në pesë ministri nuk ishte kryer procesi i Inventarizimit dhe nuk ishin bërë harmonizime me regjistrat e kontabilitetit;
- Në dy ministri dhe në dy institucione të pavarura nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë;
- Në katër institucione të pavarura dhe në një ministri nuk ishte përdorur sistemi e-pasuria;
- Në dy ministri nuk është bërë zhvlerësimi i pasurive nën 1,000€; dhe
- Në dy ministri dhe në një institucion të pavarur nuk ishte emëruar komisioni për inventarizim të pasurisë.

Niveli lokal

Në nivelin lokal, 20 komuna, kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë jofinanciare të raportuara në PVF, duke mos i raportuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë pasuritë kapitale dhe jokapitale.

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa komuna nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë jofinanciare, dhe si rezultat i kësaj, vlera e pasurive jofinanciare e prezantuar në RVF-BRK është nënvlerësuar për 6,061,429€.

Komunat që kanë ndikuar më së shumti në nënvlerësimin e pasurive jofinanciare janë: Mitrovica e Jugut me 7,835,903€, Leposaviqi 4,509,973€, Vitia 2,230,919€, Gjilani 1,756,113€. Përveç kësaj, kishte komuna që e kishin mbivlerësuar vlerën e pasurive jokapitale. Ndër komunat që kishin mbivlerësimin më të madh të këtyre pasurive ishin Fushë Kosova me 5,613,048€, Obiliqi me 5,083,573€, dhe Peja me 4,351,051€.

Mangësitë në kontrolle dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive te komunat janë:

- Në katër komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrit të përgjithshëm të pasurisë, përderisa në tetë komuna procesi i inventarizimit nuk ishte kryer me kohë, ishte kryer pjesërisht apo nuk ishte kryer fare; dhe
- Në 9 komuna nuk ishte përdorur fare softueri e-Pasuria, ndërsa në 6 komuna të tjera regjistrimi dhe raportimi i pasurive jokapitale përmes këtij softueri ishte kryer vetëm pjesërisht.

Stoqet për nivelin qendror dhe lokal

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre sipas RVF-BRK-së janë 59,365,934€, ndërsa sipas auditimeve individuale ishin 59,159,768€ me një mbivlerësim prej 206,166€. Mbivlerësimi neto i stokut, vjen kryesisht si rezultat i raportimit të gabuar nga Komuna e Obiliqit me 57,246€, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës për 58,154€, Ministria e Shëndetësisë për 95,520€, ndërsa kishte nënvlerësime sidomos te Komuna e Prishtinës për 9,641€, dhe tek Organi Shqyrtues i Prokurimit për 2,704€.

Rekomandime për Qeverinë

- Përmes MF-së, duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të mekanizmave të kontrollit të brendshëm, si dhe të forcojë kapacitetet profesionale të stafit përgjegjës për regjistrimin e pasurive me qëllim që regjistrat të jenë të plotë, të saktë dhe të besueshëm. Po ashtu, procesi i inventarizimit duhet të përfundojë në përputhje me afatet e përcaktuara ligjore; dhe
- Të sigurojë përdorimin e plotë të sistemit e-Pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim që regjistrimi, administrimi dhe raportimi i pasurive të realizohet përmes këtij sistemi.

8. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrimet financiare që palët e treta kanë ndaj organizatave buxhetore si rezultat i shërbimeve të ofruara ose transaksioneve të tjera, për të cilat pagesat ende nuk janë pranuar. Derisa këto mjete nuk arkëtohen, ato evidentohen si borxhe të hapura. Organizatat buxhetore kanë përgjegjësi që, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi, të ndërmarrin masat e nevojshme për mbledhjen e tyre. Sa më gjatë të mbeten të paarkëtuara këto detyrime, aq më i vështirë bëhet procesi i inkasimit, duke rritur njëkohësisht rrezikun e humbjeve financiare për organizatat buxhetore.

Në pasqyrat financiare vjetore (PVF) individuale, organizatat buxhetore kanë raportuar vlera të ndryshme të llogarive të arkëtueshme, të cilat më pas janë përfshirë në Raportin Vjetor Financiar (RVF) të konsoliduar. Gjatë auditimit të pasqyrave financiare individuale janë identifikuar mospërputhje ndërmjet vlerave të raportuara.

Tabela 22 - Llogaritë e arkëtueshme në tre vitet e fundit (në €)

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2025	Sipas RVF – BRK 2025		
		2025	2024	2023
Niveli qendror	905,409,690	903,029,757	727,855,832	670,012,216
Niveli lokal	309,711,007	307,714,521	276,784,168	248,071,575
Total	1,215,120,697	1,210,744,277	1,004,640,000	918,083,792

Vlera e prezantuar e llogarive të arkëtueshme në RVF-BRK ishte 1,210,744,277€. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme janë rritur për 206,104,277€, apo rreth 20% dhe ky është një tregues që institucionet publike nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për mbledhjen e të hyrave.

Bazuar në auditimin tonë, vlera e përgjithshme e llogarive të arkëtueshme ishte 1,215,120,697€, dhe kjo paraqet një nënvlerësim prej 4,376,420€. Kjo përbëhet nga një nënvlerësim në nivelin qendror prej 2,379,933€ dhe një nënvlerësim në nivelin lokal prej 1,996,486€.

Llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror

Vlera e llogarive të arkëtueshme e raportuar në RVF për nivelin qendror ishte 903,029,757€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë ishte 905,409,690€, që paraqet një nënvlerësim prej 2,379,933€. Vërehet një trend i vazhdueshëm i rritjes së vlerës së llogarive të arkëtueshme ndër vite, ndërsa veprimet e ndërmarra për raportimin e saktë dhe të drejtë të tyre vazhdojnë të mos jenë mjaftueshëm efikase.

Në nivelin qendror, rreth 97.4% e vlerës së përgjithshme të llogarive të arkëtueshme përbëhet nga tri institucione: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/ATK me vlerë prej 779,680,187€ apo 86.3%; Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me 82,194,605€, apo 9.1%; dhe Ministria e Punëve të Brendshme me 17,931,473€, apo 2%.

Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme në nivelin qendror kanë shënuar një rritje prej 175,173,925€ apo 24%.

Institucionet e nivelit qendror të cilat kanë raportuar vlera jo të sakta të llogarive të arkëtueshme në pasqyra vjetore financiare (ndryshimet në mes të pasqyrave financiare të OB-së dhe vlerës sipas auditimit):

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/ATK kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerën prej 4,057,674€ si pasojë e mosraportimit të llogarive të arkëtueshme sipas gjendjes në datën e fundit të vitit raportues;
- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 1,706,601€, si rezultat i mungesës së kujdesit të duhur gjatë përgatitjes së PVF-së;
- Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë prej 28,861€, për shkak të mungesës së evidencave të plota për pagesat dhe kontrolleve të pamjaftueshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal

Vlera e llogarive të arkëtueshme të raportuara në RVF-BRK ishte 307,714,521€, ndërsa sipas auditimit kjo vlerë ishte 309,711,005€, me një nënvlerësim për 1,996,484€.

Llogaritë e arkëtueshme të nivelit lokal përbëhen nga tatimi në pronë, taksat ndërtimi, lejet e urbanizimit, qiratë dhe të tjera. Në totalin e llogarive të arkëtueshme, për nivelin lokal, Komuna e Prishtinës merr pjesë me 29.8%, Komuna e Prizrenit me 9.5%, Komuna e Pejës me 6.6%, etj. Krahasuar

me vitin paraprak llogaritë e arkëtueshme në nivelin lokal karakterizohen me një trend rritës në vlerë prej 30,930,353€ apo 11%.

Komunat që kanë nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare janë:

- Komuna e Graçanicës për 1,418,635€ si rezultat i mosraportimit të plotë të llogarive të arkëtueshme nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë nga vitet e mëparshme;
- Komuna e Malishevës për 944,848€, si rezultat i mosfunksionimit të kontrollit për harmonizimin e regjistrave analitikë të llogarive të arkëtueshme me vlerat e raportuara në PVF;
- Komuna e Prizrenit për 355,098€, si rezultat i mosraportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme nga lejet e ndërtimit; dhe
- Komuna e Mitrovicës për 3,793€, si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në mirëmbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme.

Ndërsa komunat që i kanë mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme janë:

- Komuna e Prishtinës për 680,021€, pasi kishte ngarkuar me tatim pronat të cilat ishin në pronësi publike, dhe dyfishimit të borxheve;
- Komuna e Vushtrrisë për 26,231€, si rezultat se është ngarkuar me tatim në pronë parcela publike që është në pronësi komunale; dhe
- Komuna e Vitisë për 19,635€, si rezultat i moszbatimit të duhur të kornizës ligjore sa i përket faturimeve të tatimit në pronë të institucioneve publike.

Çështjet e mësipërme kanë ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të duhura në mbajtjen e regjistrave të llogarive të arkëtueshme dhe raportimin e saktë dhe të drejtë të tyre.

Rekomandime për Qeverinë

- **Përmes MF-së, duhet të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së raportimit të llogarive të arkëtueshme nga organizatat buxhetore, me qëllim të raportimit të plotë, të saktë dhe të drejtë të tyre në Raportin Vjetor Financiar.**
- **Po ashtu, duhet të sigurojë një strategji të qëndrueshme dhe efektive të mbledhjes së të hyrave përmes rivlerësimit të mekanizmave aktual për monitorimin dhe inkasimin e borxheve.**

9. Detyrimet e papaguara dhe kontingjente

Detyrimet e papaguara

Detyrimet e papaguara paraqesin detyrimet financiare që janë krijuar si rezultat i pranimet të mallrave, shërbimeve ose punëve, apo përmes detyrimeve të tjera ligjore dhe kontraktuale, por që nuk janë paguar brenda afateve të përcaktuara. Këto detyrime përbëjnë një tregues të rëndësishëm të menaxhimit të financave publike, pasi ndikojnë drejtpërdrejt në likuiditetin e buxhetit, besueshmërinë e institucioneve publike dhe qëndrueshmërinë fiskale.

Organizatrat buxhetore janë të obliguara që të regjistrojnë me kohë të gjitha obligimet e marra dhe të planifikojnë shlyerjen e tyre në përputhje me ndarjet buxhetore dhe kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Menaxhimi i dobët i këtyre detyrimeve mund të çojë në krijimin e borxheve të prapambetura, vonesa në pagesa dhe rritje të kostove financiare.

Organizatrat buxhetore kanë raportuar vlera të ndryshme të detyrimeve të papaguara në PVF, të cilat më pas janë konsoliduar RVF-BRK. Me rastin e auditimit të këtyre pasqyrave, janë vërejtur mospërputhje në mes të vlerave të raportuara dhe gjendjes faktike, gjë që ka rezultuar me mbivlerësime të detyrimeve në nivel qendror dhe lokal.

Tabela në vijim paraqet një krahasim të detyrimeve të papaguara sipas auditimit dhe sipas RVF-BRK-së për tre vitet e fundit.

Tabela 23 - Detyrimet e papaguara në tre vitet e fundit në (€)

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2025	RVF-BRK 2025		
		2025	2024	2023
Niveli qendror	235,074,505	237,850,574	145,088,446	131,979,483
Niveli lokal	56,659,496	56,703,209	50,916,557	26,734,024
Total	291,734,001	294,553,783	196,005,003	158,713,507

Detyrimet e papaguara sipas RVF-BRK-së janë gjithsej 294,553,783€, ndërsa sipas auditimit detyrimet e papaguara janë 291,734,001€, si rezultat i kësaj kemi një mbivlerësim prej 2,819,782€. Krahasuar me vitin paraprak sipas RVF-2025 detyrimet janë rritur për 98,548,780€ apo rreth 50%. Në këtë rritje ndikim të konsiderueshëm kishte rritja e obligimeve nga shpronësimi në MMPHI (rritja nga viti paraprak 12,999,718€).

Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Sipas auditimit vlera e detyrimeve të papaguara në raport me RVF-BRK-në ishte mbivlerësuar për 2,776,069€.

Mbivlerësimi është evidentuar kryesisht te Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe sportit. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të duhura gjatë përgatitjes së PFV-ve, si dhe pakujdesisë në përditësimin e të dhënave lidhur me detyrimet para përfundimit të vitit fiskal.

Më tej, sipas RVF-BRK-së detyrimet e nivelit qendror për vitin 2025 ishin rritur për 92,762,128€ krahasuar me ato të vitit 2024. Rritja më e theksuar⁸ e këtyre detyrimeve është evidentuar në organizatat si në vijim:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në vlerë prej 35,820,445€, apo rreth 39% e totalit të rritjes. Rritja e detyrimeve është rezultat i mosrealizimit të pagesave, kryesisht për shkak të mungesës së buxhetit dhe mangësive në nxjerrjen e urdhërblerjeve si dhe zotimin e mjeteve;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vlerë prej 15,479,417€, apo rreth 17% e totalit të rritjes. Rritja e detyrimeve është rezultat i mosrealizimit të pagesave, kryesisht për shkak të mungesës së buxhetit të kategoria e subvencioneve dhe transfereve, si dhe pranimi i faturave pas mbylljes së vitit fiskal;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vlerë prej 8,582,704€, apo rreth 9% e totalit të rritjes. Arsyeja kryesore për moskryerjen e pagesave lidhet me pranimin e faturave pas përfundimit të vitit fiskal dhe me kthimet nga bankat komerciale;
- Ministria e Mbrojtës në vlerë prej 7,878,775€, apo rreth 8% e totalit të rritjes. Arsyeja kryesore për moskryerjen e pagesave ishte për shkak të mungesës së buxhetit, si dhe pranimi i faturave pas mbylljes së vitit fiskal.

Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Si rezultat i raportimit të gabuar të detyrimeve në PVF individuale, gabimet janë bartur edhe në totalin e detyrimeve të RVF-BRK-së. Sipas auditimit vlera e detyrimeve në raport me RVF-BRK-në ishte mbivlerësuar në vlerë neto prej 43,713€.

Më tej, sipas RVF-BRK-së detyrimet e nivelit lokal për vitin 2025 ishin rritur për 5,786,652€ krahasuar me ato të vitit 2024.

Rritja më e theksuar e këtyre detyrimeve nga viti paraprak është evidentuar në komunat si në vijim:

- Komuna e Prizrenit me 5,462,264€;
- Komuna e Prishtinës me 3,408,497€;

⁸ Ndikim domethënës kishin rritjet nga viti paraprak (12,999,718€) të obligimet nga shpronësimi MMPHI

- Komuna e Rahovecit me 3,310,156€;
- Komuna e Deçanit me 2,154,159€.

Rritja e detyrimeve të këto komuna ishte kryesisht për shkak të kërkesave të dala nga kontrata kolektive e cila ka rezultuar me mungesë të buxhetit për realizimin e këtyre pagesave.

Raportimet e pasakta të detyrimeve të papaguara paraqesin një pasqyrë jo të saktë dhe jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe Qeverisë ku mund të rezultojnë me vendime joadekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrollët e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të drejtë të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes MF-së, duhet të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së raportimit të detyrimeve të papaguara nga organizatat buxhetore, me qëllim të raportimit të plotë, të saktë dhe të drejtë të tyre në Raportin Vjetor Financiar.

Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, raportohen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Tabela më poshtë paraqet krahasimin e detyrimeve kontingjente sipas auditimit dhe RVF-BRK-së për tri vitet e fundit.

Tabela 24 - Përmbledhje e detyrimeve kontingjente në (€)

Detyrimet kontingjente	Sipas auditimit 2025	Sipas RVF-BRK-së 2025		
		2025	2024	2023
Niveli qendror	202,846,643	203,920,226	207,543,564	190,823,078
Niveli lokal	186,432,527	215,177,451	182,985,594	148,122,748
Gjithsej	389,279,170	419,097,677	390,529,158	338,945,826

Në RVF-BRK, detyrimet kontingjente janë raportuar gjithsej 419,097,677€, ndërsa sipas auditimit janë 389,279,170€, që paraqet një mbivlerësim për 29,818,507€.

Krahasuar me vitin paraprak, detyrimet kontingjente janë rritur për 28,568,519€ apo rreth 7%.

Komunikimi joefektiv në mes zyrtarëve përgjegjës të OB-ve si dhe ndaj Avokaturës Shtetërore, gabimet në trajtimin e detyrimeve kontingjente si dhe kontrollët e dobëta rreth monitorimit mbarëvajtjes së

lëndëve në procese gjyqësore, ishin arsytet më të shpeshta të mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente. Si pasojë gabimet janë reflektuar edhe në raportim në PVF.

Detyrimet kontingjente të nivelit qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente sipas RVF-BRK-së ishte 203,920,266€, ndërsa sipas auditimit 202,846,643€ me një mbivlerësim për 1,073,583€.

Në vijim janë prezantuar institucionet të cilat kanë pasur ndikim më të madh për nënvlerësimin apo mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente:

- Ministria e Punëve të Brendshme ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 2,731,577€;
- Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 535,966€;
- Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 2,357,818€;
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 718,181€.

Detyrimet kontingjente të nivelit lokal

Detyrimet kontingjente ndaj komunave janë të natyrës së ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilarë e deri te paditë për shpronësime. Vlera e detyrimeve kontingjente sipas RVF-BRK-së ishte 215,177,451€ ndërsa sipas auditimit ishte 186,432,527€ me një mbivlerësim prej 28,744,924€.

Në vijim janë prezantuar komunat të cilat i kanë mbivlerësuar detyrimet kontingjente në vlera më të larta:

- Komuna e Prishtinës e kishte salldon e detyrimeve kontingjente të mbivlerësuar për 27,289,835€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së sistemit të kontrollit të mirëfilltë për menaxhimin e lëndëve, të cilat aktualisht mbahen në formë fizike, gjë që ka ndikuar në kontroll të dobët të brendshëm për përditësimin dhe menaxhimin e tyre; dhe
- Komuna e Vushtrrisë i kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 1,568,004€ si pasojë e gabimeve me rastin e regjistrimit të detyrimeve kontingjente dhe mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme për identifikimin e gabimeve para prezantimit të tyre në PVF.

Më tej, rritja e detyrimeve nga viti paraprak ishte në vlerë prej 32,191,857€. Rritja më e theksuar e detyrimeve kontingjente është evidentuar në nivelin qendror dhe lokal si në vijim:

- Ministria e Punëve të Brendshme, rritja prej 12,736,008€;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, rritja prej 8,960,094€;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, rritja prej 8,750,918€;
- Komuna e Prishtinës, rritja prej 24,293,951€;
- Komuna e Vushtrrisë, rritja prej 2,077,802€; dhe
- Komuna e Ferizajt, rritja prej 1,866,918€.

Mbivlersimi dhe nënvlersimi i detyrimeve kontingjente, krijojnë një pasqyrë jo të saktë dhe jo të drejtë të gjendjes financiare të institucioneve dhe mund të çojnë në vendime të gabuara buxhetore dhe strategjike, duke rrezikuar besueshmërinë e pasqyrave vjetore financiare. Po ashtu edhe pagesat shtesë për procedurat gjyqësore dhe përmbartimore rrisin kostot e përgjithshme të organizatave buxhetore, duke çuar në shpenzime të panevojshme dhe duke dëmtuar kapacitetin e tyre për të realizuar projekte të planifikuara.

Rekomandim për Qeverinë

Përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyrat ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta dhe të plota. Në rastet kur evidentohen mospërputhje në të dhënat e raportuara, të identifikohen shkaqet e tyre dhe të ndërmerren masa e nevojshme për korrigjimin e tyre, duke siguruar besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar.

10. Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore

Mbështetur në LMFP, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi, dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrorit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.

Në vitin 2025, me vendime të gjykatave dhe vendime të përmbartuesve privatë sipas RVF-së së BRK-së janë bërë pagesa në shumë prej 159,460,818€. Në raport me të dhënat e vitit 2024, shuma e këtyre pagesave është rritur për 34,045,662€ apo 27%. Siç shihet nga tabela, trendi i këtyre pagesave në raport me vitin e kaluar ka shënuar një rritje, çka paraqet një tregues se organizatat buxhetore ballafaqohen me mungesën e fondeve në kryerjen e detyrimeve ndaj debitorëve.


Tabela 25 - Pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore sipas kategorive ekonomike (në €)

Pagesat sipas kategorive	Sipas auditimit 2025	Sipas RVF – BRK 2025		
		2025	2024	2023
Paga dhe shtesa	336,782	336,782	41,205,175	18,150,858
Mallra shërbime/Komunali	36,492,789	36,492,789	17,800,080	8,919,733
Subvencione dhe Transfere	18,181,980	18,181,980	24,151,685	1,207,926
Investime Kapitale	104,449,267	104,449,267	42,258,216	23,657,727
Total	159,460,818	159,460,818	125,415,156	51,936,244

Mospërmmbushja me kohë e obligimeve nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbartimore) dhe shpenzimeve të interesit. Këto kosto shtesë kanë dëmtuar buxhetet e OB-ve dhe rrjedhimisht edhe objektivat e parapara për t'i realizuar me ato fonde. Marrë parasysh faktin se një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve gjyqësore/përmbartimore e përbëjnë investimet kapitale, rezulton që shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar duke qenë se fondet janë ridestinuuar për t'u paguar këto detyrime.

Në diagramin e mëposhtëm, janë paraqitur shtatë prej OB-ve të cilat janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha se 5,000,000€. Këto pagesa përbëjnë rreth 64% të shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore apo 102,696,792€, si:

Grafikoni 2 - Pagesat sipas vendimeve gjyqësore mbi 5 milion€



Nga analiza e shpenzimeve të vendimeve gjyqësore në SIMFK dhe bazuar në auditimet individuale të OB-ve, është vërejtur se në shumicën e këtyre pagesave, Thesari nuk e ka bërë ndarjen e shpenzimeve të borxhit kryesor kundrejt shpenzimeve të procedurave përmbartimore gjyqësore, siç është e paraparë me planin kontabël.

Tabela 26 - Pagesat e vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore sipas nivelit të qeverisjes (në €)

Pagesat sipas vendimeve gjyqësore	Sipas auditimit 2025	Sipas RVF – BRK 2025		
		2025	2024	2023
Niveli qendror	32,881,761	32,881,761	39,075,021	11,734,942
Niveli lokal	126,579,057	126,579,057	86,340,135	40,201,302
Total	159,460,818	159,460,818	125,415,156	51,936,244

Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit qendror

Pagesat për organizata të nivelit qendror ishin 32,881,761€, apo rreth 21% e totalit të vendimeve gjyqësore. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kishte ndodhur në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në vlerë 12,591,446€ apo 38%, ku kryesisht kishin të bënin me pagat shtesë të policëve.

Pagesat e vendimeve gjyqësore të nivelit lokal

Pagesat në nivelin lokal ishin në vlerë prej 126,579,057€ apo rreth 79% e totalit të vendimeve gjyqësore. Duhet cekur se 36% nga kjo vlerë përfshin pagesat e vendimeve gjyqësore të Komunës së Prishtinës. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me investime kapitale, pastaj kompensimin e punëtorëve për paga jubilarë, përcjellëse dhe shujtat të cilat ishin të parapara sipas kontratës kolektive dhe vonesat në pagesat e faturave nga ana e OB-ve.

Rekomandim për Qeverinë

Ministri i Financave në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbartimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.

11. Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është një funksion i rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut dhe qeverisjes në organizatat e sektorit publik. Përmes një qasjeje të strukturuar dhe të bazuar në rrezik, ai i ofron menaxhmentit të lartë siguri të arsyeshme mbi përshtatshmërinë e dizajnit dhe efektivitetin e zbatimit të mekanizmave të kontrollit, duke kontribuar në arritjen e objektivave organizative.

Komiteti i Auditimit (KA) ka rol mbështetës dhe këshillues ndaj menaxhmentit të lartë të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP), duke kontribuar në ruajtjen e pavarësisë funksionale të auditimit të brendshëm, vlerësimin e kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme për këtë funksion, si dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Në kuadër të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, forcimi i funksionit të Auditimit të Brendshëm mbetet një objektivi i rëndësishëm, i cili synohet të arrihet përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, sigurimit të cilësisë dhe avancimit të kuadrit rregullativ. Ky proces mbështetet dhe koordinohet nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm (NJQHAB), e cila ka përgjegjësi për monitorimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm dhe të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar në subjektet e sektorit publik.

Në sistemin e auditimit të brendshëm kemi vërejtur mangësi, të cilat janë përmbledhur si në vijim:

- **Funksionimi i Njësive të Auditimit të Brendshëm (NJAB)** – Nga 86⁹ Organizata Buxhetore (OB), 54¹⁰ prej tyre përmbushin kriteret për themelimin e NJAB-së sipas Rregullores Nr.01/2019. Megjithatë, nëntë (9)¹¹ OB ende nuk e kanë themeluar këtë njësi, ndërsa në 29 nga 54 NJAB-të e themeluara numri i auditorëve të brendshëm është nën minimumin e kërkuar.
- **Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm** – Menaxhmenti i OB-ve ka zbatuar vetëm 40% të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Shkalla e zbatimit në nivel lokal ishte 36% dhe 42% në nivel qendror, ndërsa realizimi i planeve vjetore të auditimit ishte 89%.
- **Komitetet e Auditimit (KA)** – Nga 45 OB që kanë themeluar NJAB-në, 17¹² prej tyre nuk kanë themeluar Komitetin e Auditimit. Ndërsa, në shtatë (7) OB,¹³ Komitetet e Auditimit nuk kanë mbajtur numrin minimal të takimeve të kërkuara sipas Rregullores Nr.01/2019, dhe në gjashtë (6) OB¹⁴ nuk është mbajtur asnjë takim gjatë vitit.

Auditimet kanë evidentuar se funksionimi joefektiv i sistemeve të kontrollit të brendshëm vazhdon të mbetet një sfidë në disa organizata buxhetore. Dobësitë kryesore lidhen me mungesën e

9 Nga 49 OB të nivelit qendror- Fondi në Mirëbesim nuk ka NJAB sepse kjo njësi funksionon në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Privatizim - (48 NQ dhe 38 NL- 86).

10 Numri prej 54 përbëhet nga 53 OB të cilat i plotësojnë kriteret për themelimin e NJAB si dhe 1 OB e cila ka themeluar NJAB edhe pse nuk ishte e obliguar.

11 Komuna e Parteshit, Istogut, Mitrovicës së Veriut, Hanit të Elezit, Junikut, Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut, si dhe Zyra e Rregullatorit për Energji.

12 MFPT, MMPHI, MPJD, RTK, si dhe komunat e Junikut, Novobërdës, Fushë Kosovës, Dragashit, Malishevës, Istogut, Zubin Potokut, Zveçanit, Mitrovicës së Veriut, Kamenicës, Shtërpçës, Parteshit dhe Hanit të Elezit. Ndërkaq ASHNA nga gjysma e dytë e vitit 2025 e ka shuar NJAB, rrjedhimisht edhe KA, bazuar me ndryshimet ligjore të kësaj agjencie.

13 MAPL, MZHR, KQZ, Obiliqi, Shtime, Gjakova dhe Kaçaniku.

14 MASHTI, ME, MPB, UP, Mitrovica dhe Vitia.

dokumentimit të plotë të procedurave të kontrollit, e cila ndikon në zbatimin e tyre të qëndrueshëm dhe në monitorimin efektiv të tyre. Për më tepër, kufizimet në burimet njerëzore dhe financiare kanë ndikuar në kapacitetet e organizatave për të zhvilluar dhe zbatuar kontrolle adekuate.

Gjithashtu, proceset për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në disa raste nuk janë të strukturuar dhe dokumentuara në nivelin e kërkuar, duke kufizuar aftësinë e menaxhmentit për të adresuar në kohë rreziqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave institucionale.

Në përgjithësi, sistemi i kontrollit të brendshëm në disa organizata buxhetore kërkon përmirësim të mëtejshëm, me qëllim që të sigurojë një nivel të arsyeshëm të sigurisë mbi funksionimin efektiv të proceseve, parandalimin dhe zbulimin në kohë të gabimeve dhe parregullsive, si dhe mbështetjen e menaxhmentit në realizimin e objektivave organizative.

Rekomandime për Qeverinë

- Përmes MF-së (NJQHAB), të sigurojë se, të gjitha OB-të të cilat janë të obliguara ta themelojnë NJAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Përmes MF-së (NJQHAB), të sigurojë se, OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NJAB-së. Këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së.

12. Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, numri i planifikuar i të punësuarve për nivelin qendror dhe lokal ishte 91,130, përderisa numri i të punësuarve sipas RVF-BRK-së ishte 85,983, duke përfshirë këtu edhe numrin e asamblistëve të komunave të cilët paguhen përmes sistemit të pagave dhe nga kategoria “pagat dhe shtesat”. Pra, numri aktual i të punësuarve përfshin të gjithë nëpunësit të cilët kanë marrëdhënie kontraktuale me organizatat buxhetore përkatëse dhe janë pjesë e sistemit të menaxhimit të pagave (Payroll).

Të punësuarit jashtë listës së pagave

Sipas RVF-BRK-së, numri i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 811 (niveli qendror 521, ndërsa niveli lokal 290). Numri më i lartë i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës 367, Universitetin e Prishtinës 71, Zyrën e Kryeministrit 27, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 19, Komunën e Fushë Kosovës 80, Komunën e Glllogocit 57, Komunën e Leposaviqit 49 dhe në Komunën e Prizrenit 38 etj.

Krahasuar me vitin paraprak numri i të punësuarve të kësaj kategorie ishte rritur për 273. Rritja më e theksuar e numrit të të punësuarve jashtë listës së pagave ishte në SHSKUK¹⁵.

Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MSHV)

Sipas RVF-BRK-së, numri i të angazhuarve përmes MSHV-ve ishte 1,891, që krahasuar me vitin paraprak numri i tyre ishte zvogëluar për 2,800.

Sipas raporteve individuale të auditimit për vitin 2025 angazhimi i stafit me MSHV-të ishte për detyra specifike, por kishte raste edhe për plotësimin e pozitave të rregullta. Po ashtu, kishte raste kur nuk ishin aplikuar procedurat përkatëse për angazhimin e tyre.

Numri më i lartë i të angazhuarve me MSHV-të në nivelin qendror ishte në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me 489 persona. Kjo rritje reflektohet kryesisht si rezultat i mbajtjes së zgjedhjeve dhe nevojës për rritjen e numrit të punëtorëve. Numër të lartë të të angazhuarve me kontratë për shërbime kishte edhe në ZKM me 242 persona, në MFPT 238 si dhe në MKRS 137 persona.

Sa i përket nivelit lokal, komuna me numrin më të lartë të të angazhuarve me MSHV-të është Komuna e Prishtinës me 207 persona, ku rritja reflektohet kryesisht te Drejtoria e Shëndetësisë dhe Urbanizimit. Komunat e tjera me numër të madh të angazhimeve të tilla janë: Komuna e Gjilanit me 65 persona, Komuna e Deçanit me 34, Komuna e Kamenicës me 34 dhe Komuna e Obiliqit me 31.

¹⁵ Rritja e numrit nga bashkëpunorët e jashtëm të cilët janë persona që punojnë për institucionin pa qenë të punësuar me kontratë të rregullt në atë institucion. (Ata mund të jenë mjekë specialistë ose specialistë varësisht nga nevoja e atij institucioni)

Kapitulli II

AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË

Përmbledhje e opinioneve, konkluzioneve dhe rekomandimeve

ZKA-ja për vitin 2025, ka publikuar 99 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, prej tyre 49 të nivelit qendror, 38 të nivelit lokal, 10 për ndërmarrje publike si dhe dy (2) raporte të auditimit për qëllime të veçanta¹⁶.

Auditimi është kryer në bazë të metodologjisë së auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Insitucioneve Supreme të Auditimit (SNISA-t). Në bazë të kësaj kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore, si dhe konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret për secilën Organizatë Buxhetore (OB).

Nga auditimi i 99 PFV individuale, 37 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar (31 në nivelin qendror, katër për komuna si dhe dy për PFV-të e KEK-ut për qëllime të veçanta), 57 kanë rezultuar me opinion të kualifikuar (18 në nivelin qendror, 34 për komuna si dhe pesë për NP), pesë NP kanë opinion të kundërt – “Trepça”, KRU “Hidro-Drini”, KRM “Uniteti” – Mitrovicë, KRM “Pastërtia” dhe NPL “Stacioni i Autobusëve” Prishtinë.

Cilësia e raportimit financiar ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak. Në nivelin qendror, në vitin 2025 është rritur numri i OB që kanë marrë opinion të kualifikuar për tre (3), rritje të njëjtë të opinioneve të kualifikuara kishte edhe te niveli lokal nga 31 opinione të kualifikuara të dhëna në vitin 2024 në 34 për vitin 2025.

Përveç opinioneve për PFV-të, ZKA-ja ka dhënë edhe konkluzion për pajtueshmërinë me autoritetet (ligjet dhe rregulloret), duke vlerësuar nëse transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar, në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Nga auditimet e kryera¹⁷, për 31 raporte të auditimit janë dhënë konkluzione të pamodifikuara, (28 në nivelin qendror dhe tre në nivelin lokal), 62 konkluzione të kualifikuara (21 në nivelin qendror, 34 në nivelin lokal si dhe shtatë për ndërmarrje publike), përveç tyre janë dhënë edhe katër konkluzione të kundërta (Komuna e Prishtinës, NP “Trepça”, KRM “Pastërtia” dhe NPL “Stacioni i Autobusëve” Prishtinë).

Konkluzioni i përgjithshëm është se organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike nuk kanë bërë përmirësime në aspektin e raportimit financiar e as në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore.

Me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin e financave publike dhe rritjen e besueshmërisë në raportimin financiar kemi dhënë 824 rekomandime.

¹⁶ Raporti i auditimit për raportin financiar vjetor të Korporatës Energjetike të Kosovës për qëllime të veçanta mbi Rentën Minerare të paguar për licencat për vitin 2025 si dhe raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore për qëllime të veçanta të divizioneve të ndara të Korporatës Energjetike të Kosovës për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për vitin 2025.

¹⁷ për dy (2) auditimet e KEK-ut për qëllime të veçanta nuk është dhënë konkluzion i pajtueshmërisë, dhe këto raporte nuk janë të llogaritura në totalin e konkluzioneve të dhëna.

Tabela 27 - Numri i rekomandimeve sipas kategorive për NQ, NL dhe NP-të për vitin 2025

Nr.	Kategoritë ekonomike	Niveli qendror	Niveli lokal	Ndërmarrjet Publike	Totali
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	5	13	24	42
2	Pagat dhe mëditjet	28	27	16	71
3	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	38	43	32	113
4	Çështjet e përbashkëta (MSH dhe IK)	13	18	5	36
5	Investimet kapitale	35	92	0	127
6	Subvencionet dhe transferet	10	20	0	30
7	Të hyrat	8	44	18	70
8	Obligimet e papaguara	10	23	13	46
9	Detyrimet Kontingjente	14	12	0	26
10	Llogaritë e arkëtueshme/pagueshme	11	45	24	80
11	Pasuritë	49	62	43	154
12	Auditimi i Brendshëm	8	13	4	25
13	Depozitat	1	0	0	1
14	Sistemet informative	0	0	3	3
	Total	230	412	182	824

Në raportet individuale të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për vitin 2025 kemi dhënë 824 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Nga 824 rekomandime, 230 janë rekomandime të cilat janë dhënë në nivelin qendror, 412 rekomandime në nivelin lokal si dhe 182 rekomandime për ndërmarrjet publike.

Kategoritë me nivelin më të lartë të rekomandimeve janë: ajo e pasurive, e investimeve kapitale, e mallrave dhe shërbimeve dhe komunalive, e llogarive të arkëtueshme, e të hyrave si dhe e pagave dhe shtesave.

Tabela 28 - Rekomandimet e dhëna sipas llojeve të auditimit për vitin 2025

Subjektet e Audituara	Rekomandime të reja	Rekomandime të pazbatuara	Rekomandime pjesërisht të zbatuara	Total rekomandime
Niveli Qendror	122	91	17	230
Niveli Lokal	132	250	30	412
Ndërmarrjet Publike	78	90	14	182
Auditimet e Pajtueshmërisë	39	-	-	39
Auditimet e Performancës	169	-	-	169
Totali i Rekomandimeve	540	431	61	1032

Nga tabela e mësipërme vërejmë se numri i rekomandimeve të reja është më i lartë se numri i rekomandimeve të pazbatuara.

1. Niveli Qendror

1.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

ZKA-ja për vitin 2025, ka finalizuar 49 raporte të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë për nivelin qendror, ku përfshihen auditimet për ministritë dhe institucionet e pavarura (përfshirë edhe Radio Televizionin e Kosovës).

Opinionet e auditimit në lidhje me pasqyrat financiare vjetore të OB-ve, të nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 29 - Lloji dhe numri i opinioneve për nivelin qendror për vitin 2025

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror ¹⁸	5	10	15
Institucionet e pavarura ¹⁹	26	8	34
Total	31	18	49

Nga 49 raportet e auditimit të organizatave të nivelit qendror (përfshirë edhe institucionet e pavarura), 31 kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar dhe 18 me opinion të kualifikuar.

¹⁸ Në institucionet e nivelit qendror janë: 15 ministri.

¹⁹ Në Institucionet e pavarura janë të përfshira 33 institucione me 34 raporte të auditimit (Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka dy raporte, një për PFV të AKP-së dhe një për PFV të Fondeve në Mirëbesim).

Po ashtu, ZKA gjatë vitit 2025 ka audituar edhe gjashtë projekte të Bankës Botërore e ku zbatues të projekteve kanë qenë: MMPHI në dy projekte kurse me nga një projekt kanë qenë MBPZHR-ja, MMPHI, MASHTI dhe MFPT-ja. Për të gjitha këto auditime janë dhënë opinione të pamodifikuara.

Çështjet kryesore të cilat kanë ndikuar në kualifikim të opinionit janë përmbledhur si në vijim:

- **Menaxhimi i pasurive** ka shfaqur mangësi në regjistrimin dhe prezantimin jo saktë të tyre në PVF. Këto mangësi përfshijnë mosregjistrim ose regjistrim të pasaktë të pasurive dhe pronave, duke rezultuar në nënvlerësim apo mbivlerësim të vlerave të raportuara. Shkaqet kryesore lidhen me kontrolle joefektive të brendshme, koordinim të pamjaftueshëm ndërmjet njësive përgjegjëse, monitorim të dobët të projekteve kapitale, si dhe përdorim joefektiv të sistemit e-Pasuria. Gjithashtu, në disa raste, mangësitë janë shkaktuar nga mungesa e politikave dhe procedurave të qarta për menaxhim të pasurive, trajnimeve të pamjaftueshme të stafit si dhe vonesave në bartjen dhe evidentimin e pronësisë së pasurive.
- **Detyrimet kontingjente dhe ato të papaguara** nuk janë prezantuar saktë në pasqyrat vjetore financiare, si rezultat i mbivlerësimit, nënvlerësimit dhe shpalosjeve. Këto mangësi kanë ardhur kryesisht nga kontrollet e pamjaftueshme, mungesa e koordinimit ndërmjet zyrave ligjore dhe atyre të financave, mospërditësimi me kohë i regjistrave dhe evidencave të detyrimeve kontingjente, vlerësimi dhe klasifikimi jo i saktë i tyre, si dhe mangësitë në procesin e identifikimit të gabimeve, migrimit të të dhënave dhe raportimit në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV).
- **Klasifikimi dhe regjistrimi i shpenzimeve** ka vazhduar të paraqesë mangësi, për shkak të regjistrimit të pagesave në kategori ekonomike jo përkatëse. Shkaqet lidhen me planifikim joadekuat buxhetor, mungesë të analizës së natyrës së shpenzimeve, si dhe kontrolle të pamjaftueshme gjatë ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së tyre, përfshirë edhe pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore.
- **Te kategoria “Pagat dhe shtesat”** janë paraqitur mangësi kryesisht për shkak të kompensimit të 80 punonjësve pa bazë të rregullt ligjore dhe pa vijueshmëri në punë, në vlerë totale prej 589,884€ (MMPHI-ja për 61 punonjës në vlerë 469,885€ dhe MPB-ja për 19 punonjës në vlerë 119,999€). Kjo dukuri vazhdon ndër vite si pasojë e mungesës së masave konkrete nga ministritë përgjegjëse për adresimin e saj.
- **Menaxhimi i të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme** ka pasur mangësi në regjistrimin dhe raportimin e saktë në Pasqyrat Vjetore Financiare, përfshirë mbivlerësimin dhe nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, veçanërisht të atyre nga lejet ujore, si dhe regjistrimin jo të saktë të të hyrave. Shkaqet kryesore lidhen me kontrollet e pamjaftueshme në regjistrimin dhe verifikimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

Çështjet e identifikuara kanë ardhur si pasojë e funksionimit jo të plotë të kontrolleve të brendshme në organizatat buxhetore, duke rezultuar në gabime të cilat nuk janë parandaluar në kohë. Në vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, vërehet një rritje e opinioneve të kualifikuara nga 15 në 18²⁰ dhe një ulje e opinioneve të pamodifikuara nga 34 në 31, veçanërisht tek institucionet e pavarura, duke reflektuar në rritje të mangësive në kontrollin dhe raportimin financiar.

1.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Konkluzionet e pajtueshmërisë në lidhje me OB-të e nivelit qendror janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 30 - Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin qendror për vitin 2025

Subjektet e audituara	Konkluzion i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Totali
Niveli Qendror	4	11	15
Institucionet e pavarura	24	10	34
Total	28	21	49

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në kualifikimin e konkluzioneve janë përmbledhur si në vijim:

- **Në prokurim dhe menaxhim të kontratave** është evidentuar mosrespektim i procedurave ligjore, planifikim dhe monitorim i dobët, hyrje në obligime pa mbulim financiar, ndryshim i kontratave pa aprovim, pagesa për punë të pakryera, përdorim i pamjaftueshëm i sistemit të e-prokurimit, mungesë dokumentimi, vonesa në realizim dhe pagesa, si dhe mungesë e kontrolleve efektive.
- **Në subvencione dhe transfere** është konstatuar anashkalim i thirrjeve publike, mosrespektim i afateve dhe kornizës ligjore, dobësi në vlerësim dhe transparencë, përfitime të padrejta në skema sociale, moshartim i Programit Vjetor për Grante për vitin 2025, si dhe vonesa në pagesa.
- **Te kategoria “Pagat dhe shtesat”** është identifikuar menaxhim jo i duhur i pozitave të punës duke i mbajtur me ushtrues detyre përtej afateve ligjore, mosrespektim i procedurave të klasifikimit dhe ekuivalentimit të pozitave, si dhe dobësi në zbatimin e rregullave për kompensime dhe në ushtrimin e funksioneve në misione dhe pozita drejtuese.
- **Në fushën e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme** janë identifikuar vonesa në trajtimin e kërkesave dhe ankesave administrative, kontrolle joefektive në procesin e arkëtimit, mungesë e garancive financiare nga qiramarrësit, si dhe masa të pamjaftueshme për sigurimin dhe realizimin e të hyrave.
- **Te detyrimet kontingjente dhe ato të papaguara** janë konstatuar vonesa në pagesa, pasaktësi në raportimin e detyrimeve kontingjente dhe obligimeve të papaguara, si dhe mangësi në administrimin e dokumentacionit mbështetës dhe në trajtimin me kohë të obligimeve.

Gjetjet e identifikuar tregojnë se proceset dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm në organizatat buxhetore ende përballen me sfida në sigurimin e parandalimit, zbulimit dhe trajtimit në kohë të parregullsive dhe dobësive të evidentuara.

Në vitin 2025 në raport me vitin 2024, kemi rritje të numrit të konkluzioneve të kualifikuara, nga 17 në 21, dhe ulje të konkluzioneve të pamodifikuara, nga 32 në 28²¹. Këto rezultate tregojnë një dobësim të nivelit të pajtueshmërisë së subjekteve të audituara me kërkesat e kornizës ligjore dhe rregullative, krahasuar me vitin paraprak.

21 Referohuni shtojcës IV

1.3. Rekomandimet e dhëna

Në kuadër të 49 raporteve individuale të auditimit për institucionet e nivelit qendror për vitin 2025, janë dhënë gjithsej 230 rekomandime, me qëllim adresimin e mangësive të identifikuara dhe përmirësimin e proceseve në fushat ku janë evidentuar dobësi dhe gabime. Në tabelën më poshtë paraqitet numri i rekomandimeve të dhëna gjatë tre viteve të fundit, me qëllim të krahasimit dhe vlerësimit të progresit në adresimin e tyre.

Tabela 31 - Numri i rekomandimeve për nivelin qendror për tre vite

Subjektet e audituara	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Niveli Qendror	147	140	127
Institucionet e pavarura	83	65	52
Total	230	205	179

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë një rritje të numrit të rekomandimeve për 12% në krahasim me vitin paraprak. Gjatë vitit 2025 janë dhënë gjithsej 230 rekomandime (prej tyre 122 të reja, 91 të pazbatuara dhe 17 pjesërisht të zbatuara), ndërsa në vitin 2024 ky numër ishte 205. Kjo rritje reflekton mungesën e veprimeve të mjaftueshme nga ana e organizatave të nivelit qendror për adresimin e mangësive të evidentuara, si në fushën e menaxhimit financiar ashtu edhe në atë të pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi.

Institucionet që shënojnë rritje të numrit të rekomandimeve në krahasim me vitin paraprak janë: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, si dhe institucione të tjera.

2. Niveli Lokal

2.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

Në vitin 2025, janë publikuar 38 raporte të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për organizatat buxhetore të nivelit lokal (komunat). Në përputhje me metodologjinë e auditimit, për secilën organizatë buxhetore janë dhënë opinionet për Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV), si dhe konkluzionet për pajtueshmërinë me kërkesat e autoriteteve përkatëse.

Tabela 32 - Lloji dhe numri i opinionëve për nivelin lokal për vitin 2025

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Gjithsej
Komunat	4 ²²	34	38

22 Mitrovica e veriut, Ranillug, Junik dhe Shtërpçë

Siç paraqitet në tabelën e mësipërme, në katër (4) raporte të auditimit është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa në 34 raporte²³, është dhënë opinion i kualifikuar. E shprehur në përqindje, 89% e komunave të audituara kanë pranuar opinion të modifikuar për PFV-të e tyre.

Krahasuar me vitin 2024, kur përqindja e opinioneve të modifikuara ishte 81%, rezultatet e vitit 2025 tregojnë një trend negativ prej tetë (8)%. Ky rezultat tregon se një numër i konsiderueshëm i komunave vazhdojnë të përballen me mangësi në prezantimin, raportimin dhe shpalosjen e informacionit financiar në Pasqyrat Financiare Vjetore, duke ndikuar në cilësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar. Nga ana tjetër, vetëm një numër i kufizuar komunash kanë arritur të sigurojnë pasqyra financiare që paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen financiare, në përputhje me kornizën e raportimit financiar dhe standardet e aplikueshme.

Çështjet kryesore për modifikimin e opinioneve të auditimit janë përmbledhur si në vijim:

- **Klasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve**, i ndikuar kryesisht nga pagesat e kryera përmes vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave, por edhe nga planifikimi jo i duhur i buxhetit lidhur për kategori të caktuara ekonomike.
- **Menaxhimi i pasurive** kishte mangësi në evidentimin, regjistrimin dhe prezantimin e tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare, përfshirë mosregjistrimin e pasurive, mosmbylljen e investimeve në vijim, mosaplikimin e zhvlerësimit, mospërputhjet ndërmjet regjistrave të pasurive dhe të dhënave kadastrale, si dhe pasaktësitë në vlerësimin e pasurive.
- **Llogaritë e arkëtueshme** nuk janë paraqitur saktë në Pasqyrat Vjetore Financiare, si rezultat i pasaktësive në regjistrim, dokumentimit të pamjaftueshëm dhe mangësive në zbatimin e kërkesave për menaxhimin e tyre.
- **Detyrimet kontingjente dhe obligimet e papaguara** janë raportuar me pasaktësi në Pasqyrat Vjetore Financiare, për shkak të mangësive në evidentim, dokumentim dhe shpalosje, duke rezultuar në mbivlerësim ose nënvlerësim të tyre dhe paraqitje jo të plotë të obligimeve dhe rasteve gjyqësore.
- **Përgatitja e Pasqyrave Vjetore Financiare** ka shfaqur dobësi të reflektuara në pasaktësi të zërave kontabël, shpalosje jo të plota dhe mospërputhje të informacionit financiar të raportuar.

Modifikimi i opinionit në shumicën e komunave është ndikuar nga klasifikimi joadekuat i shpenzimeve, si rezultat i realizimit të pagesave nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore dhe përmbarimore për kompensimin e pagave jubilarë sipas kontratës kolektive. Megjithatë Ligji i Buxhetit për vitin 2025 dhe qarkoret buxhetore kishin mundur planifikimin e mjeteve në kategorinë “Rezervat” për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive, shumica e komunave nuk kishin planifikuar fonde për këtë qëllim. Si rrjedhojë, pagesat e ekzekutuara nga Thesari janë realizuar nga kategori ekonomike joadekuate, duke rezultuar në keqklasifikim të shpenzimeve dhe, për pasojë, në modifikimin e opinionit të auditimit.

Çështjet e tjera që kanë ndikuar në modifikimin e opinioneve të auditimit burojnë nga dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, të cilat kanë ndikuar në identifikimin, evidentimin, regjistrimin

²³ Në 9 komuna (Kamencës, Mamushës, Dragashit, Rahovecit, Podujevës, Suharekës, Lipjanit, Shtimes dhe Istogut), kualifikimi i opinionit financiar është i ndikuar vetëm nga klasifikimi joadekuat i shpenzimeve që ndërlidhet me pagesat realizuara në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore.

dhe raportimin jo të duhur të zërave financiarë, duke rezultuar në pasaktësi dhe shpalosje jo të plota në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV).

2.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Konkluzionet e pajtueshmërisë, për nivelin lokal/komunat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 33 – Lloji dhe numri i konkluzioneve për nivelin lokal për vitin 2025

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzion i kualifikuar	Konkluzioni i kundërt	Gjithsej
Komunat	3 ²⁴	34	1 ²⁵	38

Siç paraqitet në tabelën e mësipërme, në tre (3) raporte të auditimit është dhënë konkluzion i pamodifikuar i pajtueshmërisë, në 34 raporte është dhënë konkluzion i kualifikuar, ndërsa në një (1) raport është dhënë konkluzion i kundërt. Shprehur në përqindje, 92% e konkluzioneve të pajtueshmërisë janë të modifikuara (konkluzione të kualifikuara dhe konkluzion i kundërt), ndërsa vetëm 8% janë të pamodifikuara.

Kjo tregon se shumica e komunave të audituara vazhdojnë të përballen me mangësi në respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullative, duke rezultuar në raste të mospajtueshmërisë në realizimin e aktiviteteve dhe transaksioneve financiare.

Për Komunën e Prishtinës është dhënë konkluzion i kundërt, pasi gjetjet e auditimit kanë evidentuar mospajtueshmëri materiale dhe të përhapura në disa fusha të veprimtarisë së saj. Këto mangësi kanë prekur kategori të ndryshme ekonomike të shpenzimeve dhe kanë ndikuar në vlerësimin se aktivitetet dhe transaksionet e komunës, në një masë të konsiderueshme, nuk janë realizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi.

Edhe në vitin paraprak komuna e Prishtinës kishte konkluzion të kundërt, çka tregon se mangësitë e identifikuar nuk janë adresuar dhe se masat e ndërmarra deri më tani nuk kanë rezultuar në përmirësimin e nivelit të pajtueshmërisë. Përsëritja e këtyre çështjeve ndër vite tregon nevojën për angazhim më të madh institucional, forcim të kontroleve të brendshme dhe monitorim më efektiv nga menaxhmenti për të siguruar zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative në menaxhimin e fondeve publike.

²⁴ Mitrovica e veriut, Mamusha dhe Dragashi

²⁵ Prishtina

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në konkluzion të modifikuar janë përmbledhur si në vijim:

- **Pagesa e faturave dhe obligimeve** është realizuar me vonesë, duke rezultuar në tejkalim të afateve të përcaktuara ligjore.
- **Menaxhimi dhe zbatimi i kontratave publike** ka shfaqur dobësi, të reflektuara në mosaplikimin e penalltive, tejkalimin e sasive apo peshave të kontraktuara, ndryshime në kontrata pa aprovimet e nevojshme, si dhe monitorim dhe dokumentim jo të mjaftueshëm të zbatimit të tyre.
- **Verifikimi dhe inspektimi i pronave të tatueshme** nuk është realizuar në nivelin e kërkuar ligjor, duke mos përmbushur kërkesën për verifikimin e së paku 20% të pronave dhe objekteve që i nënshtrohen tatimit në pronë.
- **Hyrja në obligime kontraktuale dhe realizimi i projekteve kapitale** është bërë në disa raste pa fonde të mjaftueshme ose pa aprovimet e nevojshme buxhetore, përfshirë rialokime dhe ridestinine të mjeteve pa miratimin paraprak të Kuvendit Komunal.
- **Procedurat e prokurimit publik** kanë përmbajtur parregullsi të lidhura me iniciimin e procedurave pa projekt ekzekutues, mangësi në përgatitjen e dosjeve të tenderit dhe specifikimeve teknike, në vlerësimin e ofertave dhe dhënien e kontratave operatorëve ekonomikë që nuk kanë përmbushur kriteret e përcaktuara.
- **Procesi i subvencionimit** ka shfaqur parregullsi që lidhen me mungesën e marrëveshjeve me përfituesit, monitorimin dhe raportimin e pamjaftueshëm të projekteve të subvencionuara, si dhe përzgjedhjen e përfituesve jo në përputhje me kriteret dhe kërkesat ligjore.
- **Menaxhimi i burimeve njerëzore** ka paraqitur mangësi në angazhimin e personelit për detyra të rregullta përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, mbajtjen e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore, si dhe mosrespektimin e kërkesave për kontratat e punës dhe sistemimin e stafit.
- **Menaxhimi i pronave komunale të dhëna në shfrytëzim** ka qenë joefektiv, për shkak të mungesës së monitorimit të obligimeve kontraktuale, shfrytëzimit të pronave pa bazë të rregullt kontraktuale dhe mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në kontrata.

Parregullsitë e identifikuara kanë rezultuar kryesisht nga dobësitë në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe nga moszbatimi i plotë i përgjegjësi dhe detyrave nga zyrtarët përgjegjës. Për më tepër, komunat nuk kanë siguruar masa të mjaftueshme për identifikimin me kohë, adresimin dhe parandalimin e përsëritjes së parregullsive të evidentuara.

Në vijim shpalosim detajet lidhur me dy çështje kyçe: përdorimin e fondeve të dedikuara/planifikuara për projekte specifike, të cilat janë shfrytëzuar për qëllime të tjera, si dhe hyrjen në obligime kontraktuale pa siguruar paraprakisht mjetet e nevojshme buxhetore. Të dyja këto raste kanë ndikuar drejtpërdrejt në konkluzionin e kualifikuar të auditimit.

Në gjashtë (6) komuna, janë evidentuar 82 pagesa për projekte në vlerë të përbashkët 11,617,488€, ku fondet e dedikuara për projekte specifike janë përdorur për qëllime të tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar, pa u zbatuar procedurat dhe kriteret për transferimin ose rialokimin e ndarjeve buxhetore dhe pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Pjesa më e madhe e këtyre rasteve është evidentuar në:

- Komunën e Prishtinës, në 46 pagesa në vlerë prej 10,192,709€,
- Komunën e Malishevës, në 19 pagesa në vlerë prej 805,212€, dhe
- Komunën e Suharekës, në 11 pagesa, në vlerë prej 457,039€.

Ndryshimet e tilla të ndarjeve buxhetore pa miratimin e Kuvendit Komunal zvogëlojnë transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e fondeve publike dhe mund të ndikojnë negativisht në realizimin e projekteve për të cilat fondet ishin planifikuar fillimisht.

Po ashtu, katër (4) komuna kishin hyrë në obligime kontraktuale për projekte të ndryshme pa siguruar paraprakisht fonde të mjaftueshme buxhetore, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Vlera e përgjithshme e obligimeve kontraktuale pa mbulesë buxhetore ishte 19,442,470€. Pjesa më e madhe e këtyre rasteve është evidentuar në:

- Komunën e Prishtinës në vlerë prej 17,134,523€,
- Komunën e Ferizajt në vlerë prej 1,137,131€,
- Komunën e Kaçanikut në vlerë prej 614,874€, si dhe
- Komunën e Malishevës në vlerë prej 555,942€.

Hyrja në obligime kontraktuale pa siguruar fondet e nevojshme buxhetore rrit rrezikun e krijimit të detyrimeve të papaguara dhe të kostove shtesë nga procedurat përmbare, duke ndikuar negativisht në menaxhimin e buxhetit dhe duke krijuar ngarkesa shtesë për buxhetet e viteve pasuese

2.3. Rekomandimet e dhëna

Në raportet individuale të komunave, për vitin 2025 janë dhënë gjithsej 412 rekomandime për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e proceseve në fushat ku janë identifikuar dobësi gjatë auditimit.

Tabela në vijim paraqet numrin e rekomandimeve të dhëna për komunat gjatë tre viteve të fundit. Këto rekomandime lidhen me mangësi të evidentuara në menaxhimin e financave publike, raportimin financiar, pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi, proceset e prokurimit, transparencën, llogaridhënien, si dhe fusha të tjera të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Tabela 34 - Numri i rekomandimeve për nivelin lokal për tre vite

Subjektet e audituara	Viti 2025	Viti 2024	Viti 2023
Komunat	412	413	369

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se numri i rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2025 mbetet pothuajse i njëjtë me atë të vitit paraprak, duke dëshmuar për vazhdimësinë e dobësive në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm.

Në këtë kontekst, është e domosdoshme që komunat të intensifikojnë përpjekjet për forcimin e kontrollit të brendshëm dhe të zbatojnë masa më efektive për adresimin e rekomandimeve të auditimit. Kjo do të kontribuonte në rritjen e llogaridhënies, përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe avancimin e parimeve të qeverisjes së mirë.

3. Ndërmarrjet Publike

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2025 për dhjetë (10) ndërmarrje publike (NP). Prej tyre, gjashtë (6) ishin ndërmarrje publike qendrore, dhe katër (4) ndërmarrje publike lokale.

Përveç auditimeve të rregullta financiare, ZKA-ja ka realizuar edhe dy (2) auditime financiare për qëllime të veçanta në KEK, sipas kërkesave të KPMM-së dhe ZRRE-së. Këto auditime, për shkak të karakterit të tyre specifik dhe objektivave të përcaktuara, kanë rezultuar me opinione të pamodifikuara dhe nuk janë përfshirë në analizat krahasuese të paraqitura në vijim.

Ndërmarrjet publike qendrore të audituara janë: Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK), Trepça sh.a., KOSTT sh.a., NPH "Ibër-Lepenci" sh.a., KRU "Prishtina" sh.a. dhe KRU "Hidrodrini" sh.a. Ndërsa ndërmarrjet publike lokale të audituara janë: KRM "Uniteti" sh.a. Mitrovicë, "Termokosi" sh.a. Prishtinë, KRM "Pastërtia" sh.a. Ferizaj dhe NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë.

Përzgjedhja e këtyre ndërmarrjeve për auditim nga ZKA-ja, është bërë mbi bazën e disa kriterëve kyçe, si: madhësia e buxhetit apo të hyrave, numri i punëtorëve, kompleksiteti i shërbimeve, gjendja financiare dhe interesi publik.

Edhe pse në disa ndërmarrje janë vërejtur përmirësime, auditimi ka nxjerrë në pah se menaxhimi financiar dhe funksionimi i kontroleve të brendshme vazhdojnë të kërkojnë përmirësime të mëtejshme.

Nga auditimi i tyre rezulton se cilësia e raportimit financiar dhe niveli i pajtueshmërisë mbeten sfiduese. Në këto raporte, janë dhënë pesë (5) opinione të kualifikuara dhe pesë (5) opinione të kundërta, duke reflektuar praninë e gabimeve materiale dhe mangësive të theksuara në pasqyrat financiare.

Sa i përket pajtueshmërisë, janë dhënë shtatë (7) konkluzione të kualifikuara dhe tre (3) konkluzione të kundërta, çka tregon për dobësi të vazhdueshme në respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullative. Këto rezultate tregojnë nevojën e domosdoshme për përmirësim të ndjeshëm në të gjitha fushat ku janë identifikuar mangësi, në mënyrë që të rritet besueshmëria, transparenca dhe llogaridhënia në menaxhimin e ndërmarrjeve publike.

Me qëllim të përmirësimit në menaxhim të ndërmarrjeve publike, ZKA-ja ka dhënë rekomandime relevante, të cilat janë përfshirë në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar te personat përgjegjës për qeverisje të NP-ve, si dhe tek aksionarët e tyre.

Veç kësaj, Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike mbikëqyr aktivitetet operative dhe raportimin financiar të këtyre ndërmarrjeve dhe informon rregullisht Qeverinë për gjendjen e tyre.

Një analizë më e detajuar mbi performancën e këtyre ndërmarrjeve dhe cilësinë e raportimit financiar gjendet në vijim.

3.1. Opinionet e auditimeve dhe çështjet në modifikimin e tyre

Opinionet e auditimit në lidhje me PFV-të e ndërmarrjeve publike, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 35 – Lloji dhe numri i opinioneve për ndërmarrjet publike për vitin 2025

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	Gjithsej
Ndërmarrjet publike	-	5	5	10

Për dhjetë (10) ndërmarrje publike të audituara, janë dhënë pesë (5) opinione të kualifikuara si dhe pesë (5) opinione të kundërta, që tregon për mangësi materiale në raportimin financiar.

Krahasuar me vitin 2024, janë evidentuar ndryshime në opinionet e auditimit për PFV-të e tri ndërmarrjeve publike. Ndërmarrja publike lokale "Termokos" sh.a është përmirësuar nga opinion i kundërt në opinion të kualifikuar për vitin 2025, ndërsa te NPL "Pastërtia"- Ferizaj gjendja është përqesuar nga opinion i pamodifikuar në opinion të kundërt për vitin 2025 dhe te NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a - Prishtinë nga opinion i kualifikuar në opinion të kundërt për vitin 2025.

Ndërsa për shtatë (7) ndërmarrjet e tjera publike, opinionet kanë mbetur të pandryshuara krahasuar me vitin paraprak (2024).

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikimin e opinionit për ndërmarrjet publike janë përmbledhur si në vijim:

- **Pasuritë** – Mangësitë lidhen me mosregjistrimin dhe mospërditësimin e pasurive, mungesën e dokumentacionit mbështetës, trajtimin jo të duhur kontabël, llogaritjen e pasaktë të zhvlerësimit, si dhe mospërputhjet ndërmjet regjistrave të pasurive dhe pasqyrave financiare. Po ashtu, janë evidentuar dobësi në inventarizim, në regjistrimin e investimeve në vijim dhe në shpalosjen e informatave përkatëse në pasqyrat financiare.
- **Stoqet** – Mangësitë kanë të bëjnë me mungesën e dëshmive mbështetëse, mosprezantimin e saktë të vlerës së stoqeve, dobësitë në menaxhimin dhe inventarizimin e tyre, si dhe mungesën e dokumentacionit për donacionet.
- **Llogaritë e arkëtueshme** – Çështjet kryesore lidhen me mosvlerësimin e duhur të arkëtimeve, mungesën e provizioneve për borxhet e dyshimta, mospërputhjet ndërmjet evidencave kontabël dhe pasqyrave financiare, si dhe trajtimin jo të duhur të saldove të bartura nga vitet paraprake.
- **Llogaritë e pagueshme** – Mangësitë janë evidentuar në mosprezantimin e saktë të llogarive të pagueshme si dhe në mosharmonizimin e të dhënave kontabël me dokumentacionin mbështetës.
- **Obligimet e pagueshme tatimore dhe të papaguara** - Dobësitë lidhen me prezantimin jo të saktë të detyrimeve tatimore, si dhe mospërputhjet ndërmjet evidencave kontabël dhe obligimeve të raportuara ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

- **Çështjet tjera që kanë ndikuar në opinionet e auditimit** – Përfshijnë pasaktësi në raportimin financiar, mospërputhje ndërmjet pasqyrave financiare dhe evidencave kontabël, klasifikim dhe trajtim jo të duhur të zërave financiarë, mangësi në njohjen e shpenzimeve, provizioneve dhe korigjimeve, si dhe mungesa në dokumentimin dhe shpalosjen e informatave të nevojshme në pasqyrat financiare.

Mangësitë e identifikuara në pasqyrat financiare të ndërmarrjeve publike kanë ardhur kryesisht si rezultat i dobësive në menaxhim dhe në kontrollet e brendshme, si dhe nga veprimet e pamjaftueshme për adresimin e rekomandimeve të auditimit. Në disa raste, menaxhmenti i ka vlerësuar këto rekomandime si sfiduese për zbatim, për shkak të rrethanave specifike operative dhe institucionale.

Dobësitë kryesore janë evidentuar në menaxhimin e pasurive, përfshirë regjistrimin, përditësimin dhe zhvlerësimin e tyre, si pasojë e mungesës së dokumentacionit mbështetës, kontrolleve të mjaftueshme, politikave të brendshme dhe koordinimit efektiv ndërmjet njësive përgjegjëse. Po ashtu, mungesat në trajtimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme, mosrealizimi i plotë i inventarizimeve dhe mosharmonizimi me evidencat kontabël kanë ndikuar në saktësinë e informatave financiare.

Gjithashtu, mosmbajtja e një databaze për pasuritë e financuara nga grantet²⁶, ka paraqitur sfida në regjistrimin dhe paraqitjen e tyre të drejtë në pasqyrat financiare. Përgatitja e pasqyrave financiare është ndikuar edhe nga kontrollet e pamjaftueshme gjatë procesit të raportimit, mungesa e evidencave të plota historike dhe përdorimi i proceseve manuale të kontabilitetit në raste të caktuara. Këto mangësi kanë shkaktuar mospërputhje ndërmjet evidencave kontabël dhe pasqyrave financiare, duke ndikuar në besueshmërinë dhe cilësinë e raportimit financiar të ndërmarrjeve publike.

3.2. Konkluzionet për pajtueshmëri dhe çështjet në modifikimin e tyre

Përveç aspektit financiar të PFV-ve, kemi audituar edhe aspektin e pajtueshmërisë nëse proceset dhe transaksionet janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit si dhe kemi dhënë konkluzione të pajtueshmërisë për të gjitha NP-të e audituara.

Konkluzionet e pajtueshmërisë për NP-të, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 36 – Lloji dhe numri i konkluzioneve për ndërmarrjet publike për vitin 2025

Subjektet e audituara	Konkluzioni i pamodifikuar	Konkluzioni i kualifikuar	Konkluzioni i kundërt	Gjithsej
Ndërmarrjet publike	-	7	3	10

Sipas tabelës, të gjitha ndërmarrjet publike të audituara kanë pranuar konkluzione të modifikuara të pajtueshmërisë, përkatësisht të kualifikuara ose të kundërta që tregojnë se kanë probleme të pajtueshmërisë me autoritetet dhe se transaksionet financiare nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat ligjore.

²⁶ Kjo është identifikuar tek Trepça, Uniteti, Termokosi dhe Hidrodrini

Krahasuar me vitin e kaluar, shumica e ndërmarrjeve publike në vitin 2025 kanë mbetur në të njëjtin nivel të performances, pa ndonjë progres të theksuar. Ndërmarrjet që kanë pranuar konkluzion të kundërt vazhdojnë të kenë mospërputhje materiale në zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative, duke reflektuar mungesën e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Në përgjithësi, ndërmarrjet publike vazhdojnë të përballen me mangësi në zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregullative, të cilat kryesisht lidhen me menaxhimin e shpenzimeve operative, shpenzimeve të pagave, si dhe menaxhimin e të hyrave. Përmirësimi në këto fusha është i domosdoshëm për të siguruar menaxhim më të mirë financiar dhe përmbushje të detyrimeve ligjore.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në modifikimin e konkluzionit të pajtueshmërisë janë përmbledhur si në vijim:

- **Menaxhimi i prokurimit dhe shpenzimeve operative** – Mangësitë lidhen me mosrespektimin e kërkesave ligjore në procedurat e prokurimit, menaxhimin joefektiv të kontratave, përdorimin e procedurave jo të përshtatshme, mungesën e dokumentimit të furnizimeve dhe pagesave, si dhe vonesat në realizimin e kontratave.
- **Shpenzimet e pagave** – Dobësitë janë evidentuar në pagesën e kontributeve dhe tatimeve, zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe transferimit të punonjësve, emërimit në pozita të larta, pagesën e bonuseve dhe shtesave jashtë kornizës ligjore, si dhe në kalkulimin dhe raportimin e saktë të përfitimeve nga pagat.
- **Të hyrat** – Mangësitë kryesore kanë të bëjnë me administrimin jo të plotë të të dhënave të konsumatorëve, mungesën e dokumentacionit kontraktual, pasaktësitë në faturim, menaxhimin e ankesave dhe dobësitë në dokumentimin e proceseve të vlerësimit dhe tregtimit të energjisë.
- **Çështjet tjera me ndikim në konkluzion** - Përfshijnë dobësi në sistemet e kontrollit të brendshëm, mungesë ose mosazhurnim të akteve të brendshme, vonesa në miratimin e dokumenteve raportuese, mosrespektim të kërkesave ligjore, si dhe mangësi në menaxhimin e pasurive, llogarive të arkëtueshme dhe evidencave përkatëse.

Këto mangësi kanë rezultuar kryesisht nga moszbatimi i kërkesave ligjore dhe procedurave të brendshme nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjeve publike, si dhe nga dobësitë në planifikimin dhe në kontrollin e brendshëm. Ato janë pasojë e moszbatimit të rregulloreve dhe procedurave të brendshme në ndërmarrjet publike, mungesës së veprimeve të mjaftueshme të menaxhmentit, ndryshimeve në menaxhment, si dhe mungesës së mbikëqyrjes efektive nga Bordi Mbikëqyrës dhe mosaplikimit të duhur të kërkesave ligjore.

3.3. Obligimet e Ndërmarrjeve Publike për Raportimin Vjetor Financiar

Gjatë auditimit kemi konstatuar se ndërmarrja publike “Trepça” sh.a. nuk i kishte përgatitur dhe finalizuar me kohë Pasqyrat Vjetore Financiare.

Vonesa në përgatitjen dhe finalizimin e PVF-ve në këtë NP kishin ndodhur kryesisht nga kompleksiteti i ndërmarrjes dhe vështirësitë në marrjen e shënimeve nga njësitë biznesore të ndërmarrjes.

Këtë çështje e kemi adresuar në raportin individual, duke theksuar se situata e njëjtë ishte evidentuar edhe në vitin paraprak. Vlerësojmë se në vitet në vijim do të ndërmerren masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes dhe sigurimin e raportimit në përputhje të plotë me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Vlen të theksohet se, ndërmarrja publike “KOSTT” kishte kryer auditimin e PVF-ve për vitin 2025 edhe nga një kompani private e auditimit edhe pse ZKA-ja e kishte njoftuar me kohë se do ta kryente auditimin e PVF-ve për vitin 2025. Kjo kishte ndodhur për shkak se KOSTT-i, shërbimet e auditimit i kishte të kontraktuara që nga viti 2023 me kompaninë private të auditimit.

Analiza e gjendjes financiare e ndërmarrjeve publike

Ndonëse gjendja financiare e ndërmarrjeve publike më hollësisht mund të kuptohet nga pasqyrat e bashkëngjitura në raportet individuale, në këtë kapitull në mënyrë përmbledhëse janë paraqitur treguesit kryesorë të performancës financiare dhe gjendjes së tyre të fund vitit 2025. Për qëllime analize, janë marrë në shqyrtim të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtra dhe detyrimet afatgjata.

Tabela 37 - Treguesit kryesorë financiarë të ndërmarrjeve publike të audituara për vitin 2025

Nr.	Subjektet e e audituara	Të hyrat	Shpenzimet	Fitimi/ Humbja	Detyrimet afatshkurtra	Detyrimet afatgjata
1	KEK “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a.	214,264,000	204,161,000	10,103,000	40,370,000	156,282,000
2	Trepça sh.a.	29,142,647	31,337,806	-2,195,159	36,741,032	3,071,409
3	Ndërmarrja Publike “KOSTT”	91,620,000	81,440,000	10,180,000	50,012,000	53,874,000
4	KRU “Hidrodrini”	6,222,084	6,751,703	-529,619	370,654	32,677,474
5	NPH “Ibër-Lepenc” sh.a. – Prishtinë	12,778,439	11,017,534	1,760,905	5,128,253	12,067,092
6	KRU “Prishtina” sh.a. – Prishtinë	20,179,836	19,721,075	458,761	5,982,468	32,487,925
7	NP “Termokos” sh.a. – Prishtinë	14,739,154	13,402,871	1,336,283	4,873,700	42,240,159
8	NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. – Prishtinë	1,745,582	1,577,960	167,622	106,752	0
9	KRM “Uniteti” sh.a. – Mitrovicë	2,323,211	2,266,813	56,398	3,980,161	303,120
10	KRM “Pastërtia” sh.a. – Ferizaj	3,435,043	3,031,027	404,016	1,665,231	0
	Totali	396,449,996	374,707,789	24,466,985	149,230,251	333,003,179

Rezultati financiar (fitimi/humbja) - Nga tabela më sipër shihet se nga 10 ndërmarrje publike të audituara, tetë (8) prej tyre kanë operuar me një total të fitimeve prej 24.9 milionë euro ndërsa humbje kishte NP "Trepça" sh.a. në vlerë rreth 2.2mil.€ dhe KRU "Hidrodrini" me 529,619€.

Pjesën më të madhe të fitimit e kishin dy NP të nivelit qendror: Kompania Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në shumën prej 10.18 milionë euro apo 41.6% të totalit të fitimeve dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) në shumën prej 10.10 milionë euro apo 41.3% të totalit të fitimeve. Vlen të theksohet se në raport me vitin paraprak ndërmarrja "KOSTT" kishte rritje të shpenzimeve për shërbimet mbështetëse për balancimin e sistemit krahas uljeve të të hyrave.

Përderisa, KEK-u kishte fitim dukshëm më të ulët se vitin e kaluar, shkaku kryesor që ka ndikuar në uljen e fitimit ishte ulja e të hyrave, si rezultat i procesit të modernizimit të turbinave në TC Kosova B. Po ashtu rritja e shpenzimeve për shkak të energjisë së blerë për FEE si dhe ngritjes së tarifës së transmisionit nga KOSTT-i dhe shpenzimeve të personelit, të cilat janë më të larta në krahasim me vitin paraprak.

Detyrimet afatshkurtra/qarkulluese - janë obligime financiare që duhet të shlyhen brenda një viti fiskal. Ato përfshijnë: llogaritë e pagueshme, tatimet e pagueshme, kreditë afatshkurtra dhe detyrimet e tjera me afat pagese brenda një viti.

Për 10 ndërmarrje publike, detyrimet afatshkurtra ishin në shumën prej 149 milionë eurosh, ku 85% prej tyre e përbëjnë tri ndërmarrjet publike të nivelit qendror: KOSTT-i me 50 milionë euro apo 33%, Korporata Energjetike e Kosovës me 40.3 milionë euro apo 27%, dhe Trepça me 36.7 milionë euro apo 25%. Ndërsa pjesën e mbetur prej 22 milionë eurosh apo 15% e përbëjnë detyrimet afatshkurtra të shtatë ndërmarrjeve tjera.

Detyrimet afatgjata - janë obligime financiare ose detyrime jo qarkulluese të cilat listohen në bilancin e gjendjes si obligime që afatin e pagesës e kanë më të gjatë se një vit. Këtu bëjnë pjesë kreditë për mjete themelore, detyrimet ndaj letrave me vlerë dhe detyrimet tjera që duhet të paguhën në afat më të gjatë se një vit.

Detyrimet afatgjata për 10 ndërmarrjet në fund të vitit 2025 ishin 333 milionë euro, ku 159 milionë euro apo rreth 47% e përbën KEK-u ndërsa pjesën tjetër ndërmarrjet e tjera. Meqenëse pasqyra e shpalosjeve përmban mangësi të informatave, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë të dhëna analitike se brenda sa vitesh duhet të kthehen këto detyrime.

Pra, në bazë të analizave të mësipërme, edhe pse të gjitha ndërmarrjet e audituara (me përjashtim të NP "Trepça" dhe KRU "Hidrodrini") kanë rezultat pozitiv për vitin 2025, gjendja e tyre financiare është e vështirë për shkak të shumave të larta të detyrimeve të papaguara.

Gjithsej detyrimet e papaguara të këtyre ndërmarrjeve janë rreth 482 milionë euro, prej të cilave detyrime afatshkurtra që duhet të shlyhen brenda një viti janë rreth 149 milionë euro dhe detyrime afatgjata rreth 333 milionë euro.

Marrë parasysh faktin se të hyrat totale ishin rreth 396 milionë euro, pagesa eventuale e këtyre detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata duket mjaft e vështirë. Kur kësaj i shtohen edhe detyrimet

tjera potenciale që krijohen gjatë vitit vijues gjendja mund të bëhet edhe më e vështirë sa i përket detyrimeve.

3.4. Rekomandimet e dhëna

Në raportet individuale të 10 NP-ve për vitin 2025, janë dhënë 182 rekomandime për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime.

Tabela 38 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të NP-ve për vitin 2025

Ndërmarrjet publike të audituara	Rekomandime të reja	Rekomandime të pazbatuara	Rekomandime pjesërisht të zbatuara	Gjithsej
Niveli Qendror	36	60	7	103
Niveli Lokal	42	30	7	79
Total	78	90	14	182

Nga gjithsej 182 rekomandimeve të dhëna, 78 janë rekomandime të reja, 90 të pazbatuara dhe 14 pjesërisht të zbatuara. Kjo tregon që 43% e rekomandimeve janë të reja, 49% të pazbatuara nga viti i kaluar dhe 8% pjesërisht të zbatuara.

Kapitulli III

AUDITIMET E PERFORMANCËS, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

1. Auditimet e performancës dhe teknologjisë së informacionit

Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon t'u kushtojë rëndësi të veçantë auditimeve të performancës, si një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e qeverisjes publike dhe të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Këto auditime vlerësojnë nëse burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive, si dhe nëse programet dhe aktivitetet e institucioneve publike arrijnë rezultatet e synuara. Përmes gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit, Kuvendit dhe publikut u ofrohet një bazë e qëndrueshme për të kërkuar llogari nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike.

Po ashtu, ZKA-ja ka vazhduar të zgjerojë fokusin në auditimet e pajtueshmërisë, me qëllim të vlerësimit nëse aktivitetet, transaksionet, programet dhe veprimet e institucioneve publike zhvillohen në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi.

Gjatë sezonit auditues 2025–2026 janë kryer 15 auditime të performancës përfshirë edhe teknologjisë së informacionit dhe janë dhënë 169 rekomandime. Në këto auditime kemi përfshirë 36 institucione (9 Ministri, 15 Komuna, 4 Agjenci, 5 Ndërmarrje publike, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Policia e Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës). Përmes këtyre auditimeve janë trajtuar fusha me rëndësi të veçantë për qytetarët, duke marrë parasysh edhe Objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (tutje SDG).Temat e trajtuara si në vijim:

- Barazia gjinore
- Arsimi cilësor dhe mirëqenia sociale
- Industria, inovacioni dhe infrastruktura
- Teknologjia e informacionit-Sistemet e informacionit
- Paqe, Drejtësi dhe Institucione të Forta
- Qytete dhe komunitete të qëndrueshme
- Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm/prokurim publik i qëndrueshëm

AUDITIMI I PERFORMANCËS

INDUSTRI,
INNOVACION
DHE
INFRASTRUKTURË



MONITORIMI, MIRËMBAJTJA DHE SIGURIA E DIGAVE NË KOSOVË

Siguria e digave përbën një aspekt thelbësor të menaxhimit të burimeve ujore dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike në Kosovë. Digat janë objekte strategjike që shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm, ujitje, energji elektrike dhe kontroll të përmbytjeve.

Auditimi ka vlerësuar efektivitetin e masave të sigurisë dhe sistemeve të monitorimit të digave në Kosovë, duke e krahasuar atë me praktikën në Shqipëri, me qëllim identifikimin e përmirësimeve të mundshme dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy vendeve.

Auditimi është fokusuar në periudhën **2021-2024**, mirëpo për çështje krahasimore, janë analizuar edhe periudha nga themelimi i Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore në 2004 e deri në vitin 2025.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

4



Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,

Ndërmarrja Publike “Ibër-Lepenc”, që menaxhon digën e Ujmanit;

Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina”

Korporata Energjetike e Kosovës si pronar i digës së Batllavës.



Ky auditim është realizuar si auditim paralel me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit profesional ndërmjet institucioneve supreme të auditimit.

Për shkak të natyrës së informatave që përmban, raporti është përcaktuar me nivelin e informacionit **“I kufizuar”**.

REKOMANDIME

24

3

Qeverinë e Republikës së Kosovës

6

Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore

6

KRU “Prishtina”

2

Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

6

NP “Ibër-Lepenc”

1

Korporatën Energjetike të Kosovës

AUDITIMI I PERFORMANCËS

BARAZIA
GJINORE



FUQIZIMI I ROLIT TË GRAVE NË POZITA UDHËHEQËSE DHE MARRJE TË VENDIMEVE

Auditimi ka vlerësuar efektivitetin e masave për fuqizimin e rolit të grave në pozita udhëheqëse dhe në marrjen e vendimeve.

Fushëveprimi i auditimit përfshinë periudhën kohore 2020/2024.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

4



Ministria e Punëve të Brendshme dhe
Administratës Publike

Agjencia për Barazi Gjinore

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbyesve
Civil

Njësitë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
të: Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së
Industriës Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,
Ministrisë së Shëndetësisë, Agjencisë për
Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve
në Kosovë, Agjencisë së Gjeologjisë, si dhe
Agjencisë së Punës



MESAZHI I AUDITIMIT

Rezultatet e auditimit tregojnë se ndonëse është shënuar progres në përfshirjen e grave në shërbimin civil, institucionet publike nuk kanë arritur të sigurojnë rritje të kënaqshme të përfaqësimit të grave në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Përfaqësimi i ulët i grave në proceset e vendimmarrjes, vetëm prej 20-25%.

GJETJET KRYESORE

Masat afirmative

Zbatimi i masave afirmative janë trajtuar kryesisht si mundësi ligjore për raste të veçanta, jo si instrument i synuar për rritjen e përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse.

Analiza gjinore e ankesave

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, nuk i analizon kategoritë e ankesave sipas gjinisë.

Menaxhimi i të dhënave në SIMBNJ

Të dhënat në SIMBNJ nuk plotësohen dhe përditësohen rregullisht.

Bashkëpunimi ndërinstitucional

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet institucioneve mbeten të dobëta.

REKOMANDIME

6

2

Ministrinë e
Digjitalizimit dhe
Administratës Publike

1

Këshillin e Pavarur
Mbikëqyrës të
Shërbimit Civil

1

Njësitë e Menaxhimit
të Burimeve Njerëzore
Në Ministrinë e Audituar

2

për të gjitha
Institucionet
Publike

AUDITIMI I PERFORMANCËS

ARSIM
CILËSOR



SIGURIA E NXËNËSVE NË SHKOLLAT PUBLIKE NË KOSOVË

Auditimi ka vlerësuar nëse institucionet përgjegjëse kanë krijuar mekanizma efektivë për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e incidenteve të dhunës në shkolla. Gjithashtu është vlerësuar nëse këto mekanizma kontribuojnë në krijimin e një ambienti të sigurt për nxënësit. Auditimi është fokusuar gjatë periudhës **2022-2025**.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

6



Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Policia e Kosovës

Komuna e Prishtinës

Komuna e Ferizaj

Komuna e Gjakovës

30 Shkolla mostër auditimi dhe 771 pyetësor me nxënës



MESAZHI I AUDITIMIT

Institucionet përgjegjëse nuk funksionojnë ende si një sistem i koordinuar, i standardizuar dhe efektiv për garantimin e sigurisë së nxënësve në shkolla. Mangësitë në parandalim, trajtim dhe raportim të rasteve, si dhe mangësitë në koordinim ndërinstitutional dhe monitorim kanë bërë që reagimi ndaj rasteve të jetë shpesh reaktiv dhe jo i bazuar në menaxhim sistematik të rrezikut dhe dhunës në shkolla.

GJETJET KRYESORE

Parandalimi

Aktivitetet parandaluese nuk zhvillohen në mënyrë sistematike.

Kontrollet dhe vlerësimet e rrezikut janë të kufizuara.

Shkollat kanë qasje kryesisht reaguese dhe jo parandaluese.

Raportimi

Raportimi i rasteve në Sistemi për menaxhimin e informacioneve të arsimit nuk është i plotë.

Mungojnë të dhëna dhe analiza të besueshme mbi incidentet.

Vendimmarrja nuk mbështetet në të dhëna të sakta.

Koordinimi institutional

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve nuk është i qëndrueshëm.

Qendrat për Punë Sociale nuk përgjigjen gjithmonë në kohë.

DKA-të nuk bëjnë monitorimin dhe mbikëqyrjen e shkollave.

Infrastruktura dhe monitorimi

Kamera të sigurisë jo funksionale ose të pamjaftueshme.

Oborre dhe hyrje të pambikëqyrura.

Mungojnë standarde të unifikuara për sigurinë fizike në shkolla.

Monitorimi institucional mbetet i kufizuar.

Nuk është bërë inspektimi për sigurinë në shkolla.

REKOMANDIME

12

5

për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

1

për Policinë e Kosovës

3

të përbashkëta për:
Komunën e Prishtinës,
Komunën e Ferizaj dhe
Komunën e Gjakovës

3

të veçanta për
Komunën e
Prishtinës

AUDITIMI I PERFORMANCËS

ARSIMI
CILËSOR



MBËSHTETJA PËR NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA PUBLIKE

Auditimi ka vlerësuar efektivitetin e mekanizmave për identifikimin, vlerësimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta publike gjatë periudhës **2022-2025**.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

6



Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

Drejtoria Komunale e Arsimit – Prishtinë

Drejtoria Komunale e Arsimit – Pejë

Drejtoria Komunale e Arsimit – Mitrovicë



MESAZHI I AUDITIMIT

Sistemi i mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore ende nuk siguron mbështetje të barabartë dhe të bazuar në nevojat reale. Kapacitetet e pamjaftueshme profesionale, mosfunksionimi i ekipeve vlerësuese komunale, mungesa e procedurave të standardizuara dhe monitorimi i pamjaftueshëm nga niveli qendror, ka bërë që mbështetja për nxënësit me Nevoja të Veçanta Arsimore të ndryshojë dukshëm ndërmjet komunave dhe shkollave.

GJETJET KRYESORE

Identifikimi dhe vlerësimi pedagogjik

Procedurat për identifikim dhe referim nuk janë të standardizuara.

Ekipe vlerësuese komunale nuk funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha komunat.

Vlerësimi pedagogjik vonohet dhe krijon lista pritjeje.

Mbështetja pedagogjike

Planet individuale të Arsimit nuk hartohen dhe rishikohen në mënyrë të njëtrajtshme.

Mësimdhënia e diferencuar zbatohet në mënyrë të pabarabartë.

Praktikat e mira varen nga iniciativa individuale e shkollave.

Shërbimet mbështetëse

Numri i asistentëve, mësuesve mbështetës, psikologëve dhe pedagogëve është i pamjaftueshëm.

Planifikimi nuk bazohet në nevojat reale të nxënësve.

Disa prindër sigurojnë vetë asistentë privatë.

Monitorimi dhe koordinimi

Monitorimi nga MASHTI nuk është sistematik.

SMIA nuk ofron të dhëna plotësisht të sakta dhe të verifikuara.

Vendimmarrja dhe planifikimi nuk bazohen mjaftueshëm në evidencë.

REKOMANDIME

14

5

për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

6

të përbashkëta për Drejtoritë Komunale të Arsimit (Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë)

2

specifike për Drejtoria Komunale e Arsimit Prishtinë

1

i përbashkët për Drejtoria Komunale e Arsimit Pejë dhe Mitrovicë

AUDITIMI I PERFORMANCËS

ENERGJI E
PËRBALLUESHME
DHE E PASTËR



EFEKTIVITETI I SHËRBIMIT TË NGROHJES QENDRORE TERMOKOS

Objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Termokos menaxhon në mënyrë efektive rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike, duke siguruar furnizim të barabartë, matje të saktë dhe ngrohje të qëndrueshme për konsumatorët. Ky auditim ka mbuluar periudhën nga viti 2023 deri në 2025.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



TERMOKOS

Ndërmarrje publike në pronësi të
Komunës së Prishtinës



MESAZHI I AUDITIMIT

Termokos përballlet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin e sistemit të ngrohjes qendrore, të cilat lidhen me mangësi në menaxhimin teknik të rrjetit, dobësi në sistemin e matjes dhe faturimit, si dhe mungesë të sigurisë rezervë për furnizim.

GJETJET KRYESORE

Menaxhimi i rrjetit

Shpërndarje e pabalancuar: Dardania e Ulpiana mbingrohen, kurse Mati 1 e Kodra e Diellit marrin ngrohje të pamjaftueshme.

Moszbatim i metodologjisë së faturimit: Rreth 46.5% e konsumatorëve faturohen sipas sipërfaqes (m²) dhe jo sipas konsumit real.

Pajisje jofunksionale: Mbi 5.6% e matësve kanë defekte, duke detyruar kalimin në faturim sipas sipërfaqes.

Mungesë e kapaciteteve rezervë: Varësia e plotë nga KEK-u rrezikon furnizimin e qëndrueshëm me ngrohje.

Matja dhe faturimi

46.5% e konsumatorëve faturohen sipas sipërfaqes (m²), jo sipas konsumit real.

Matësit e energjisë termike janë jashtë funksionit ose mungojnë.

Metodologjia e matjes dhe faturimit e pa zbatuar.

Siguria e furnizimit

Termokos nuk ka kapacitete rezervë për prodhim të energjisë termike.

Varësi e plotë nga Korporata Energjetike e Kosovës për prodhimin e energjisë.

Rrezik i lartë për vazhdimësinë e furnizimit në periudha kritike.

Shërbimi për konsumatorët

Pabarazi në trajtimin e konsumatorëve sipas lokacionit.

Cilësi jo uniforme e shërbimit të ngrohjes.

Nevojë për investime në infrastrukturë dhe sistem monitorimi.

REKOMANDIME

9

për Termokosin

AUDITIMI I PERFORMANCËS

QYTETE DHE
KOMUNITETE
TË QËNDRUESHME



EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI NË PROCESIN E LEJEVE NDËRTIMORE NË KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



Komuna e Fushë Kosovës

Objektivi i auditimit ishte vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të Komunës së Fushë Kosovës në procesin e trajtimit të lejeve ndërtimore, që nga dhënia e kushteve ndërtimore, lëshimi i lejeve, inspektimet dhe deri te pajisja me certifikata të përdorimit.

Fushëveprimi i auditimit përfshinë periudhën kohore 2022 - 2024.



MESAZHI I AUDITIMIT

Komuna e Fushë Kosovës nuk ishte treguar efikase dhe efektive në menaxhimin e procesit të lejeve ndërtimore për ndërtimet të larta banesore. Mungesa e Planit Zhvillimor Komunal dhe planeve rregulluese të hollësishme, si dhe dobësitë në zbatimin e Hartës Zonale, kanë bërë që kushtet dhe lejet ndërtimore të mos jenë gjithmonë në përputhje me kërkesat e planifikimit hapësinor.

Numri i ulët i inspektimeve, mungesa e planifikimit dhe kontrollet e pamjaftueshme në fazat e lejeve dhe certifikatave të përdorimit kanë rezultuar me tejkalime të parametrave urbanistikë, mungesë të vendparkimeve jashtë kërkesave dhe vonesa në lëshimin e certifikatave. Këto mangësi rrisin rrezikun e zhvillimit të pakontrolluar urban dhe përdorimit të objekteve pa verifikim të plotë të përputhshmërisë me standardet dhe sigurinë funksionale.

GJETJET KRYESORE

Planifikimi hapësinor

Komuna nuk ka Plan Zhvillimor Komunal dhe plane rregulluese të hollësishme.

Lejet dhe kushtet ndërtimore lëshohen kryesisht në bazë të Hartës Zonale.

Inspektimet

Numri i inspektimeve është shumë i ulët.

Komuna nuk ka plan pune dhe objektiva për inspektorët.

Lejet ndërtimore

Vonesa në lëshimin e kushteve dhe lejeve ndërtimore.

Mospërputhjet ndërmjet kushteve dhe lejeve ndërtimore

Certifikatat e përdorimit

Vetëm 48% e objekteve të analizuar për periudhën 2018-2021 janë pajisur me certifikatë përdorimi.

Mospërputhje ndërmjet gjendjes reale dhe kushteve ndërtimore.

REKOMANDIME

10

për Komunën e Fushë Kosovës

AUDITIMI I PERFORMANCËS

QYTETE DHE
KOMUNITETE
TË QËNDRUESHME



EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE TË AMVISERISË NË KRYEQYTET

Objektivi i auditimit ishte të vlerësojë efikasitetin dhe efektivitetin e Komunës së Prishtinës në organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, duke marrë në konsideratë rëndësinë thelbësore të këtij shërbimi për mbrojtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit dhe sigurimin e një cilësie të qëndrueshme jetese për qytetarët. Ky auditim ka mbuluar periudhën 2022-2024.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

2



Komuna e Prishtinës

Kompania Rajonale të Mbeturinave (KRM)
"Pastrimi"



MESAZHI I AUDITIMIT

Komuna nuk ka arritur të jetë efikase dhe efektive në grumbullimin e mbeturinave gjatë viteve të fundit. Situata e rënduar e mbeturinave në kryeqytet, e reflektuar përmes mbingarkimit të kontejnerëve dhe shpërndarjes së mbeturinave nëpër trotuare dhe hapësira publike, paraqet dëshmi të dukshme që shërbimi i mbledhjes së mbeturinave nuk ka qenë adekuat.

GJETJET KRYESORE

Mungesë e Monitorimit dhe raportimit

Komuna nuk ka siguruar kontroll dhe monitorim efektiv mbi KRM Pastrimin.

KRM Pastrimi nuk ka përmbushur detyrimet e raportimit ndaj Komunës.

Komisioni i Aksionarëve dhe Bordi i Drejtorëve nuk kanë ushtruar mbikëqyrje efektive në zinxhirin e qeverisjes institucionale.

Përdorim jo-efikas i pajisjeve

KRM Pastrimi nuk ka siguruar funksionim efikas të flotës së kamionëve.

Dobësi në planifikim operativ dhe menaxhim të aseteve.

Investime jo efektive në flotë.

Shpërndarje dhe menaxhim jo-efektiv i kontejnerëve

Shumë kontejnerë dhe shporta mbesin të papërdorura në depo.

Në shumë pika të grumbullimit mungojnë kontejnerë, janë të dëmtuar ose jo-funksional.

Kompania private më e shtrenjtë-kompania publike më e lirë

Kontratë me operator privat për grumbullim të mbeturinave pa analizë paraprake dhe të strukturuar të kostos.

Kosto me e lartë (149 mijë euro për ton për periudhën prill-dhjetor 2024) krahasuar me KRM Pastrimi.

Vështirësi financiare

KRM Pastrimi nuk ka arritur të sigurojë performancë të qëndrueshme financiare.

Niveli i ulët të arkëtimit të faturave, vetëm 21% e faturimit në vitin 2025.

REKOMANDIME

12

për Komunën e Fushë Kosovës

2

për Komunën e Prishtinës

10

për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi"

AUDITIMI I PERFORMANCËS

PAQE, DREJTËSI
DHE
INSTITUCIONE
TË FORTA



EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE NGA AKKVP

Objektivi i auditimit ishte për të vlerësuar nëse Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave (AKKVP) ka vendosur mekanizma efektivë që sigurojnë administrim të ligjshëm, efikas dhe transparent të pronave nën administrimin e saj.

Ky auditimit përfshinë periudhën kohore 2023 – 2025.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



Agjencia Kosovare për Krahësim dhe
Verifikim të Pronës



MESAZHI I AUDITIMIT

Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave nuk ka siguruar administrim mjaftueshëm efikas dhe efektiv të pronave nën administrim. Mangësitë në sistemin elektronik, regjistrin e pronave, procesin e inspektimeve dhe në trajtimin e shfrytëzimit të paautorizuar kufizojnë monitorimin efektiv, llogaridhënien dhe mbrojtjen e pronave publike.

GJETJET KRYESORE

Sistemi elektronik jo plotësisht funksional

Vetëm moduli i administrimit të pronave është në përdorim,

Modulet e të hyrave dhe financave nuk janë funksionale që nga viti 2018.

Të dhënat financiare dhe të hyrave administrohen në mënyrë manuale, pa integrim dhe pa raporte automatike.

Regjistri i pronave jo i plotë dhe jo i besueshëm

Regjistri nuk përmban të dhëna të plota dhe të standardizuara për shfrytëzuesit e rreth 9,700 pronave.

Inspektime të planifikuara dhe dokumentuara dobët

Planifikimi i inspektimeve nuk është i bazuar në analizë të rrezikut.

Dokumentimi i inspektimeve është i paplotë,

Monitorimi i zbatimit të masave ndaj shfrytëzuesve të paautorizuar është i pamjaftueshëm.

Trajtim jo efektiv i shfrytëzimit të paautorizuar

Rastet e shfrytëzimit të paautorizuar nuk janë trajtuar në mënyrë të plotë dhe me kohë.

Shumë prona përdoren jashtëligjshëm dhe pa të hyra për Agjencinë.

Kontrollet e brendshme dhe raportimi të dobët

Kontrollet e brendshme nuk garantojnë parandalim efektiv të veprimeve të paautorizuara dhe nuk sigurojnë cilësi të mjaftueshme të të dhënave.

Raportimi menaxherial dhe ai financiar nuk ofron pasqyrë të plotë dhe në kohë.

REKOMANDIME

10

për Agjencinë Kosovare për
Krahësim dhe Verifikim të Pronës

AUDITIMI I PERFORMANCËS

KONSUM DHE PRODHIM
I PËRGJEGJSHËM/
PROKURIM PUBLIK I
QËNDRUESHËM

ZBATIMI I PROCEDURAVE TE PROKURIMIT PËR MIRËMBAJTJEN E AUTOUDHËVE A7 DHE A6

Auditimi ka pasur për objektiv vlerësimin nëse procesi i prokurimit për mirëmbajtjen e autoudhëve është zhvilluar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe parimet e

ekonomisë, efikasitetit, trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminimit. Ky auditim ka pasur në fushëveprim vetëm këtë aktivitet të prokurimit prej identifikimit të nevojës deri te nënshkrimi i kontratës.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



Ministria e Infrastrukturës
dhe Transportit



MESAZHI I AUDITIMIT

Rezultatet e auditimit tregojnë se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nuk ka arritur të sigurojë që procesi i prokurimit për mirëmbajtjen e autoudhëve të realizohet plotësisht në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit, trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminimit të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

GJETJET KRYESORE

Vonesa ne iniciimin e procedurës se prokurimit

Procedura është iniciuar vetëm 36 ditë para skadimit të kontratave ekzistuese.

Shkurtim i afatit për dorëzimin e ofertave prej 40 në 24 ditë.

Mangësitë ne dosjen e tenderit çuan ne vonesë në hapje të ofertave

Kritere dhe kërkesa të papërshtatshme në dosjen e tenderit.

Hapja e ofertave ishte shtyrë për rreth pesë muaj.

Janë përdorë procedura të negociuara të prokurimit.

Mos analizimi i mjaftueshëm i çmimeve me devijime të theksuara nga çmimet referente

Ministria nuk ka analizuar mjaftueshëm devijimet ndërmjet çmimeve të ofertave dhe çmimeve referente.

Ministria nuk ka kërkuar sqarime shtesë për pozicionet me çmime dukshëm të ulëta.

Përzgjedhja e fituesve sipas llojeve nuk ka rezultuar me kombinimin me ekonomik te ofertave

Nuk është përzgjedhur kombinimi që siguronte koston më të ulët të mundshme për Ministrinë.

Konflikt potencial i interesit

Angazhimi i mëparshëm profesional i kryesuesit të Komisionit të Vlerësimit me operatorin ekonomik fitues nuk ishte vlerësuar apo trajtuar nga Ministria,

Cenim (së paku në dukje) i paanshmërisë dhe besueshmërisë së procesit.

REKOMANDIME

7

për Ministrinë për Infrastrukturës
dhe Transportit

AUDITIMI I PERFORMANCËS

QYTETE DHE
KOMUNITETE
TË
QËNDRUESHME



EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI NË PROCESIN E NDËRTIMEVE TË LARTA NË KOMUNËN E FERIZAJT

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



Komuna e Ferizajt

Objektivi i auditimit ishte që të vlerësohet nëse Komuna e Ferizajt ka menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive procesin

nga shqyrtimi i aplikacioneve për leje ndërtimore deri te inspektimi dhe pajisja me certifikatë të përdorimit, si dhe nëse ka siguruar transparencë në këtë proces. Ky auditim ka mbuluar periudhën 2023-2025.



MESAZHI I AUDITIMIT

Dhënia e lejeve ndërtimore nuk është menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive nga Komuna e Ferizajt për shkak të mungesës së Hartës Zonale, moszbatimit konsistent të planeve rregulluese, mungesës së një procesi të standardizuar për shqyrtimin e aplikacioneve dhe kontrollit të pamjaftueshëm para lëshimit të lejeve.

Si rezultat, ndërtimet e larta në Komunë të Ferizajt janë zhvilluar në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe me pasoja afatgjata në cilësinë e hapësirës urbane sepse nuk reflekton nevojat e qytetarëve dhe ka cenuar hapësirën publike.

GJETJET KRYESORE

Ndërtimet e larta u lejuan pa dokumente të planifikimit hapësinor

Lejet ishin dhënë duke u bazuar vetëm në Ligjin për ndërtimin, sipas kriterit "brenda diametrit 50m".

Lejet për ndërtim janë dhënë pa u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, pa Hartë Zonale të aprovuar.

Edhe pse ekzistonin Plane Rregulluese Urbane, Komuna nuk i ishte bazuar në to me arsyetimin se përkohë me Planin Zhvillimor të vjetër (të shfuqizuar),

Trajtimi i ndryshëm i sipërfaqeve ndikoi në koeficient të ndërtimit

Në dy raste, tarracat nuk u përfshinë në llogaritje, duke bërë që koeficienti të rezultonte brenda kufirit të lejuar.

Në shtatë raste, falja e tokës ndikoi në tejkalimin e koeficientit maksimal të ndërtimit,

Në katër raste lejet e ndërtimit u lëshuan me koeficient mbi kufirin e lejuar.

Inspektorati nuk ka bërë inspektime të mjaftueshëm të ndërtimeve

Nga objektet e audituara, asnjëri nuk ishte inspektuar në të gjitha fazat e ndërtimit.

Rreth gjysma e tyre ishin inspektuar vetëm një herë,

Inspektimi ishte më shumë reagues sesa parandalues.

Gjobat, vendimet për ndalim të punimeve dhe kallëzimet penale nuk prodhuan efektin e pritur.

Objekte të banuara pa certifikatë përdorimi

Së paku 20 objekte të ndërtuara në pesë vitet e fundit të banuara por pa certifikatë përdorimi.

Punë të pakryera si: pjesë të ashensorit të paizoluara, parkingje të pakompletuara etj.

REKOMANDIME

9

8

për Komunën e Ferizajt

1

për Ministrinë e Mjedisit
dhe Planifikimit Hapësinor

AUDITIMI I PERFORMANCËS

KONSUM DHE
PRODHI I
PËRGJEGJSHËM/
PROKURIM PUBLIK I
QËNDRUESHËM



EFEKTIVITETI NË PËRDORIMIN E KRITERIT TENDERI EKONOMIKISHT MË I FAVORSHËM PËR DHËNIE TË KONTRATËS NË PROKURIM PUBLIK

Objektivi i këtij auditimi ishte që të vlerësojmë se a është përdorur kriteri tenderi ekonomikisht më i favorshëm (TEMF) në mënyrë efektive për të siguruar arritjen e vlerës për para.

Ky auditimi ka mbuluar aktivitetet e prokurimit që janë zhvilluar gjatë viteve 2023-2025, përkatësisht nga dy aktivitete në secilën entitet të audituar.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

3



Ministria e Infrastrukturës

Komuna Pejë

Komuna Suharekë



MESAZHI I AUDITIMIT

Rezultatet e auditimit nxjerrin në pah se përdorimi i kriterit tenderi ekonomikisht më të favorshëm nuk ka qenë efektiv, përkatësisht nuk ka sjellë ndonjë ndryshim pozitiv në rezultatet e prokurimit publik. Tenderi ekonomikisht më i favorshëm është përdorur kryesisht në mënyrë formale.

GJETJET KRYESORE

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm është përdorur kryesisht në mënyrë formale.

Mungon analizë dhe arsyetim të mjaftueshëm për përdorimin e kriterit TEMF

Përdorimi i TEMF nuk ka sjellë dallime domethënëse krahasuar me kriterin Çmimi Më i Ulët.

Vlera e parashikuar e kontratave nuk është bazuar në analiza reale të tregut

Vlera e parashikuar e kontratave nuk është dokumentuar dhe arsyetuar sa duhet.

Dallime të konsiderueshme ndërmjet vlerës së parashikuar të kontratës dhe ofertave, 16%-50%.

Procesi i vlerësimit të ofertave nuk ka qenë gjithmonë objektiv

Janë eliminuar oferta më të ulëta pa shteruar të gjitha mundësitë për sqarime.

Janë shpërblyer operatorë ekonomikë të papërgjegjshëm.

Mangësi në menaxhimin e kontratave

Mungesa e projekteve të detajuara, matjeve paraprake gjeodezike, monitorimit aktiv të kontratës dhe menaxhimit të duhur të sigurisë së ekzekutimit ka ndikuar në ndryshime të sasive, vonesa dhe rrezik të mos zbatimit të kontratave.

Nuk është arritur vlera për para

Nuk ka dëshmi se përdorimi i kriterit TEMF ka sjellë cilësi më të lartë, efikasitet më të madh apo rezultat më të mirë krahasuar me kriterin çmimi më i ulët.

Vlera për para nuk është arritur në kontratat e analizuar.

REKOMANDIME

8

për Ministrinë e Infrastrukturës, Komunën e Pejës dhe Komunën e Suharekës

AUDITIMI I PERFORMANCËS

PAQE, DREJTËSI
DHE
INSTITUCIONE
TË FORTA



PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I SHESHIT SË BASHKU ME NËNKALIMET DHE PARKINGUN NËN TOKËSOR"

Auditimi vlerësoi nëse Komuna e Malishevës kishte planifikuar dhe menaxhuar në mënyrë efikase projektin "Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor".

Ky auditim mbuloi periudhën 2022 - 2025.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



Komuna e Malishevës



MESAZHI I AUDITIMIT

Komuna nuk e kishte planifikuar dhe menaxhuar projektin në mënyrë efikase, duke bërë që objektivat e tij të mos realizohen sipas projektit fillestar. Mungesa e planifikimit të detajuar, ndryshimet në punime dhe materialet ndërtimore, si dhe nevoja për punë shtesë, kanë ndikuar në rritjen e kostos së projektit dhe në vonesa në realizim.

GJETJET KRYESORE

Sistemi elektronik jo plotësisht funksional

Projekti nuk ishte mbështetur në planifikim strategjik,

Nuk ishin konsultuar me kohë qytetarët dhe institucionet relevante,

Pëlqimet për ndërtim ishin siguruar vetëm pas fillimit të punimeve.

Fillimi i projektit pa financim të mjaftueshëm

Komuna ka ri-destinuar rreth 520 mijë euro nga projektet të tjera kapitale

Vlerësime jo të sakta në fazën e projektimit

Ndryshime në 37% të pozicioneve të punimeve,

Punë shtesë dhe rritje të kostos së projektit për rreth 973 mijë euro,

Për përfundimin e projektit u nevojiten edhe mbi 520 mijë euro shtesë.

Mungesa e analizës së tregut

Dallime të konsiderueshme ndërmjet çmimeve të vlerësuara dhe atyre të kontraktuara, deri në 16 herë më të larta.

Menaxhim dhe mbikëqyrje të dobët të kontratës

Mungesa e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrjes së pavarur,

Mos-formalizim me kohë të ndryshimeve përmes aneks-kontratave

Paqartësi në përgjegjësitë teknike.

REKOMANDIME

9

për Komunën e Malishevës

AUDITIMI I PERFORMANCËS

QYTETE DHE
KOMUNITETE
TË
QËNDRUESHME



PËRCJELLJA E REKOMANDIMEVE PËR RAPORTIN E AUDITIMIT "MEKANIZMAT E SIGURIMIT TË CILËSISË SË TË DHËNAVE TË RAPORTUARA PËR SMPK DHE GPK PËR VITIN 2021"

Objekti i përcjelljes ishte të vlerësohet nëse komunat: Gjakovë, Klinë dhe Viti si dhe Ministria e Administrimit të

Pushtetit Lokal, kanë ndërmarrë masa efektive për përmirësimin e mekanizmave të sigurisë dhe cilësisë së të dhënave të raportuara në kuadër të Sistemit të

Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantit të Performancës Komunale.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

4



Komuna e Gjakovës

Komuna e Klinës

Komuna e Vitisë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal



MESAZHI I AUDITIMIT

Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve ka gjetur se vetëm një rekomandim është zbatuar plotësisht, tri janë në fazën përfundimtare të zbatimit, dy kanë filluar të zbatohen ndërsa dy nuk janë adresuar fare. Konkluzioni i përcjelljes është se MAPL dhe komunat kanë punuar për të adresuar rekomandimet, por zbatimi i plotë kërkon ende angazhim.

AUDITIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

INDUSTRI,
INNOVACION
DHE
INFRASTRUKTURË



SISTEMI I INTEGRUAR INFORMATIV PËR SKEMAT PENSIONALE

Auditimi ka vlerësuar nëse Sistemi i Integruar Informativ (SI) për Skemat Pensionale dhe aplikacionet përkatëse funksionojnë në mënyrë efektive për administrimin e skemave pensionale, duke siguruar të dhëna të sakta dhe shërbime të digjitalizuara në kohë reale për qytetarët gjatë periudhës 2024-2026.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

4



Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministria për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës
Çlirimtare
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Agjencia Kosovare e Privatizimit



MESAZHI I AUDITIMIT

Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale nuk funksionon plotësisht në mënyrë efektive për administrimin e skemave pensionale dhe nuk siguron në tërësi të dhëna të sakta dhe shërbime të digjitalizuara në kohë reale për qytetarët.

Mangësitë kryesore lidhen me integrimin e pjesshëm të sistemit, kontrollet e pamjaftueshme të aplikacionit dhe dobësitë në sigurinë e informacionit.

GJETJET KRYESORE

Integrimi i sistemit

Skemat pensionale nuk janë plotësisht të integruara.

Modulet janë zhvilluar të ndara.

Nuk ekziston bazë unike qendrore e të dhënave.

Dokumentacioni historik mbahet ende fizikisht.

Kontrollet e aplikacionit

Validime automatike të pamjaftueshme.

Mungon verifikimi ndërinstitucional.

Rrezik për pasaktësi të të dhënave.

Procese të caktuara ende manuale.

Siguria e informacionit

Dobësi në menaxhimin e qasjeve.

Mungon enkriptimi i të dhënave.

Politika të pamjaftueshme për fjalëkalimet.

Rrezik për qasje të paautorizuar dhe keqpërdorim të të dhënave.

Digjitalizimi i shërbimeve

Integrim jo i plotë i sistemeve.

Shërbime jo plotësisht në kohë reale.

Procese të fragmentuara dhe jo të standardizuara.

Kufizohet efikasiteti dhe kënaqësia e qytetarëve.

REKOMANDIME

23

21

Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës
Çlirimtare, Ministrinë e Financave

2

Agjencinë Shtetërore
e Arkivave të Kosovës

AUDITIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

INDUSTRI,
INNOVACION
DHE
INFRASTRUKTURË



SISTEMI ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E STUDENTËVE

Auditimi ka vlerësuar nëse Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS) administrohet dhe menaxhohet në mënyrë efektive, të sigurt dhe të qëndrueshme, duke mbështetur proceset akademike dhe administrative të Universitetit të Prishtinës gjatë periudhës 2022-2025.

NR. I INSTITUCIONEVE TË AUDITUARA

1



Universiteti i Prishtinës



MESAZHI I AUDITIMIT

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve paraqet mangësi në qeverisjen e Teknologjisë së Informacionit, kontraktimin, kontrollet e aplikacionit dhe vazhdimësinë e biznesit. Për më tepër, sistemi ende nuk është shtrirë në të gjitha njësitë akademike, duke kufizuar përdorimin e tij të plotë në Universitetin e Prishtinës.

GJETJET KRYESORE

Qeverisja e TI-së

Mungojnë politika dhe procedura të dokumentuara.

Pozitat kyçe të TI-së nuk janë plotësuar.

Nuk ka procedurë për menaxhimin e incidenteve.

Raportimi dhe monitorimi i aktiviteteve të TI-së është i kufizuar.

Kontraktimi

Kodi burimor nuk ishte në pronësi të plotë të Universitetit.

Varësi e lartë nga operatori ekonomik.

Paqartësi në menaxhim me sistemin.

Kontratat nuk përmbajnë Marrëveshje të nivelit të shërbimit dhe indikatorë performance për ofruesit të shërbimit.

Mungojnë kërkesa të qarta për sigurinë dhe backup-in.

Kontrollet e aplikacionit

Mungojnë validimet automatike të të dhënave.

Nuk është vendosur një mekanizëm formal për menaxhimin e roleve dhe privilegjeve.

Sistemi përdoret pjesërisht në disa fakultete.

Ekzistojnë qasje pa autorizim formal.

Rrezikohet integriteti dhe besueshmëria e të dhënave.

Vazhdimësia e biznesit

Mungon Plani i Vazhdimësisë së Biznesit.

Nuk ekziston ambient testues.

Mungon një qendër e dytë për rimëkëmbje nga fatkeqësitë.

Rrezik për ndërprerje të shërbimeve dhe humbje të të dhënave.

REKOMANDIME

16

për Universitetin e Prishtinës

Kapitulli IV

AUDITIMET E PAJTUESHMËRISË

1. Auditimet e pajtueshmërisë

Përmbledhje e përgjithshme

Përmbledhje e auditimeve të pajtueshmërisë të realizuara në fusha me rëndësi për menaxhimin e financave publike

8	4	4
Auditime të pajtueshmërisë	Auditime në nivel qendror	Auditime në nivel lokal

Gjatë vitit raportues, Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar tetë auditime të pajtueshmërisë në fusha me rëndësi për menaxhimin e financave dhe pasurisë publike. Po ashtu, janë kryer edhe tri auditime të pajtueshmërisë me informata të klasifikuara me nivel të kufizuar.

Auditimet kanë trajtuar investimet kapitale në shëndetësi dhe trashëgimi kulturor, subvencionet dhe grantet, si dhe dhënien në shfrytëzim dhe menaxhimin e pronave komunale.

Auditimet evidentuan mangësi në planifikim, procedurat e prokurimit dhe përzgjedhjes së përfituesve, monitorimin e kontratave dhe subvencioneve, administrimin e pronës publike, mbledhjen e të hyrave dhe zbatimin e dispozitave kontraktuale.

Për adresimin e mangësive të identifikuara në fushën e pajtueshmërisë dhe për përmirësimin e proceseve në këto auditime kemi dhënë gjithsej 39 rekomandime.

Lista e auditimeve të pajtueshmërisë

Institucioni	Tema e auditimit	Fusha	Çështjet dominuese
SHSKUK	Ndërtimi i objektit për Klinikat e Nefrologjisë dhe Hemato-Onkologjisë	Investime kapitale në shëndetësi	Planifikimi, specifikimet teknike, vlerësimi i ofertave dhe pasqyrimi i shpenzimeve
MAPL	Ndërtimi i shtëpive për komunitetet jo shumicë	Subvencione dhe përfitues	Planifikimi, përzgjedhja e përfituesve, ankesat dhe masat kontraktuale
MKRS	Menaxhimi i projekteve kapitale në trashëgimi kulturor	Investime kapitale dhe trashëgimi	Ekzekutimi i buxhetit, mbikëqyrja, dokumentacioni dhe vonesat
MZHR	Monitorimi i Skemës së Granteve për Zhvillim Rajonal të Balancuar	Grante dhe zhvillim rajonal	Dokumentimi i monitorimit, përdorimi i aseteve dhe zbatimi i masave kontraktuale
Komuna e Prishtinës	Menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit	Subvencione në sport	Planifikimi, kriteret e përzgjedhjes, pagesat, monitorimi dhe raportimi

Institucioni	Tema e auditimit	Fusha	Çështjet dominuese
Komuna e Lipjanit	Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira	Prona komunale	Regjistri i pronave, monitorimi i kontratave, kontrollet në terren dhe raportimi
Komuna e Skenderajt	Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira	Prona komunale	Afatet e shfrytëzimit, monitorimi, arkëtimi i qirave dhe regjistrat
Komuna e Gjakovës	Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira	Prona komunale	Monitorimi, investimet kontraktuale, kontratat valide dhe borxhet e qirasë

1.1. SHSKUK - Ndërtimi i objektit për Klinikat e Nefrologjisë dhe Hemato-Onkologjisë

Objektivi dhe fushëveprimi

Objektivi i auditimit ishte të vlerësohej nëse procesi i ndërtimit të objektit ishte zhvilluar në pajtueshmëri me legjislacionin për prokurimin publik, dokumentet e planifikimit dhe projektimit, si dhe nëse fondet e projektit ishin menaxhuar në mënyrë të rregullt dhe transparente. Auditimi përfshiu të gjithë ciklin e projektit, nga planifikimi dhe buxhetimi, procedurat e prokurimit dhe vlerësimi i ofertave, deri te menaxhimi i fondeve dhe implementimi i kontratës.

Konkluzioni i auditimit

Auditimi konstatoi se procesi nuk ishte menaxhuar në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe procedurale. Kontrollet e brendshme nuk kishin funksionuar në nivelin e duhur dhe ishin evidentuar parregullsi në fazat kryesore të projektit.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Procesi i planifikimit dhe buxhetimit të kontratës nuk ishte i plotë dhe i rregullt.
- Në hartimin e specifikimeve teknike ishte aplikuar qasje e dyfishtë, duke krijuar hapësirë për dykuptimësi dhe interpretime subjektive.
- Ekzistonin mospërputhje ndërmjet dokumentacionit teknik të projektit dhe paramasës.
- Kërkesat ligjore nuk ishin zbatuar plotësisht gjatë vlerësimit të ofertave.
- Parregullsitë në menaxhimin e fondeve kishin ndikuar në pasqyrimin jo të saktë të shpenzimeve.

Për adresimin e mangësive të identifikuara janë dhënë pesë rekomandime.

1.2. MAPL - Ndërtimi i shtëpive për komunitetet jo shumicë në komuna

Objektivi dhe fushëveprimi

Objektivi i auditimit ishte të vlerësohej pajtueshmëria e procesit me kornizën ligjore, rregulloret dhe dispozitat e thirrjes publike, duke përfshirë planifikimin, shpalljen e thirrjes, përzgjedhjen e përfituesve, implementimin e subvencionit dhe ekzekutimin e fondeve.

Konkluzioni i auditimit

Megjithëse projekti kishte siguruar mbështetje për një numër përfituesish, procesi nuk ishte zhvilluar plotësisht në përputhje me kërkesat për ligjshmëri, transparencë dhe trajtim të barabartë.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Aktiviteti ishte zhvilluar jashtë planit vjetor të punës dhe objektivave strategjike të ministrisë.
- Nuk ishte miratuar rregullore e brendshme që përcakton procedurat e zbatimit.
- Ishin përzgjedhur përfitues pa dokumentacion të plotë dhe aplikantët me kushte të njëjta nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë.
- Vendimet e komisionit të ankesave nuk ishin të arsyetuara mjaftueshëm dhe vizitat në terren nuk ishin dokumentuar.
- Në dy raste, shtëpitë nuk ishin ndërtuar sipas afateve dhe kushteve kontraktuale, ndërsa ministria nuk kishte zbatuar masat ndëshkuese të parapara.

Me qëllim të adresimit të çështjeve të identifikuara dhe për të siguruar mbarëvajtje të proceseve nga faza e planifikimit e deri te zbatimi i subvencionit, janë dhënë katër rekomandime.

1.3. MKRS - Menaxhimi i projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore

Objektivi dhe fushëveprimi

Auditimi kishte për qëllim të vlerësonte nëse projektet kapitale ishin planifikuar, zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive, efikase dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi gjatë periudhës 2022–2024.

Konkluzioni i auditimit


MKRS- ja nuk kishte siguruar menaxhim adekuat të projekteve kapitale. Nga 27.15 milionë euro të planifikuara, ishin realizuar vetëm 10.89 milionë euro, ose rreth 40.1%, duke reflektuar nivel të ulët të ekzekutimit të buxhetit.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Mbikëqyrja profesionale e projekteve nuk ishte e mjaftueshme dhe në disa raste ishte angazhuar staf i palicencuar.
- Monitorimi nga menaxherët e kontratave ishte i pamjaftueshëm.
- Dokumentacioni teknik dhe ndërtimor nuk ishte i plotë.
- Sistemi elektronik i prokurimit nuk ishte përdorur për menaxhimin e kontratave.
- Ishin evidentuar vonesa në realizimin e kontratave dhe mungesë e garancioneve për punimet pas pranimit teknik.

Për adresimin e mangësive të identifikuara janë dhënë gjashtë rekomandime.

Figura 1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për projektet kapitale në trashëgimi kulturore



1.4. MZHR - Monitorimi i zbatimit të Skemës së Granteve të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar

Objektivi dhe fushëveprimi

Objektivi i auditimit ishte të vlerësohej nëse Ministria e Zhvillimit Rajonal kishte vendosur dhe zbatuar mekanizma adekuatë për monitorimin dhe raportimin e projekteve të financuara, si dhe nëse projektet ishin realizuar dhe dokumentuar në përputhje me kushtet e marrëveshjeve të financimit gjatë periudhës 2024-2025.

Konkluzioni i auditimit

MZHR-ja kishte krijuar mekanizmat bazë për monitorimin administrativ dhe vizitat në terren. Megjithatë, procesi nuk kishte siguruar në të gjitha rastet dokumentim të mjaftueshëm dhe përcjellje efektive të respektimit të detyrimeve kontraktuale nga përfituesit.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Dokumentacioni mbështetës i raporteve të monitorimit nuk ofronte në të gjitha rastet dëshmi të mjaftueshme dhe relevante.
- Gjatë ekzaminimeve fizike u evidentuan raste të mosrespektimit të kushteve të marrëveshjeve lidhur me ruajtjen dhe përdorimin e aseteve.
- Ministria nuk kishte iniciuar me kohë procedurat për zbatimin e dispozitave kontraktuale, përfshirë kthimin e mjeteve ose të aseteve të financuara.

Për përmirësimin e procesit të monitorimit dhe zbatimit të detyrimeve kontraktuale janë dhënë dy rekomandime.

1.5. Komuna e Prishtinës - Menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit

Objektivi dhe fushëveprimi

Auditimi kishte për qëllim të vlerësonte pajtueshmërinë e planifikimit, ndarjes, pagesës dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit me kërkesat ligjore dhe procedurale për periudhën 1 janar 2024 - 31 dhjetor 2025.

Konkluzioni i auditimit


Auditimi konstatoi se proceset dhe sistemet e menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve nuk ishin efektive dhe nuk ishin në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, procedurale dhe kontraktuale. Këto mangësi kanë rritur rrezikun që fondet publike të mos përdoren në përputhje me qëllimin e përcaktuar, përfituesit të mos përzgjidhen në mënyrë transparente dhe të barabartë, si dhe objektivat e financimit të mos arrihen.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Kriteret e detajuara për vlerësimin dhe renditjen e aplikimeve nuk ishin përcaktuar paraprakisht dhe nuk ishte përdorur metodologji standarde e vlerësimit.
- Subvencione ishin ndarë jashtë thirrjeve publike dhe pa dëshmi të plota për zhvillimin e procedurave të kërkuara.
- Në raste të audituara, përfituesit nuk kishin plotësuar të gjitha kriteret dhe obligimet e kërkuara.
- Procedurat e vlerësimit dhe pagesave nuk ishin zhvilluar brenda afateve të përcaktuara.
- Monitorimi dhe raportimi i subvencioneve ishte i pamjaftueshëm dhe nuk siguronte dokumentim të plotë të përdorimit të fondeve.

Për adresimin e mangësive të identifikuara janë dhënë pesë rekomandime.

Figura 2. Planifikimi dhe realizimi i subvencioneve për rini dhe sport, 2024–2025



1.6. Komuna e Lipjanit - Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira

Objektivi dhe fushëveprimi

Objektivi i auditimit ishte të vlerësohej nëse Komuna e Lipjanit kishte përcaktuar dhe zbatuar procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale dhe nëse pronat e dhëna me qira ishin menaxhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Auditimi përfshiu procesin e dhënies me qira dhe menaxhimin e kontratave për periudhën 2024 – 2025.

Konkluzioni i auditimit

Komuna e Lipjanit nuk kishte arritur të menaxhonte në mënyrë adekuate pronat nën administrimin e saj. Kontrollat e brendshme për menaxhimin dhe monitorimin e pronave nuk kishin funksionuar në nivelin e duhur, duke rezultuar dobësi në transparencë, mbikëqyrje, zbatim dhe llogaridhënie.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Komuna nuk posedonte regjistër gjithëpërfshirës dhe të përditësuar të pronave të dhëna në shfrytëzim.
- Nuk ishte siguruar sistem funksional për monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontratave të qirasë.
- Mosrespektimi i kontratave dhe mos përmbushje e planeve investive nga shfrytëzuesit e pronave komunale.
- Në raste të audituara, obligimet kontraktuale nuk ishin zbatuar dhe përfitimet e parapara me kontrata nuk ishin realizuar.
- Nuk ishin zhvilluar kontrole të rregullta në terren dhe nuk ishte siguruar raportimi gjashtëmujor nga shfrytëzuesit e pronës.
- Kryetari i Komunës nuk kishte raportuar në Kuvendin Komunal gjatë viteve 2024 dhe 2025 me fokus realizimin e kontratave të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Për adresimin e mangësive është dhënë një rekomandim për Kuvendin Komunal dhe gjashtë rekomandime për Kryetarin e Komunës.

1.7. Komuna e Skenderajt - Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira

Objektivi dhe fushëveprimi

Objektivi i auditimit ishte të vlerësohej nëse Komuna e Skenderajt kishte përcaktuar dhe zbatuar procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale dhe menaxhimin e pronave të dhëna me qira në përputhje me legjislacionin në fuqi. Auditimi përfshiu planifikimin, procedurat e dhënies në shfrytëzim, si dhe monitorimin, raportimin dhe mbledhjen e të hyrave gjatë periudhës 2024-2025.

Konkluzioni i auditimit


Komuna e Skenderajt nuk kishte arritur të menaxhonte në mënyrë adekuate pronat komunale nën administrimin e saj. Kontrollët e brendshme në monitorimin dhe menaxhimin e pronave nuk kishin funksionuar si duhet dhe ishin identifikuar mangësi në planifikim, kontraktim, mbikëqyrje dhe arkëtim të qirave.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Në planin për dhënien në shfrytëzim të pronave për vitin 2025 nuk ishte përcaktuar qartë periudha kohore e shfrytëzimit për secilën pronë.
- Lokalet ishin shfrytëzuar për vite pa ripërtëritje të kontratave dhe pa procedura formale të përzgjedhjes.
- Komuna nuk kishte siguruar mekanizëm dhe plan dinamik për monitorimin e kontratave, ndërsa Kryetari nuk kishte raportuar veçmas në Kuvend gjatë viteve 2024 dhe 2025.
- Obligimet e papaguara të qirasë ishin 167,151 euro në fund të vitit 2024 dhe 220,914 euro në fund të vitit 2025, ndërsa komuna nuk kishte ndërmarrë me kohë veprime ligjore apo ndërprerje të kontratave.
- Regjistri i pronave ishte i pastrukturuar dhe i paplotë, ndërsa mungonin kartelat analitike financiare për secilën pronë.

Për adresimin e mangësive është dhënë një rekomandim për Kuvendin Komunal dhe pesë rekomandime për Kryetarin e Komunës.

Figura 3. Obligimet e papaguara nga shfrytëzuesit e pronave komunale



1.8. Komuna e Gjakovës - Dhënia në shfrytëzim dhe menaxhimi i pronave komunale të dhëna me qira

Objektivi dhe fushëveprimi

Auditimi përfshiu procesin e dhënies në shfrytëzim dhe menaxhimin e kontratave aktive të pronave me qira për periudhën 2024 – 2025, përfshirë edhe kontratat bazë të lidhura në vitet e mëparshme. Fokusi ishte vlerësimi i menaxhimit dhe monitorimit të pronave komunale të dhëna me qira.

Konkluzioni i auditimit

Komuna e Gjakovës nuk kishte arritur të siguronte menaxhim të mjaftueshëm për ruajtjen dhe rritjen e vlerës së pronave të dhëna me qira. Mangësitë në monitorimin e kontratave, realizimin e investimeve dhe mbledhjen e obligimeve financiare kishin ndikuar në efektivitetin dhe transparencën e administrimit të pronës komunale.

Çështjet kryesore të identifikuara

- Kryetari nuk kishte paraqitur në Kuvendin Komunal raport për monitorimin e kontratave gjatë vitit 2024, përderisa raporti i përgatitur në maj të vitit 2025 nuk përmbante detaje të mjaftueshme për ecurinë e investimeve afatgjata.
- Në një rast përfituesi nuk kishte filluar investimet sipas kushteve të kontratës, ndërsa komuna kishte shkëputur kontratën për mosfillimin e ndërtimit apo renovimit.
- Në 17 raste qiramarrësit nuk kishin paguar obligimet për vite me radhë, duke krijuar borxh të përgjithshëm prej 253,347€. Komuna kishte ngritur padi ndaj tyre.
- U evidentuan raste të mosrealizimit të përfitimeve kontraktuale, përdorimit të pasurisë komunale pa kontrata valide dhe mosrespektimit të kushteve dhe obligimeve nga shfrytëzuesit.

Për adresimin e mangësive ishin dhënë katër rekomandime për përmirësimin e monitorimit dhe menaxhimit të pronave me qira për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës.

Kapitulli V

REKOMANDIMET E AUDITIMIT

Përmbledhje për zbatimin e rekomandimeve

Raportet e auditimit identifikojnë dobësitë në sistemet e qeverisjes, në veçanti ato financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si mekanizëm kyç për adresimin e këtyre dobësive dhe për forcimin e efikasitetit e efektivitetit të sistemeve në funksion të arritjes së objektivave institucionale. Megjithatë, analizat kanë treguar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit mbetet i pamjaftueshëm.

Në nivelin e auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore ende nuk kanë vendosur një proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Krahësuar me vitin paraprak numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale është rritur, por niveli i zbatimit të tyre mbetet i pamjaftueshëm. Vetëm 36% e rekomandimeve (duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike) janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa e mbetur është në proces zbatimi ose nuk është zbatuar ende.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në vazhdimin e dobësive dhe mangësive të kontrollit, duke çuar në përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve është treguesi kryesor i ndikimit të auditimit dhe reflekton nëse menaxhmenti ka ndërmarrë veprime për të përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsi. Përmes auditimeve individuale, ZKA-ja vlerëson zbatimin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak, duke evidentuar qartë fushat ku janë ndërmarrë masa përmirësuese dhe ato ku ende kërkohen veprime shtesë.

Në Raportin Vjetor të Auditimit për RVF-BRK të vitit 2025 janë dhënë gjithsej 17 rekomandime për Qeverinë/Ministrinë e Financave.

Shtojca I e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA-2024, ndërsa Tabela 39 paraqet statistikën dhe përqindjet e rekomandimeve për institucionet e niveleve të ndryshme.

1. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA për vitin 2024

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve mbetet pjesë e rëndësishme e procesit të vazhdueshëm të auditimit. Ky vlerësim realizohet për secilën organizatë të audituar gjatë auditimeve të rregullta, me qëllim të evidentimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak, si dhe identifikimit të çështjeve që vazhdojnë të mbeten të paadresuara nga subjektet e audituara.

Qeveria nuk ka dërguar në ZKA planin e veprimit për implementim të rekomandimeve. Ndërsa, në raportin vjetor financiar për vitin 2025 tek aneksi 24 është paraqitur plani për zbatimin e rekomandimeve të RVA-së.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarr nga ana e Qeverisë dhe institucioneve tjera, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar një nivel të kënaqshëm të zbatimit të rekomandimeve.

Nga gjithsej 20 rekomandime të dhëna në RVA-në e vitit 2024, prej tyre një (1) rekomandim ishte zbatuar, një (1) ishte pjesërisht i zbatuar, 14 nuk ishin zbatuar, dhe katër (4) nuk janë të aplikueshme. Shtojca I, paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA-në e vitit 2024.

2. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale për vitin 2024

Nga raportet individuale të auditimit të kryera në vitin 2025 është vlerësuar niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak. Nga 766 rekomandimet e vlerësuara 274 apo 36% ishin zbatuar, 61 apo 8% pjesërisht ishin zbatuar dhe 431 rekomandime apo 56% nuk kishin gjetur ende zbatim.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindja e adresimit të tyre sipas grupeve të subjekteve të audituara .

Tabela 39 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për OB dhe NP - 2024

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve në 2024	Rekomandimet e zbatuara ²⁷	%	Rekomandimet pjesërisht të zbatuara	%	Të pazbatuara	%
Niveli qendror	140	51	36%	15	11%	74	53%
Institucionet e pavarura	65	46	71%	2	3%	17	26%
Niveli lokal	413	133	32%	30	7%	250	61%
Ndërmarrjet Publike	148 ²⁸	44	30%	14	9%	90	61%
Gjithsej Rekomandimet	766	274	36%	61	8%	431	56%

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërehet se institucionet e pavarura kanë nivelin më të lartë të zbatimit të rekomandimeve, me 71%, kurse ndërmarrjet publike vazhdojnë të kenë nivelin më të ulët me 30%. Po ashtu, niveli i rekomandimeve të pazbatuara te Ndërmarrjet publike dhe te Komunitet mbetet shumë i lartë me 61%.

²⁷ Te rekomandimet e zbatuara janë përfshirë edhe rekomandimet që janë konsideruar në raportet individuale që nuk janë të aplikueshme më.

²⁸ Në RVA-në e vitit 2024 për NP-të janë raportuar gjithsej 153 rekomandime të dhëna. Megjithatë ZKA-ja nuk i auditon çdo vit NP-të e njëjta atëherë vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve ndryshon. Në vitin 2025 nuk është audituar nga ZKA-ja Telekom i Kosovës sh.a (14 rekomandime, nuk është vlerësuar niveli i zbatimit), ndërsa janë audituar KRM "Pastërtia" (3 rekomandime, është vlerësuar niveli i zbatimit) dhe NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Prishtinë (6 rekomandime, është vlerësuar niveli i zbatimit).

Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2025 te Ndërmarrjet publike nuk është audituar nga ZKA-ja Telekom i Kosovës sh.a., kurse janë audituar KRM “Pastërtia” dhe NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. Prishtinë.

3. Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës për katër (4) raporte të auditimit të shqyrtuara në vitet paraprake për: Universitetin e Prishtinës, Telekomin e Kosovës, SHSKUK-në dhe RTK-në, ka dhënë 10 rekomandime. Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe ka konstatuar se gjashtë (6) prej tyre janë zbatuar, siç është raportuar në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2024. Për katër (4) rekomandimet e tjera, të cilat ishin të pazbatuara ose në proces, është bërë një vlerësim pasues gjatë auditimeve të vitit 2025, ku ka rezultuar se dy (2) janë ende në proces zbatimi dhe dy (2) të tjera nuk janë zbatuar.

Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për këto rekomandime të Kuvendit të Kosovës.

4. Ndikimi i auditimit

Në kuadër të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ofron siguri të pavarur dhe të arsyeshme mbi saktësinë e pasqyrave financiare, si dhe vlerëson përputhshmërinë e aktiviteteve të organizatave të sektorit publik me kërkesat ligjore dhe rregullative. Përmes vlerësimit të sistemeve, politikave, proceseve dhe kontrolleve të brendshme, auditimi identifikon fushat ku nevojiten përmirësime dhe kontribuon në forcimin e llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë financiare.

Ndikimi i auditimit matet kryesisht përmes nivelit të zbatimit të rekomandimeve, pasi adresimi i çështjeve të identifikuar reflekton gatishmërinë e menaxhmentit për të ndërmarrë veprime korrigjuese dhe për të përmirësuar proceset dhe kontrollet ekzistuese. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve përbën një element kyç të ciklit të auditimit, duke mundësuar trajtimin efektiv të mangësive dhe rritjen e besueshmërisë së raportimit financiar.

Në përgjithësi, auditimet për vitin 2025 kanë dhënë një ndikim të matshëm në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar në sektorin publik, përmes korrigjimit të pasaktësive, përmirësimit të prezantimit të të dhënave dhe forcimit të kontrolleve të brendshme.

Si rezultat i auditimit janë realizuar korrigjime të Pasqyrave Financiare Vjetore në nenin 13, nenin 14 dhe shënimet shpjeguese duke e përmirësuar raportimin financiar për 119,117,075€, dhe rritur besueshmërinë dhe cilësinë e raportimit financiar.

Në nivelin qendror, korrigjimet e realizuara në nenin 13, nenin 14 dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare Vjetore arrijnë në 103,139,739€. duke kontribuar në harmonizimin e të dhënave buxhetore, eliminimin e keqdeklarimeve dhe përmirësimin e klasifikimit dhe shpalosjeve financiare. Ndërsa në nivelin lokal, vlera e korrigjimeve të realizuara arrin vlerën totale prej 15,977,336€.

Po ashtu, përmes regjistrimit të pasurive të paluajtshme përfshirë tokat, objektet dhe parcelat, Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Kamenicës kanë rritur vlerën e pasurive kapitale mbi 1,000€ me gjithsej 151,064,997€, duke përmirësuar ndjeshëm prezantimin e pasurisë publike.

4.1. Niveli Qendror

Procesi i auditimit ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë së raportimit financiar në nivelin qendror, përmes identifikimit dhe korigjimit të gabimeve materiale, si dhe përmes forcimit të kontrolleve të brendshme.

Ky ndikim reflektohet edhe në kapitullin “Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit”, ku nga 49 organizata buxhetore, 15 prej tyre kanë ndërmarrë veprime të menjëhershme duke realizuar korigjime para përfundimit të auditimit.

Vlera totale e korigjimeve të realizuara në nivelin qendror arrin vlerën prej 103,139,739€. Këto korigjime përfshijnë harmonizimin e të dhënave dhe adresimin e keqdeklarimeve në:

- Nenin 13 të PFV-ve - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme,
- Nenin 14 të PFV-ve Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit, si dhe
- Në prezantimin e shënimeve shpjeguese ku bën pjesë edhe pasuria.

Vlerat më të larta të korigjimeve janë evidentuar në:

- Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) 42,338,877€,
- Ministrinë e Drejtësisë (MD) 18,024,470€,
- Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) 9,944,983€,
- Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës (AAC) 6,927,049€,
- Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) 6,774,410€,
- Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) 6,413,875€, dhe
- Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) 6,111,180€.

Nga rekomandimet e dhëna më herët, SHSKUK-ja ka ndërmarrë veprime korigjuese lidhur me kalkulimin dhe kompensimin e kujdestarive për stafin mjekësor, duke filluar nga muaji gusht i vitit 2025.

4.2. Niveli Lokal

Në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë për vitin 2025, ndikimi më i theksuar në nivelin lokal është evidentuar në përmirësimin e regjistrimit dhe menaxhimit të pasurive, veçanërisht në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Komunën e Kamenicës.

Si rezultat i rekomandimeve të dhëna, vlera e pasurive kapitale mbi 1,000€ është rritur për **151,064,997€** gjatë vitit 2025:

- Komuna e Mitrovicës së Jugut – nga 121,139,319€ në vitin 2024, në 245,705,129€ në vitin 2025;
- Komuna e Kamenicës – nga 66,644,668€ në vitin 2024, në 93,143,855€ në vitin 2025.

Ky përmirësim ka ardhur si rezultat i regjistrimit të një numri të konsiderueshëm të pasurive të paluajtshme, përfshirë toka, objekte dhe parcela, duke mundësuar një prezantim më të plotë dhe më të saktë të vlerës së pasurive në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Përveç kësaj, ZKA-ja ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për komunat gjatë përgatitjes së draft-PVF-ve, përmes komunikimeve dhe takimeve me zyrtarët përgjegjës. Ky angazhim ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar, veçanërisht në përgatitjen e nenit 13, nenit 14 dhe shënimeve shpjeguese.

Ndikimi i auditimit është reflektuar përmes kapitullit “Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit”, ku nga 38 komuna të audituara, 11 komuna prej tyre kanë ndërmarrë veprime korrigjuese, gjatë procesit të auditimit, duke korrigjuar gabimet e identifikuara në Pasqyrat Vjetore Financiare.

Korrigjimet janë realizuar nga komunat: Gjakovë, Podujevë, Rahovec, Mitrovicë e Jugut, Prishtinë, Klinë, Malishevë, Gllogoc, Pejë, Gjiilan dhe Fushë Kosovë me vlerë totale prej 15,977,336€.

Në përgjithësi, këto rezultate tregojnë se auditimi ka kontribuar në mënyrë të matshme në rritjen e saktësisë, transparencës dhe besueshmërisë së raportimit financiar, si dhe në forcimin e menaxhimit të financave publike në nivel lokal.

Shtojcat

Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA-në e vitit 2024

Legjenda:



Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA-në 2024	Statusi
1 Qeveria e Kosovës	Përmes MF-së të sigurojë përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar për të përmbushur kërkesat për raportim të plotë dhe të saktë, përfshirë pasqyrat e shpalosjeve (anekseve).	I pazbatuar
Borxhi shtetëror dhe garancitë shtetërore		
2 Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të sigurojë që para se të merren vendimet për financimin e projekteve me huamarrje, se janë bërë analiza të hollësishme dhe përgatitjet e duhura lidhur me projektet, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të këtyre fondeve.	I pazbatuar
3 Qeveria e Kosovës	Ngecjet apo dështimi në mosfillimin apo mosrealizimin e projekteve, duhet të jenë subjekt i shqyrtimeve të vazhdueshme me organizatat zbatuese të projekteve përkatëse ku analizohen shkaqet dhe arsyet që pasqyrojnë ndërmarrjen e veprimeve konkrete në reduktimin/eliminimin e tyre në mënyrë që të njëjtat të realizohen dhe të rezultojnë me përfitime publike në dobi të qytetarëve.	I pazbatuar
4 Ministria e Financave	Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MF-ja në bashkëpunim me ministritë e linjës duhet t'i adresojë të gjitha sfidat e identifikuar, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MF-ja duhet t'i sugjerojë Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave.	Nuk është i aplikueshëm (Është fuzionuar në kuadër të rekomandimit nr.3)
Analiza e buxhetit të shtetit		
5 Qeveria e Kosovës	Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe të monitorojë nëse fondet e alokuara janë të mjaftueshme dhe janë shpenzuar për projektet për të cilat janë aprovuar me buxhet.	I pazbatuar

6	Qeveria e Kosovës	Përmes ministrive përkatëse të ndërmarrë veprimet e mëtejshme për punonjësit që nuk kanë vijueshmëri në punë. Të analizojë situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhjeje, dhe të ndërmerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.	Pjesërisht i zbatuar 
7	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të sigurojë kontrole efektive në proceset e buxhetimit me qëllim që shpenzimet të jenë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuatë, sipas kërkesave të LMFP-së dhe SNKSP-ve.	I pazbatuar 
8	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së të sigurojë se planifikimi dhe realizimi i buxhetit bëhet sipas kodeve funksionale përkatëse në mënyrë që shpenzimet të paraqesin gjendjen e saktë të tyre sipas planit kontabël.	I pazbatuar 
Pasuritë			
9	Qeveria e Kosovës	Qeveria përmes MFPT-së duhet të sigurojë funksionalizimin e plotë të kontroleve të brendshme dhe të rrisë kompetencën e stafit përgjegjës në regjistrimin e pasurive në mënyrë që regjistrat e pasurive të prezantohen në mënyrë të plotë dhe të drejtë, si dhe procesi i inventarizimit të kryhet sipas afateve ligjore.	I pazbatuar 
10	Qeveria e Kosovës	Qeveria duhet të sigurojë përdorimin e sistemit e-Pasuria nga të gjitha organizatat buxhetore.	I pazbatuar 
Llogaritë e Arkëtueshme			
11	Qeveria e Kosovës	Qeveria, në koordinim me MFPT-në duhet të sigurojë raportim të saktë dhe të drejtë financiar të llogarive të arkëtueshme të organizatave buxhetore. Po ashtu, duhet të sigurojë një strategji të qëndrueshme dhe efektive të mbledhjes së të hyrave përmes rivlerësimit të mekanizmave aktual për monitorimin dhe inkasimin e borxheve.	I pazbatuar 
Detyrimet e Papaguara dhe ato Kontingjente			
12	Qeveria e Kosovës	MFPT-ja duhet të vendosë kontrole përmes monitorimit të raporteve të detyrimeve të papaguara nga OB-të dhe në rast të devijimeve nga afatet ligjore të ndërmerren masa.	I pazbatuar 
13	Qeveria e Kosovës	Përmes Ministrisë së Drejtësisë (Avokaturës shtetërore) dhe në koordinim me zyrat ligjore të organizatave buxhetore të verifikojë vlerën e saktë dhe të plotë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta dhe të drejta. Aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korrigjohen.	I pazbatuar 

		Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore	
14	Qeveria e Kosovës	Qeveria, përmes institucioneve relevante të shqyrtojë obligimet dhe përgjegjësitë e OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive, shpronësimet, vonesat në pagesa dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të sigurojë që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime shtesë nga proceset eventuale gjyqësore.	Nuk është i aplikueshëm (Është fuzionuar në kuadër të rekomandimit nr.7) 
15	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Ministri, në koordinim me drejtorin e Thesarit duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarimore, të bëhet ndarja e shpenzimeve shtesë të procedurave përmbarimore nga shuma e borxhit kryesor sipas kodeve ekonomike të parapara me planin kontabël.	I pazbatuar 
		Ndërmarrjet Publike	
16	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	T'i forcojnë masat llogaridhënese ndaj Bordeve Drejtuese dhe menaxhmentit të Ndërmarrjeve Publike, të sigurojnë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet dhe të ndërmerren veprime për t'i adresuar ato në mënyrë sistematike me qëllim të eliminimit të gabimeve që kanë ndikuar në opinionet dhe konkluzionet e modifikuara. Po ashtu, duhet të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve të vitit 2025 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.	Ky rekomandim bartet për adresim te Organizatat përgjegjëse 
17	Qeveria e Kosovës dhe Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike	Në rastet e angazhimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditim të pasqyrave vjetore financiare, të shmangen kontraktimet e shërbimeve të auditimit të PVF-ve me kompanitë private të auditimit.	I zbatuar 
		Sistemi i auditimit të brendshëm	
18	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së (NJQHAB) të sigurojë se OB-të të cilat janë të obliguara të themelojnë NAB-në, duhet ta formojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm.	I pazbatuar 
19	Qeveria e Kosovës	Përmes MFPT-së (NJQHAB) të sigurojë se OB-të sipas kërkesave ligjore themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NJAB-së. Këto komitete të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së. Po ashtu, të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA.	I pazbatuar 

		Auditimet e Performancës, TI-së	
20	Qeveria e Kosovës	T'i analizojë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës, dhe teknologjisë e informacionit si dhe të përgatisë dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt për veprimet përmirësuese.	Ky rekomandim bartet për adresim te Organizatat përgjegjëse

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Kosovës pas shqyrtimit të raporteve të auditimit

Institucioni përgjegjës		Rekomandimet e dhëna nga Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike	Progresi në zbatimin e rekomandimeve
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të UP-së për vitin 20	
1	UP	Rektorati i Universitetit të Prishtinës t'i angazhojë të gjitha kapacitetet ligjore, nese ka mungesë të angazhojë ekspert të jashtëm ose ta angazhojë Avokatin e Popullit në mënyrë që të bëjë përfaqësim kualitativ ligjor në seancat gjyqësore në lidhje me çështjen e Kishës Ortodokse Serbe të ndërtuar në Kampusin e UP-së.	I pazbatuar 
2	UP	Rektori duhet t'i intensifikojë punët dhe të kërkojë raportim 6 mujor nga komisioni i formuar, nëse është nevoja të themelohet edhe komision i ri ndërinstytucional në menyrë që të definohet pronësia e pronave të UP-së me Komunën e Prishtinës, kufijtë kadastral, kalimi i atyre pronave në pronësi të UP-së, si dhe regjistrimi në gjeoportalin shtetëror.	Pjesërisht i zbatuar 
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2022	
1	RTK	Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim me Bordin e RTK-së, t'i analizojë mundësitë, që në një afat sa më të shpejtë, RTK-ja ta ketë një objekt të përhershëm, që i plotëson kushtet e funksionimit të televizionit publik.	Pjesërisht i zbatuar 
		Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2021	
1	SHSKUK	Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë kontrolle të shtuara, sa i përket përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave vjetore financiare. Bordi dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë që zyrtari kryesor financiar të ketë përgatitjen profesionale, njohuritë dhe trajnimet e nevojshme, për të kuptuar dhe zbatuar drejt kërkesat e raportimit financiar. Pasqyrat vjetore financiare duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të mirëfilltë nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Bordi i Drejtorëve.	I pazbatuar 

Shtojca III: Opinionet për OB-të e audituara në tre vitet e fundit

Tabela nr. 40 - Opinionet e auditimit të nivelit qendror për tre vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinionet e auditimit		
		2025	2024	2023
1	Kuvendi i Republikës së Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
2	Zyra e Presidentit	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
3	Zyra e Kryeministrit	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
4	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
5	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
6	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
7	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
8	Ministria e Shëndetësisë	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
9	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
10	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
11	Ministria për Komunitete dhe Kthim	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
12	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
13	Ministria e Ekonomisë	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
14	Ministria e Punëve të Brendshme	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
15	Ministria e Drejtësisë	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
16	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
17	Ministria e Mbrojtjes	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
18	Ministria e Zhvillimit Rajonal	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
19	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
20	Fondi i Sigurimit Shëndetësor	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
21	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
22	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
23	Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
24	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
25	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
26	Agjencia Kosovare e Privatizimit	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar

27	Organi Shqyrtues i Prokurimit	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
28	Universiteti i Prishtinës	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
29	Gjykata Kushtetuese	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
30	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
31	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
32	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
33	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
34	Këshilli Prokurorial i Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
35	Agjencia për Informim dhe Privatësi	I pamodifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
36	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	I kualifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
37	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
38	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
39	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
40	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
41	Komisioni i Pavarur për Media	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
42	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
43	Insitucioni i Avokatit të Popullit	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
44	Akademia e Drejtësisë	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
45	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
46	Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
47	Radio Televizioni i Kosovës	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
48	Fondet në Mirëbesim	I pamodifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
49	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar ²⁹	I kualifikuar	I kualifikuar	-

²⁹ Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar është organizatë buxhetore e themeluar në vitin 2014

Tabela nr. 41 – Opinionet e auditimit të nivelit lokal për tre vite

Nr.	Subjektet e audituara	Opinionet e auditimit		
		2025	2024	2023
1	Glllogoc	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
2	Fushë Kosovë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
3	Lipjan	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
4	Obiliq	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
5	Podujevë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
6	Prishtinë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
7	Shtime	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
8	Graçanicë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
9	Dragash	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
10	Prizren	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
11	Rahovec	I kualifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
12	Suharekë	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
13	Malishevë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
14	Mamushë	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
15	Deçan	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
16	Gjakovë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
17	Istog	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
18	Klinë	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
19	Pejë	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
20	Junik	I pamodifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
21	Mitrovicë	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
22	Skenderaj	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
23	Vushtrri	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
24	Gjilan	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
25	Kaçanik	I kualifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
26	Kamenicë	I kualifikuar	I pamodifikuar	I kualifikuar
27	Novo Bërd	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
28	Shtërpçë	I pamodifikuar	I kualifikuar	I pamodifikuar
29	Ferizaj	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
30	Viti	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
31	Partesh	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
32	Hani i Elezit	I kualifikuar	I pamodifikuar	I pamodifikuar
33	Klllokot	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar

34	Ranillug	I pamodifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
35	Zubin Potok	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
36	Zveçan	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
37	Mitrovica Veriore	I pamodifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
38	Leposaviq	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar

Tabela 42 - Opinionet e auditimit të ndërmarrjeve publike për tre vite

Nr.	Subjektet e audituara	NP e Nivelit	Opinionet e auditimit		
			2025	2024	2023
1	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a	Qendror	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
2	Trepça sh.a	Qendror	I kundërt	I kundërt	I kundërt
3	KOSTT sh.a	Qendror	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
4	NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë	Qendror	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
5	Telekomi i Kosovës, sh.a	Qendror	-	I pamodifikuar	I pamodifikuar
6	KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë	Qendror	I kualifikuar	I kualifikuar	I kualifikuar
7	KRU. "Hidrodrini" SH.A.	Qendror	I kundërt	I kundërt	I kundërt
8	KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë	Lokal	I kundërt	I kundërt	I kundërt
9	Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a	Lokal	I kualifikuar	I kundërt	I I kundërt
10	KRM "Pastërtia", sh.a	Lokal	I kundërt	-	-
11	NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a.. Prishtinë ³⁰	Lokal	I kundërt	-	-
12	Raporti i Auditimit PFV për Qëllime të Veçanta të Divizioneve të Ndara të KEK-ut për ZRRE-në	Qendror	I pamodifikuar	-	-
13	Raporti i auditimit për raportin financiar vjetor të KEK-ut për qëllime të veçanta mbi rentën minerare të paguar për licencat	Qendror	I pamodifikuar	-	-

30 Për vitin 2024 dhe 2023 KRM "Pastërtia", sh.a dhe NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a., nuk janë audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Shtojca IV: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinionëve dhe konkluzioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pamodifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keqdeklarime ose mospajtueshmëri; kur janë zbuluar keqdeklarime ose mospajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keqdeklarimi(et) dhe/ose mospajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keqdeklarimit(eve) material(e) dhe/ose mospajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe/ose mospajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale dhe/ose mospajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keqdeklarime dhe/ose mospajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keqdeklarimi dhe/ose mospajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keqdeklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keqdeklarime dhe/ose mospajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keqdeklarimet dhe/ose mospajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keqdeklarimeve dhe/ose mospajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keqdeklarimeve dhe/ose mospajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keqdeklarimeve dhe/ose mospajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a. nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; por
- b. nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c. për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe i përhapur.

Konkluzionet e auditimit

- **Konkluzioni i Pamodifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit;
- **Konkluzioni i Kualifikuar** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara të auditimit, përveç ndonjë çështjeje të caktuar e cila përshkruhet te baza për konkluzion të pajtueshmërisë;
- **Konkluzioni i kundërt** - Paraqet opinionin e auditorit se proceset dhe transaksionet përcjellëse nuk janë në pajtim me kriteret e përcaktuara të auditimit; dhe

- **Mohimi i konkluzionit** - Paraqet gjendjen kur auditori për shkak të pamundësisë për marrjen e dëshmive të duhura dhe pa pajtueshmërive të përhapura në shumë fusha, nuk është në gjendje të nxjerrë konkluzion lidhur me pajtueshmërinë.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin "Theksim i çështjes" ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditorit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shtojca V: Letërkonfirmimi

Deri në datën e finalizimit të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2025, nuk është pranuar Letërkonfirmimi nga Entiteti i audituar.

Shtojca VI: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

Shënim		2025	2024	2023
		Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
Tatimet Direkte				
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	219,484	203,380	184,864
Tatimi në të ardhura personale	3	300,604	280,782	255,941
Tatimi në pronë	4	39,142	32,977	46,085
Tatime tjera direkte	5	56	29	3,403
		559,286	517,168	490,294
Tatimet Indiekte				
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	1,649,892	1,504,924	1,365,580
Detyrimi doganor	7	185,914	172,069	156,214
Akciza	8	653,275	618,287	554,989
Tatime tjera indirekte	9	1,278	1,834	101
		2,490,359	2,297,114	2,076,882
Kthimet tatimore				
Kthimet tatimore	10	-76,661	-74,131	-61,277
		-76,661	-74,131	-61,277
Të hyrat jo-tatimore				
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	170,453	197,283	148,074
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	81,656	66,239	62,511
Taksa koncesionare	13	42,634	33,037	25,980
Renta minerare	14	25,467	27,455	26,722
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	3,940	3,045	3,594
Të hyrat nga dividenda dhe ndarja e fitimit	16	15,417	10,376	-
		339,568	337,436	266,881
Huamarrja				
Huamarrja e jashtme shtetërore	17	143,449	124,723	96,745
Pranimet për shërbimin e nënhuazimeve	18	3,653	6,577	8,216
Huamarrja e brendëshme shtetërore	19	-1,150	-7,993	-141,805
		145,953	123,306	-36,845
Grantet dhe ndihmat				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	20	16,314	9,928	13,823
Grantet e BE-së për energjinë	21	-	-	67,500
Grantet për mbështetje buxhetore	22	14,372	1	-
		30,687	9,929	81,323
Pranimet tjera				
Fondi i depozitave	23	4,045	4,793	4,547
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	24	12,364	11,486	37,877
Të hyrat e dedikuara	25	6,809	6,485	5,958
Financimi i njëhershëm i AKP-së	26	22	-	-
		3,512,430	3,233,585	2,865,640
Operacionet				
Paga dhe shtesa	27	910,621	843,599	767,305
Mallëra dhe shërbime	28	470,357	432,514	397,978
Shërbime komunale	29	32,049	29,250	28,779
		1,413,028	1,305,363	1,194,062
Transferet				
Subvencione dhe transfere	30	1,232,534	1,114,605	1,079,450
Shpenzimet kapitale				
Prona, impiantet, pajisjet, transferet	31	729,448	654,626	560,868
Pagesat tjera				
Pagesa e borxhit	32	98,725	99,747	89,163
Kredidhënia për Ndërmarrje Publike dhe RTK	33	10,021	15,000	1,947
Kthimet e fondeve dhe depozitave	34	2,883	6,238	508
Gjithsej Pagesat¹		3,486,638	3,195,579	2,925,998
Rritje/(Zbritje) në para të gatshme		25,792	38,509	(60,358)
Efekti i kursit të këmbimit mbi paranë e mbajtur në USD	35	-4,449	503	-
Para të gatshme në fillim të vitit	36	423,884	385,375	445,734
Para të gatshme në fund të vitit	36	445,228	423,884	385,375

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	Shënim	2025			2024	2023
		Realizimi A	Buxheti përfundimtar B	Buxheti fillesar C	Ndryshimet buxhetore D=B-A	Realizimi Realizimi
		'000 €	'000 €	'000 €	'000 €	'000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimet direkte		559,286	586,339	586,339	517,168	490,294
Tatimet indirekte		2,490,359	2,431,367	2,431,367	2,297,114	2,076,882
Kthimet tatimore		-76,661	-91,343	-91,343	-74,131	-61,277
Të hyrat jo-tatimore		339,568	356,571	356,571	337,939	266,881
Grantet dhe ndihmat ²		30,687	22,500	22,500	9,929	81,323
Huamarrja		145,953	518,491	518,491	123,306	-36,845
Pranimet tjera ³		23,239	11,300	11,300	22,764	48,382
Gjithsej Pranimet		3,512,430	3,835,225	3,835,225	3,234,089	2,865,640
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Paga dhe shitesa		910,133	914,185	916,920	843,034	766,557
Mallra dhe shërbime		466,586	515,319	502,233	429,198	394,950
Shpenzime komunale		32,048	35,013	34,757	29,249	28,778
Subvencione dhe transfere		1,230,710	1,246,738	1,156,723	1,112,492	1,078,206
Shpenzime kapitale		720,059	887,409	931,300	647,014	554,433
Rezerva		-	583	4,062	-	-
Interesi		50,884	49,507	49,507	43,213	42,215
Të tjera ⁴		76,218	199,036	186,897	91,378	60,859
Gjithsej Pagesat		3,486,638	3,847,789	3,782,398	3,195,579	2,925,998
Rritja/Zbritja e parasë së gatshme	37	25,792	(12,564)	52,828	38,509	(60,358)

² Të planifikimi buxhetor përfshihen grantet e përcaktuara të donatorëve (12 milionë euro) si dhe grantet për mbështetje buxhetore (10.5 milionë euro)

³ Përfshihen, të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, financimi i njëjtershëm nga AKP dhe pranimet nga deponizat.

⁴ Përfshihen buxheti dhe pagesat si: pagesat e kryesjes, nen-huazimeve, granteve të përcaktuara të donatorëve, pagesat për kapitalizim dhe blerje të aksioneve, pagesat për antarësim në IFN, dhe kthimet nga fondet e deponitave (neto).

Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe balanceve të fondeve për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025

	Shënim	2025 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2024 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	2023 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
Pasuritë financiare - para e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	38	419,526	395,911	345,232
Kuotat në IFN	39	9,832	9,832	8,395
Fondi në mirëbesim për zhvillim	40	3,862	3,837	3,566
Paratë e gatshme në transit	41	6,382	7,223	22,894
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	42	2,674	4,849	3,899
Paratë e gatshme në dorë (arka) dhe avance te hapura	43	2,951	2,231	1,389
Gjithsej pasuritë financiare dhe para të gatshme		445,228	423,884	385,375
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	44	8,321	7,675	17,472
Të hyrat vetanake - niveli qendror	45	1,803	2,000	3,027
Të hyrat vetanake - niveli lokal	46	45,615	57,515	81,387
Fondi në mirëbesim për zhvillim	47	3,807	3,782	3,510
Të hyrat e dedikuara	48	5,158	4,253	3,431
Kontigjenca e BE-së për Energji	49	-	-	22,740
Të tjera	50	35,189	33,832	29,060
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	51	6,571	6,953	6,226
		106,464	116,010	166,854
Të pashpërndara		338,764	307,874	218,522
Gjithsej Bilanci i Fondeve	36	445,228	423,884	385,375

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës